

STUDIM FIZIBILITETI

SITUATA E AKSESIT, FUNKSIONIMIT DHE LIDHJES SË INTERNET BROADBAND NË ZONËN E BJESHKËVE TË NAMUNA

Tiranë, Dhjetor 2014

Ky studim është përgatitur në kuadër të zbatimit të projektit “*Promovimi i Internet Broadband në Bjeshkët e Namuna*”, projekt i zbatuar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, dhe i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të instrumentit IPA, programi i bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Mal i Zi.

Studimi përbëhet nga katër kapituj:

1. “Vlerësim i përgjithshëm i zhvillimit social-ekonomik të zonës, pozicionit gjeografik dhe relievit, demografisë së zonës, gjendjes së turizmit malor dhe perspektivës së zhvillimit të tij nëpërmjet zgjerimit të aksesit dhe lidhjes të internet broadband”.
2. “Përgatitja e listës së operatorëve dhe ofruesve të internetit broadband në zonën e përzgjedhur, vlerësimi i kuadrit ekzistues ligjor dhe i dokumenteve politike shoqëruar me sugjerime për përmirësimin e tyre, evidentimi i sinergjive të përdorimit të internet broadband për rritjen e bashkëpunimit ndërkufitar në shkëmbimet e vizitorëve/turistëve si dhe në rritjen e shkëmbimeve tregëtare”.
3. “Shërbimet Internet Broadband në zonën “Bjeshkët e Namuna””
4. “Financimi i Internet Broadband në Bjeshkët e Nëmuna”

Procesi i përgatitjes së këtij grup studimeve u drejtua nga Znj. Anis Lamllari, Drejtore Projekti për tre kapitujt e parë, dhe nga Znj. Krisela Hackaj për kapitullin e katërt.

Për pjesë të veçanta bashkëpunuan:

- Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik (AKCE), Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Autoriteti Shtetëror për informacionin gjeohapësinor (ASIG), dhe konsulentët e jashtëm Znj. Elmira Gaxho, Z. Genci Mesi, Z. Idar Bistri, për kapitujt 1, 2, 3 dhe konkluzionet;

- Z. Ilir Ciko nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim për kapitullin 4.

SHKURTIMET

ADSL	Linje Asimetrike e Abonentit Dixhital
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
BE	Bashkimi Europian
BEI	Banka Europiane e Investimeve
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
CEB	Banka e Zhvillimit të Këshillit të Europës
DLDP	Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal
E-Qeveria	Qeveria Elektronike
ECA	Tabela Europiane e Akomimit të Frekuencave
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
GSM	Sistemi Global i komunikimeve celulare
GTZ/GIZ	Organizata Gjermane për Kooperim Teknik/Ndërkombëtar
IDB	Banka Islamike për Zhvillim
IPA	Instrumenti i Ndihmës para Aksesimit
ITU	Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit
KfW	Banka e Zhvillimit Gjerman
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
PAP	Pikat e Aksesit Publik
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeohapsinor
MIAP	Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike
NjQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore (qarqet, bashkitë dhe komunat)

LTE	Long Term Evolution
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
ShBSh	Shoqata e Bashkive të Shqipërisë
ShKSh	Shoqata e Komunave të Shqipërisë
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, e RSH
SNSIS	Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit në Shqipëri
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave të RSH
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
WSIS	Samiti Botëror i Shoqërisë së Informacionit- (World Summit of Information Society)
WRC	Konferenca Botërore e Radiokomunikacionit
UMTS	Sistemi Universal i Telekomunikacioneve të Levizshme
UN	Kombet e Bashkuara
ADSL	Asymmetrical Digital Subscriber Line
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
BPL	Broadband Power Line
CMTS	Cable Modem Termination System
DOCSIS	Data over Cable Service Interface Specification
FTTH	Fiber to the Home
FTTC	Fiber to the Curb
GePON	Gigabit Ethernet Passive Optical Network
GPS	Global Positioning System

HFC	Hybrid Fiber and Coax
ICT	Information & Communication Technology
ISDN	Integrated Services Digital Network
ISP	Internet Service Provider
IT	Information Technology
ITU	International Telecommunication Union
IEEE	Institute of Electrical and Electronics Engineer
LOS	Line-of-Site
OLT	Optical Line Terminator
ONT	Optical Network Terminal
POTS	Plain Old Telephone Service
SDSL	Symmetrical Digital Subscriber Line
SME	Small and Medium Enterprises
SOS	Kerkesë për ndihmë sipas Alfabetit MORS
VDSL	Very-Hight-Bit-Rate Digital Subscriber Line



PËRMBAJTJA

Përmbledhje

Kapitulli I

“Vlerësim i përgjithshëm i zhvillimit social-ekonomik të zonës, pozicionit gjeografik dhe relievit, demografisë së zonës, gjendjes së turizmit malor dhe perspektivës së zhvillimit të tij nëpërmjet zgjerimit të aksesit dhe lidhjes të internet broadband. Një vlerësim i situatës së penetrimit të internetit, mbulimit dhe çmimeve të ofruara në zonën e përzgjedhur”

Ky studim ka si qëllim përgatitjen e listës së operatorëve dhe ofruesve të internetit broadband në zonën e Bjeshkëve të Namuna, vlerësimin e kuadrit ekzistues ligjor dhe i dokumenteve politike i shoqëruar me sugjerime për përmirësimin e tyre, evidentimin e sinergjive të përdorimit të internet broadband për rritjen e bashkëpunimit ndërkuftar në shkëmbimet e vizitorëve/turistëve si dhe në rritjen e shkëmbimeve tregëtare.

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në këtë studim është e kombinuar, përmes hulumtimit të një sërë dokumentash mbi pozicionin gjeografik dhe relievin, analizave për situatën demografike të zonës, situatën aktuale të zhvillimit social, ekonomik të saj, të turizmit malor nga njëra anë dhe marrjes së informacionit nga takimet e zhvilluara me përfaqësuesit të pushtetit vendor dhe biznesit të zonës.

Në këtë studim do t’i referohemi fakteve të mbledhura nga materialet e përgatitura gjatë viteve të fundit nga Censusi, AKEP, INSTAT dhe materiale të shumta të komunave. Por gjithashtu do të konsiderojmë dhe informacionet e mbledhura në terren, nga intervistat me punonjës të institucioneve lokale, bizneseve vendore e qytetarëve. Do të konsiderojmë dhe fakte të paraqitura

nga studime të mëparshme të mbështetura nga institucionet ndërkombëtare si USAID, PNUD apo GIZ dhe do të bazohemi në strategjitë e përpiluara për këto dy qarqe, Shkodër dhe Kukës.

Nga analiza e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik e social, situatës së TIK në këtë zonë dhe ndikimit të tij në ekonominë e gjendjen e turizmit, kalohet në sugjerimin e mënyrave si të nxisim zhvillimin ekonomik e turistik të zonës përmes përdorimit të TIK si dhe nëpërmjet zgjerimit të aksesit dhe lidhjes në internet broadband.

Për hartimin e këtij studimi janë marrë për bazë edhe rezultatet e intervistave në terren të kryera nga stafi i projektit IBB me drejtues dhe staf të disa NjQV-ve të zonës së mbuluar nga projektit në qarqet Shkodër dhe Kukës, e me specifikisht në komunën Kelmend, Komunën Kastrat, Komunën Qënder Koplik, Komunën Shkrel-Dedaj, Komunën Margegaj, Komunën Lekbibaj, Komunën Tropojë e Vjetër, Komunën Bujan, Komunën e Shalës etj.

Për të identifikuar angazhimin e operatorëve privat TIK studimi mbështetet në analizat e tregut të kryera nga AKEP, në dokumentin e regjistrimit të sipërmarrësve të autorizuar për ofrimin e shërbimeve në këtë zonë si dhe në rezultatet e vizitave në terren për prezencën faktike të sipërmarrësve që ofrojnë shërbime broadband. Studimi merr në konsideratë vrojtime të kryera në kuadër të projekteve të mëparshme mbi situatën e TIK në zonën e mbuluar nga projekti. Analiza e legjislacionit ekzistues dhe politikave të zhvillimit ka trajtuar një numër dokumentash në nivel kombëtar, politikash zhvillimi për TIK dhe broadband, kuadrin ligjor të BE-së për komunikimet elektronike, politikat e zhvillimit rajonal në zonën e Bjeshkëve të Namuna duke identifikuar çështjet që duan vëmendje në të ardhmen.

Studimi është mbështetur në një numër dokumentash dhe publikimesh të lidhura me zhvillimin e kësaj zone, në studimin e analizave të tregut për TIK të kryera në dy vitet e fundit, në shqyrtimin e kuadrit ligjor për komunikimet elektronike, dokumentat e politikës së zhvillimit rajonal të listuara në fund të dokumentit.

KAPITULLI I

HYRJE

Zhvillimi social e ekonomik i një vendi shihet i lidhur ngushtë me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të njohura si teknologji të interesit të përgjithshëm. Teknologjitë TIK dhe broadband ofrojnë potencialin për të kapërcyer shumë sfida unike dhe kufizime tradicionale që karakterizojnë ekonominë rurale, veçanërisht ato zona që janë në distanca të largëta. Qytetarët e zonave rurale dhe të largëta kanë nevoja të ngjashme me ato të zonave urbane, por janë në disavantazh me zonën urbane. Për shembull, dendësia e ulët e popullsisë do të thotë një bazë më e ulët e të ardhurave për të mbështetur shërbimet themelore; largësia gjeografike do të thotë vështirësi të transportit; Distanca nga tregjet mund të jetë një dekurajim për rritjen dhe lindjen e bizneseve të reja. Në fund, largësia, zakonisht nënkupton mungesën e qasjes në arsim, trajnim dhe përditësimin profesional. Diversifikimi ekonomik konsiderohet një mekanizëm kyç i mbijetesës për shumë komunitete rurale, por tashmë ofrimi i internetit ofron mundësi për punë dhe shërbime.

Në një periudhë shumë të shkurtër kohe, Broadband ka evoluar nga të qenit një luks në një infrastrukturë thelbësore për njerëzit dhe biznesin, efektive dhe e shpejtë për kujdesin shëndetësor, arsimin dhe mirëqeverisjen. Qasja me internet broadband është bërë një mjet i nevojshëm për angazhimin në ekonomi dhe në kulturën moderne. Sot, të gjitha nivelet e qeverisë e konsiderojnë gjithnjë e më shumë aksesin në internet si një domosdoshmëri – dhe me një rëndësi të veçantë për mirëqënien ekonomike dhe sociale duke u barazuar me rrugët dhe me energjinë elektrike. Në mungesë të aksesit broadband, zhvillimi ekonomik dhe ofrimi i shërbimeve për banorët dëmtohet seriozisht. Si në sektorin privat dhe publik po shkohet gjithnjë e më shumë në vetë-shërbim, zgjidhje me kosto të ulët, dhe shfrytëzim i mjeteve të shpejta të komunikimit të cilat ofrojnë qasje më të lehtë dhe më transparente në informacion, si interneti dhe teknologjia. Qasja e internet Broadband ndihmon në promovimin e mundësive të barabarta për të gjithë. Pas pajisjes me internet, vendndodhja e tyre gjeografike bëhet gjithnjë e më pak pengesë për përfshirjen sociale dhe ekonomike. Kjo e bën më të lehtë jetesën dhe punën e njerëzve në zonat rurale për të mbështetur

zhvillimin lokal, duke shmangur migrimin e panevojshëm dhe përmirësimin e strukturave socio-geografike kombëtare.

TIK gjithnjë e më shumë po luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Fushat si ato të edukimit, shëndetësisë, transportit, tregëtisë por dhe shërbimet qeveritare, janë direkt të ndikuara nga zhvillimi i TIK. Qeveria shqiptare ka identifikuar si një prioritet të rëndësishëm zhvillimin e TIK-ut për sigurimin e një game të gjerë të shërbimeve të komunikimit elektronik dhe sigurimin e lidhjeve të besueshme dhe të përballueshme përmes këtyre shërbimeve. Gjithashtu, qeveria ka vënë në dukje se për të arritur këto sfida është thelbësore shtrirja e aksesit të shërbimeve me internet brez të gjerë (*broadband*) dhe shpejtësi të lartë, në të gjithë vendin¹.

Për të rritur mundësitë e zhvillimit ekonomik në të gjithë vendin e veçanërisht me qëllim përfshirjen e zonave rurale, nevojitet krijimi i mundësive për përdorimin e Teknologjive të informacionit dhe të komunikimit në një game të gjerë me qëllim që zonat rurale të bëhen sa më tërheqëse për investime dhe rritjen e interesit të njerëzve për të lëvizur në këto zona për qëllime turizmi, tregëtie etj. Në këtë kuadër, ka gjithmonë nevojë për përmirësime. Ofrimi i internetit përbën një element të rëndësishëm që mundëson zhvillimin e zonave rurale e veçanërisht atyre malore.

Qeveria shqiptare ka miratuar Planin Kombëtar *Broadband* (PKB) për Shqipërinë, i cili përcakton vizionin politik dhe masat për zhvillimin e *broadband* në përshtatje me situatën dhe sfidat që përballet vendi, përfshirë sigurimin e shërbimeve *broadband* në zonat rurale. Përmes bashkëpunimit të sektorit publik dhe atij privat përfshirë industrinë, operatorët dhe ofruesit e shërbimeve, si edhe autoritetet e qeverisjes vendore (bashkitë, komunat), qeveria shqiptare synon të nxisë zhvillimin e *broadband* në Shqipëri dhe të ndër marrë veprime konkrete për të përmirësuar disponueshmërinë, përballueshmërinë dhe aksesueshmërinë e shërbimeve të komunikimeve *broadband*.

Ky dokument analizon situatën aktuale të zhvillimit social, ekonomik të zonës, pozicionit gjeografik dhe relievit, demografisë së zonës, gjendjes së turizmit malor dhe perspektivës së zhvillimit të tij nëpërmjet zgjerimit të aksesit dhe lidhjes të internet *broadband*.

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I ZONËS SË PROJEKTIT

BJESHKËT E NAMUNA

Alpet shqiptare dhe Bjeshkët e Namuna janë vazhdimësi e maleve dinarite dhe shtrihen në veri të Shqipërisë, në perëndim të Kosovës dhe në jug-lindje të Malit të Zi. Bjeshkët e Namuna shtrihen deri te lugina e Ibrit, rreth 50 km në gjatësi. Në anën e Kosovës ngrihen nga fundi i fushës (500-600 m) dhe arrijnë lartësinë mbi 2000 m, në disa vende prehen në lugina të thella dhe kanë si kufi jugor Drinin.

Të kufizuara, gati nga çdo anë, Bjeshkët, në jug-perëndim bien deri në ultësirën shkodrane, nga qendra mbërrijnë rrjedhën e Drinit, dhe në lindje ulen drejt Tropojës, vetëm në veri-perëndim Alpet lidhen me malësitë karstike malazeze.

Alpet shqiptare janë mbresëlënëse dhe me forma piktoreske. Ato janë një shtrirje e peizazhit malor, i cili përplaset në disa zinxhirë luginash gëlqerore të Alpeve. Luginat paraqesin në disnival me majat e maleve, thellësitë e 1200-1500 m dhe ndonjëherë edhe më shumë.

Relievi malor i Alpeve i përngjan një kupole me majën më të lartë që nuk ka si të mos tërheqë vëmendjen e vizitorëve me format e shumta karstike, akullnajore etj. Majat e maleve që në këtë territor duket sikur arrijnë qiellin me majat e tyre të mprehta dhe bukuri mahnitëse, pasqyrohen në ujërat e kthjellta të lumenjve si Shala, Valbona, Curraj, Cemi, Moraça, etj si dhe në liqenet akullnajore të tilla ato të Pejës, Jezercës, Dobërdolit, Sylbicës, të cilat ofrojnë një qetësi përrallore dhe një nivel adrenaline e cila ndryshon në çdo moment që shijon bukuritë e shumta të kësaj hapësire. Majat e maleve të tilla si Radohima, Maja Hekurave, maja e Arapit, maja e Shkëlzenit, etj që shërbejnë si pika triangulacioni të ofrojnë një panoramë të ndryshme e cila tundon shpirtin aventuror të çdo vizitori për t'i parë bukuritë natyrore përreth tyre.

Kësaj oferte natyrore tepër të pasur e cila mund të shfrytëzohet për qëllime turistike i shtohet edhe larmia e florës dhe faunës. Katër katet e bimësisë dhe kushtet edafike sa të ngjashme aq edhe të ndryshme në këtë hapësirë ka kushtëzuar dhe ekzistencën e një sërë bimësh dhe kafshësh

endemike të cilat paraqesin jo vetëm interes me karakter studimor por gjithashtu e pasurojnë dekoracionin turistik të kësaj hapësire.

Monumentet e shumta natyrore si kanioni i Shoshaj, i Valbonës, i Cemit, shpella e Dragobisë, e majës së Arapit, shpella e Rrathëve, shpella e Akullit, shpella e Haxhisë, shpella e Njerzëve të Lagur, burimi i Shoshaj, Valbonës, Okolit, Shtrazës, Kirit, Koprishtit, Vuklit etj ujëvara e Thethit, Grunasit, etj si dhe biomunimentet e shumta si ahishta e Gurrajt e Hasan Gashit, rrobulli në liqenin Ponarëve, bredhishta e Rragamit, pisha Flamur e qafës së Pejës, Habitati i Salamandrës, rrapit i Toplanës janë një tregues shumë domethënës për pasuritë e mëdha natyrore të kësaj zone në funksion të turizmit.



Kësaj i shtohet ekzistenca e zonave të mbrojtura si Parku kombëtar i Thethit, Parku kombëtar i Valbonës, të cilat janë një garanci për jetëgjatësinë e këtyre bukurive natyrore. Një potencial tjetër i çmuar i Alpeve shqiptare është pasuria kulturore, mikëpritja dhe bujaria e madhe e banorëve të zonës. Disa nga zonat turistike të Alpeve janë Thethi, Razma, Valbona, Vermoshi, etj si dhe lugina

me bukuri epike e Drinit ku një udhëtim me traget nga Fierza për në Koman do të linte përshtypje të paharrueshme edhe për vizitorët më indiferent.

Bjeshkët e Namuna shtrihen midis qarkut të Shkodrës dhe Kukësit. Më poshtë do të japim një përshkrim të përgjithshëm të situatës ekonomike, sociale, demografike, pozitën gjeografike të këtyre qarqeve për të vijuar me situatatën e shtrirjes së përdorimit TIK në këto zona. Në këtë prezantim do ndalemi në disa nga komunat kryesore të zonës për të evidentuar çështje që lidhen me prespektivën e zhvillimit dhe se si TIK dhe lidhja broadband mund të ndikojë në zhvillimin social e ekonomik të zonës.

2. QARKU SHKODËR

Qarku i Shkodrës shtrihet në pjesën veriore të Shqipërisë në një territor prej 3.562 km² i cili kufizohet me Malin e Zi në veri dhe veriperëndim, me qarkun e Kukësit në lindje dhe me qarkun e Lezhës në jug, ndërsa arrin deri në bregdetin e detit Adriatik në perëndim dhe jugperëndim. Territori i qarkut përbëhet nga zona fushore dhe zona malore në Alpet shqiptare dhe në pjesën qendrore të qarkut. Territori më malor ndodhet në pjesën perëndimore të Alpeve me majën më të lartë atë të Radohimës, ndërkohë që zonat fushore shtrihen në perëndim dhe jugperëndim (10% e sipërfaqes) me dy zona kryesore – ajo e Mbishkodrës në rrethin e Malësisë së Madhe dhe e Nënshkodrës në rrethin e Shkodrës.

Qendra administrative e qarkut është qyteti i Shkodrës – i themeluar në shekullin e katërt para Krishtit nga fisi ilir i Labeatëve. Në shkallë kombëtare qarku i Shkodrës renditet i dyti për nga sipërfaqja dhe i pesti për nga numri i popullsisë.

Territori i qarkut, përbëhet nga tre rrethe kryesore – Shkodër, Malësia e Madhe dhe Puka – me pesë bashki (gjashtë qytete – Shkodër, Vau-Dejë, Koplík, Bajzë, Pukë, Fushë-Arrëz) dhe 28 komuna me një total prej 272 fshatrash.

Shumica e popullsisë, rreth 62% jeton në zonat rurale, veçanërisht në fshatrat e rrethit Shkodër. Ashtu si edhe tek shumica e rajoneve të tjera shqiptare në zhvillim, migrimi i brendshëm është një

fenomen karakteristik që ka sjellë një ulje drastike të numrit të popullsisë në zonat rurale krahasuar me periudhën e fillim viteve të tranzicionit (fillimi i viteve 1990).

Qarku i Shkodrës është një nga zonat me pasuri të shumta natyrore. Brenda një rreze prej rreth 30 km rajoni ofron kushte të favorshme natyrore për zhvillimin e katër llojeve të turizmit: liqenor / detar / bregdetar (Liqeni i Shkodrës dhe bregdeti i Velipojës), turizmi malor e dimëror (Alpet dhe Bjeshkët e Namuna), kulturor (qyteti i Shkodrës, Kalaja e Rozafës, Pazari i vjetër i cili daton prej 1807 – 1809 et.).

Me një ekosistem të larmishëm (Liqeni i Shkodrës dhe lumi i Bunës), shumë pranë detit Adriatik (Porti i Shëngjinit) dhe pika më e afërt e tranzitit drejt veriut të gadishullit të Ballkanit dhe tregun e Bashkimit Evropian (me rrugë tokësore e hekurudhore), qarku i Shkodrës manifeston të gjitha parakushtet e një zone të rëndësishme tregu dhe tranziti, si edhe të një qendre të rëndësishme ekonomike dhe industriale të Shqipërisë.

Këto të dhëna si edhe burimet natyrore por jo vetëm, të prezantuara më sipër tregojnë se Qarku i Shkodrës ofron një potencial të konsiderueshëm për rritje dhe zhvillim të mëtejshëm ekonomik. Ky rajon tradicionalisht ka qenë qendra më e madhe ekonomike e Shqipërisë së veriut por edhe për zonën kufitare në Malin e Zi. Sidoqoftë, izolimi thuajse gjysmë shekullor i rajonit e ka vendosur Shkodrën përballë sfidave të mprehta kur në fillim të viteve 1990 e gjeti veten të pamundur të rivendoste bashkëpunimin ekonomik dhe lidhjet tregtare të ndërprera për rreth 45 vjet më fqinjët në krahun tjetër të kufirit dhe më gjerë.

Aktualisht, aktivitetet kryesore ekonomike në qarkun e Shkodrës janë të përqendruara në ndërtim dhe prodhimin e materialeve të ndërtimit, industrinë e lehtë (agro-industria, industria e përpunimit të drurit, fasonët etj.), agrobiznesi, tregti, shërbime etj.

Veçanërisht vitet e fundit, rigjallërimi i qarkut të Shkodrës u zhvillua me ritme relativisht të larta, me një numër të konsiderueshëm investimesh të huaja (megjithëse në përmasa të vogla), me një bashkëpunim të sektorit privat me kompanitë dhe tregjet e huaja, të shoqëruara të gjitha këto me përmirësime të mëdha të infrastrukturës dhe mjedisit të biznesit.

Ndonëse aktivitetet kryesore ekonomike dhe industriale janë të përqendruara kryesisht në rrethin e Shkodrës, autoritetet lokale dhe rajonale janë duke bashkëpunuar në mënyrë intensive me pushtetin qendror dhe aktorë të tjerë për të siguruar shtrirje sa më të madhe të trendeve të zhvillimit edhe në rrethet e tjera të qarkut.

Një kuadër i gjerë masash është duke u përgatitur në këtë kontekst si krijimi i parkut industrial në Koplík (rrethi i Malësisë së Madhe), investime në sektorin energjetik, mbështetje për zhvillimin e agro-turizmit, mbështetje për sektorin akademik në Shkodër që t'i përgjigjet sfidave social-ekonomike të rajonit etj. Partneriteti i qendrës akademike të qarkut – Universiteti Luigj Gurakuqi – si edhe lidhjet tradicionale të bashkëpunimit me Evropën perëndimore (Itali) vazhdojnë të ofrojnë një vlerë të shtuar në këtë kontekst.

Qarku i Shkodrës përbëhet nga 33 NJQV në tre rrethe: rrethi i Malësisë së Madhe (6 njësi, qendër Koplík), rrethi i Pukës (10 njësi, qendër Pukë) dhe rrethi i Shkodrës (17 njësi, qendër Shkodër). Popullsia e qarkut të Shkodrës është 215.347 banorë në vitin 2011, ndër të cilët 77% (166.050 banorë) jetojnë në rrethin e Shkodrës dhe 36% në qytetin e Shkodrës. Dy njësitë e tjera më të mëdha pas bashkisë së Shkodrës janë komunat Rrethinat (21.000 banorë) dhe Bushat (14.000 banorë). Dy bashkitë e tjera qendër rrethi – Koplík dhe Pukë kanë popullësi mjaft të vogël (më pak se 4.000 banorë), ndërkohë që bashkia e dytë më e madhe e zonës është Vau i Dejës, me pak më shumë se 8.000 banorë.

Qarku i Shkodrës ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 35% ose mbi 118.000 banorë krahasuar me të dhënat zyrtare të Regjistrit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Sipas të dhënave zyrtare të RGJC-së në Janar 2012 në qarkun e Shkodrës ishin të regjistruar 333.355 banorë, me përqendrim të ngjashëm me atë të raportuar nga Censusi 2011.

Popullsia e qarkut Shkodër përbën rreth 32,4% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 25.840 banorë/NJQV ose tre herë më e lartë se mesatarja kombëtare prej 8.016 banorë/NJQV. Kjo mesatare rritet ndjeshëm për shkak të përqendrimit të madh të popullsisë në qendrat urbane dhe periferike në rrethin e Shkodrës, ku madhësia mesatare e njësisë është pothuaj 15.000 banorë pa

llogaritur qytetin e Shkodrës. Njësitë e rrethit të Pukës janë më të vogla, me një mesatare prej 6.224 banorësh ose 22% më të vogël se mesatarja kombëtare.

Dendësia mesatare e popullsisë është 147 banorë/km², krahasuar me 97,4 banorë/km² në rang vendi. Dendësinë më të madhe e ka natyrisht Shkodra, me mbi 2.400 banorë për km²; por dendësi të lartë kanë edhe qendra, si Rrethinat (487 banorë/km²) dhe Kopluku (285 banorë/km²). Megjithatë, gjysma e njërive të qarkut kanë dendësi më të ulët se 47 banorë/km².

Pesha specifike e rajonit të Shkodrës ndaj PBB-së kombëtare në vitin 2011 është 6,07%, ndërsa PBB për frymë në këtë qark është 20% më e ulët se mesatarja kombëtare, me 2583 Euro për banor sipas të dhënave të popullsisë së Census-it 2011.

Po të shohim strukturën e PBB-së për qarkun e Shkodrës, vërejmë se sektori i bujqësisë dominon strukturën e PBB-së lokale, me peshë specifike prej 26% në vitin 2011, i ndjekur nga sektori i shërbimeve, përfshirë tregtinë, hotelet, transportin dhe telekomunikacionin (23%) dhe sektorin financiar të pronave (19%). Industria dhe ndërtimi sjellin më pak se 20% të vlerës së shtuar bruto në këtë qark.

Prodhimi i brendshëm bruto: Pesha specifike e rajonit të Shkodrës ndaj PBB-së kombëtare në vitin 2011 është 6,07%, ndërsa PBB për frymë në këtë qark është 20% më e ulët se mesatarja kombëtare, me 2583 Euro për banor sipas të dhënave të popullsisë së Census-it 2011.

Sipërmarrja dhe bizneset: Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në Shkodër janë të rregjistruara mbi 8.950 biznese, ndër të cilat rreth 7.300 në rrethin e Shkodrës. Vetëm në qytetin e Shkodrës janë të rregjistruara mbi 62% e bizneseve të të gjithë qarkut, si edhe 62% ose 660 biznese të mëdha e të mesme të qarkut. 47% e bizneseve operojnë në fushën e tregtisë, 17% janë hotele dhe restorante, ndërsa rreth 4% në fushën e pasurive të paluajtshme. Ndërkohë, sipas të dhënave të tatimeve, të cilat rregjistrojnë numrin e bizneseve aktive (pra që paguajnë tatim), rrethi i Shkodrës rezulton të ketë rreth 2.400 biznese ose 4,8% e bizneseve në shkallë vendi, si edhe 1.072 biznese të mesme e të mëdha (subjekt i tatimit mbi fitimin) që janë rreth 4,7% e bizneseve të mëdha në shkallë vendi.

Të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël (tatim fitimi nga 1 janar 2014) kanë ulje nga viti 2009, me një rënie drastike në vitin 2012. Në vitin 2012 të ardhurat nga kjo taksë janë mesatarisht 97 lekë për frymë, me një ulje mbi 30% nga një vit më parë. Kjo ulje në vlerat mesatare duket të ketë ardhur nga realizime më të dobëta në të gjitha njësitë, përfshirë edhe bashkitë e Shkodrës dhe Pukës, ku realizimi i vitit 2012 është pothuajse sa gjysma e një viti më parë.

Komuna e Velipojës është e vetmja që ka rritje të konsiderueshme të të ardhurave për frymë në vitin 2012. Ndërkohë, mbi gjysma e njësisive kanë të ardhura për frymë më të ulëta se 32 lekë dhe 9 njësi nuk e mbledhin taksën (dhe/ose nuk kanë biznese).

Profili Social

Gjeografia dhe Popullsia

Qarku i Shkodrës ka 33 njësi administrative. Popullsia është 211.685 banorë.

- Qarku i Shkodrës ka pësuar gjithashtu rënie në numrin e popullsisë në krahasim me 2001 (-17%). Zonat urbane kanë pësuar zvogëlim me (-2, 6%), ndërsa ato rurale një rënie me -26%. Dendësia gjithashtu ka rënë (-17%).
- Qarku i Shkodrës numëron 54.429 familje.
- Popullsia rinore (15 - 29 vjeç) përbën rreth 24, 3% të popullsisë. Popullsia në moshë pune 15 - 64 përbën 66%, ndërsa moshë e tretë (mbi 65 vjeç) është rreth 12, 4%.
- 5, 7% e popullsisë janë persona me aftësi të kufizuara.
- Shpërndarja e popullsisë në qarkun e Shkodrës sipas gjinisë është 49, 8% meshkuj dhe 50,2% femra.
- Popullsia në moshë pune është 65, 9% e totalit të popullsisë së qarkut.
- Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun e Shkodrës janë 18.942 persona të regjistruar si të papunë, nga këta persona, 1.395 përfitojnë pagesë papunësie.
- Sipas rezultateve të Census-it 2011 popullsia migruese e kthyer në qarkun e Shkodrës prej vitit 2001 deri më 2011 është 7893 persona, ku 69,2% e të kthyerve janë meshkuj.

Strehimi

- 54.429 familje, 48.027 banesa në pronësi ose në proces pronësimi, 1.618 me qera, 4.784 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Shkodrës ka mesatarisht 3, 09 dhoma – treguesi i dytë më i lartë në Shqipëri pas Lezhës.
- 2.059 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 14.787 kanë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 53.399 banesa të banuara) ose rreth 31,5% nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm – treguesi më i lartë në vend që tregon për gjendjen e keqe të furnizimit me ujë në qarkun e Shkodrës.
- Rreth 5.407 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër (nga 53.399 banesa të banuara) ose 10, 1%.

Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Shkodrës shënon një nivel varfërie prej 15, 7%. Thellësia e varfërisë është 3, 7% dhe ashpërsia 1, 6%. Tregues të lartë varfërie krahasuar me vlerat kombëtare.
- Nga ana tjetër, 15.433 janë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Shkodrës ose rreth 15, 8% në rang vendi (viti 2010). Në rang qarku, ky numër është i barabartë me rreth 28, 3% të totalit të familjeve.
- Koeficienti GINI për qarkun e Shkodrës është 28, 2.
- Konsumi total për familje në qarkun e Shkodrës është 50.406 lekë, krahasuar me konsumin për person që është 11.953 lekë.

Shëndetësia

- 12.318 është numri i personave me aftësi të kufizuar të moshës mbi 15 vjeç, e barabartë me rreth 7, 87%.
- 2 spitale me 653 shtretër, si dhe 119 qendra shëndetësore.

- Në qarkun e Shkodrës kemi një numër total mjekësh prej 225.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt në zonat urbane është 18 minuta, ashtu sikurse edhe në zonat rurale, 18 minuta.
- Sipas ndarjes në të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt është 18 minuta për jo të varfërit dhe 20 minuta për të varfërit.

Arsimi

- Rreth 5.284 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç, e barabartë me 2,8%.

Tabela 1. Shërbimet

	Publike	Jo Publike
Shërbime sociale për të moshuar	1	2
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	4
Shërbime sociale për fëmijët	3	13
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	0	9
Shërbime sociale për PAK	1	6
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	3
Gjithsej	5	37

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF

Sektorët Prioritarë për Zhvillimin e Qarkut Shkodër

Sektorët e mëposhtëm janë prioritarë për zhvillimin e Qarkut të Shkodrës:

- Arsimi, Trajnimi dhe Ndërtimi i Kapaciteteve
- Infrastruktura dhe Shërbimet
- Mbrojtja nga Përmbytjet
- Turizmi dhe Agrobiznesi

Turizmi dhe Agrobiznesi

Turizmi dhe agrobiznesi mbeten gjithashtu dy prej sektorëve të ekonomisë të cilët gërshetojnë potencialet e burimeve natyrore, avantazhet e pozitës gjeografike, traditën e rajonit por gjithashtu edhe interesin në rritje të aktorëve dhe partnerëve të rëndësishëm për rajonin.

Një tjetër element mjaft i rëndësishëm për rolin e të dy sektorëve në ekonominë e rajonit dhe cilësinë e jetesës së komunitetit rezident në të, është potenciali i tyre për të mbështetur zhvillimet në sektorët e tjerë (p.sh. industria e përpunimit, shërbimet etj.) duke i bërë të diversifikojnë strukturën e aktivitetit ekonomik të qarkut dhe duke eliminuar mbi-përqendrimin e burimeve në një apo dy sektorë të vetëm.

Pozita gjeografike e rajonit mundëson projeksione që favorizojnë zhvillimin e sektorit të agrobiznesit.

Gjithashtu, investimet në rrjetin kombëtar të infrastrukturës lehtësojnë ndjeshëm qasjen tek tregjet kombëtare dhe rajonale, ndërkohë që për këto të fundit një tjetër avantazh përbën edhe Marrëveshja për tregtinë e lirë (CEFTA) dhe pjesa e MSA që rregullon marrëdhëniet tregtare me BE.

Turizmi dhe agrobiznesi do të diversifikojnë ekonominë e rajonit, do të mbështesin zhvillimin e sektorëve të tjerë dhe do të sigurojnë pozita të qëndrueshme në tregun rajonal ndërkohë që do të tregtohen në nivel ndërkombëtar.

Në mënyrë të përmbledhur analiza për potencialet e zhvillimit të turizmit në këtë qark do jepej në një matricë SWOT si më poshtë:

Anët e forta për zhvillimin e turizmit	Anët e Dobëta
<ol style="list-style-type: none"> 1. Atraksione natyrore të pashfrytëzuara 2. Burime ujore të shumta 3. Biodiversiteti i pasur 4. Pozita gjeografike e favorshme 5. Rajon ndërkufitar/ 3 pika kufitare 6. Traditë në turizmin malor 7. Klima e përshtatshme 8. Ekzistenca e planeve të veprimit në mjedis 9. Prania e universitetit/ dega turizëm 10. Tradita e kultivimit të luleve/artizanati 11. Kultura në mikëpritje 12. Folklori 13. Vlera Historike dhe Arkeologjike 14. Pyje 15. Tokë Bujqësore e Sistemuar 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndotja e mjedisit nga mbetjet urbane 2. Mungesa e menaxhimit të mbetjeve 3. Dobësi në ndjeshmërinë për mbrojtjen e mjedisit 4. Cilësi e dobët e shërbimeve turistike 5. Marketing i dobët 6. Infrastruktura e dobët 7. Mungesë urbanizimi në plazh Velipoje 8. Mungesa e ujësjellësve të ujit të pijshëm 9. Mungesa e strukturave akomoduese 10. Mosshfrytëzimi dhe copëzimi i tokës bujqësore 11. Keqmenaxhimi i pyjeve 12. Organizim i pamjaftueshëm i tregëtimit të produkteve bujqësore 13. Mosaplikimi i kontrollit të standardeve të produkteve 14. Mungesa e specializimit Profesional 15. Mungesa e bashkërendimit të sektorit privat me atë publik 16. Dobësi të zbatimit të ligjeve 17. Promovimi i dobët i rajonit 18. Mungesa e sistemit të informimit 19. Mungesa e çertifikimit të produkteve
Kërcënimet	Shanset
<ol style="list-style-type: none"> 1. Konkurrenca e vëndeve fqinje 2. Problemet e pronësisë 3. Pritshmëri të gabuara në raport me ofertën 4. Mungesë e stabilitetit politik në Ballkan 5. Përmbytjet 6. Rënia e kërkesës së tregut 7. Epidemi 8. Krizë Ekonomike 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mjedis pa ndotje industriale 2. Diversitet i kushteve natyrore 3. Mundësi oferte të bashkërenduar e burimeve natyrore dhe kulturore 4. Organizimi i ngjarjeve publike 5. Mbrojtja, zhvillimi dhe shfrytëzimi me teknologji moderne i pyjeve 6. Krijimi i pistave të skive në zonat malore 7. Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike 8. Përmirësimi i funksionimit të strukturave lokale për Turizmin dhe bujqësinë 9. Koordinimi i mire i entit të turizmit me strukturat lokale 10. Prodhimi BIO 11. Përmirësimi i ofertës së produktit endemik bujqësor e medicinal

PROFILI KOMUNËS KASTRAT

Pozita gjeografike

Komuna e Kastratit ndodhet në skajin verior të Republikës së Shqipërisë, në territorin administrativ të Malësisë së Madhe, në Prefekturën e Qarkut Shkodër dhe kufizohet:

Veri: Republika e Malit të Zi dhe Komuna e Kelmendit me Bjeshkët e Hotit.

Jug: Komuna e rrethinave të Koplikut me vijë ndarëse Përroi i Thatë.

Lindje: me Komunën e Shkrelit.

Perëndim: me Liqenin e Shkodrës.

Sipërfaqja e Komunës është 133 km²; nga këto zona fushore zë 76 km² dhe ajo male 57 km².

Komuna e Kastratit ka një shtrirje Veri-Jug 21,2 km dhe shtrirje Lindje-Perëndim, nga Liqeni I Shkodrës deri në zonat e populluara, rreth 6,33 km. Qyteti i Bajzës, qendra e komunës, ka një sipërfaqe prej 42 ha nga ku vetëm stacioni ndërkombëtar hekurudhor zë 16,8 ha. Qendra e Bajzës ka 17, 7 ha sipërfaqe. Banesat shoqërore zënë 7, 3 ha; komplekse dhe sheshe sportive 9, 3 ha; rrugë e trotuare 6, 9 ha dhe sheshi i Qytetit Bajzë zë 0, 72 ha.

Popullsia

Komuna Kastrat përbëhet nga popullësi të etnisë Shqiptare ku 90 % i përkasin besimit katolik dhe 10 % atij musliman.

Në Komunën Kastrat numri mesatar i lindjeve është 15-16 lindje në muaj ose rreth 190 lindje në vit. Numri mesatar i vdekjeve është 5-6 vdekje në muaj ose rreth 70 vdekje në vit.

Zona turistike

Komuna Kastrat ka mundësi të mira për zhvillimin e turizmit. Pjesë të ndryshme të territorit të saj janë të pasura me bukuri natyrore mjaft tërheqëse. Pjesa më e favorshme për zhvillimin e turizmit

është bregu i liqenit të Shkodrës dhe në mënyre te veçantë Syri i Sheganit dhe Syri i Zi nga të cilët buron ujë shumë i ftohtë, si dhe pjesa shkëmbore e malit përgjatë një pjese të bregut të tij kryesisht në fshatin Gashaj. Këtu mund të zhvillohen sporte ujore. Kësaj pjese i mungon infrastruktura.

Bjeshka e Granazhdolit, 930 m mbi nivelin e detit, si dhe Fushë Zeza e cila shtrihet rreth 1.000 m mbi nivelin e detit janë vende të përshtatshme për turizëm veror dhe dimëror duke ofruar peisazhe të pasura me natyrë të bukur malore. Vendi është i rrethuar me ahe dhe pisha dhe ka ajër të pastër dhe të freskët.

Shërbimi Telefonik

Shërbimi telefonik fiks i ofruara nga Albtelecom ofrohet sipas tarifave të përcaktuara nga Albtelecom. Në Bajzë është zyra e PTT. Aty shërbehen thirrje me brenda dhe jashtë vendit.

Tabela 2. Tarifa e shërbimit telefonik për rrjetin fiks - Burimi Albtelecom

Distancë e bisedimit	Lek për 1 min/bisedë
0-20 km	20 lek / min
20-30 km	30 lek / min
30-50 km	40 lek / min
Mbi 50 km	50 lek / min

Tabela 3. Telefonat Fiks. Tarifa e Shërbimit ndërkombëtar - Burimi Albtelecom

Nr	Zona / vendi	Lek për 1 minutë / bisedë
1	Zona I (Greqi, Itali, Maqedoni)	90 lek / min
2	Zona II (Vendet Evropiane mesdhetare)	160 lek/min
3	Zona III (Vendet të tjera)	270 lek / min

Në komunë kapen edhe valët e Vodafone dhe AMC, por rrjetet më të përdorshëm janë Malazezët, nga rreth 85% e përdoruesve.

Ndërkohë një informacion i detajuar për paketat tarifore për shërbimin telefonik fiks, celular dhe internetin sipas operatorëve kryesore ofrohet nga AKEP në rubrikën për konsumatorin. Bie në sy që numri i paketave tarifore të ofruara në treg është shumë i madh rreth 100 paketa që janë të kombinuara për shërbim telefonik dhe data ose internet.

KOMUNA KELMEND

Komuna e Kelmendit me karakteristikat e saj kulturore, territoriale është një nga zonat më të bukura të Shqipërisë. Banorët e kësaj zone kanë dhe kanë pasur lidhje të vazhdueshme me një pjesë të madhe të banorëve në territoret që ndodhen rreth saj dhe më gjerë.

Vlerat e veçanta natyrore peisazhistike, klimatike dhe tradita kulturore kanë bërë që kjo zonë të jetë një pikë referimi për mjaft vizitorë dhe një potencial i madh për zhvillimin e turizmit malor.

Duke u nisur nga llojshmëria e vlerave të zonës, institucionet vendore dhe rajonale gjithmonë e kanë klasifikuar atë si një zonë të veçantë që duhet ti nënshtrohet një regjimi të vecantë juridik nga aspekti i ruajtjes dhe zhvillimit të vlerave natyrore dhe kulturore.

Pozicioni gjeografik

Komuna e Kelmendit ndodhet në skajin verior të Republikës së Shqipërisë, në territorin administrativ të Malësisë së Madhe, të Prefekturës së Qarkut Shkodër, dhe në kufi me Republikën e Malit të Zi.

Ajo ndodhet ndërmjet koordinatave gjeografike 42° 24' 22" Qafa e Kapës-Broje e 42° 39' 45" maja e Zhihovës- Vermosh, gjerësi gjeografike veriore 19° 30' 12" kufiri shtetëror, bregu i Cemit e 19° 15' 01" liqenet e Jezercës në gjerësi gjeografike lindore. Ka shtrirje 24 km në drejtimin veri- jug, dhe 245 km në atë lindje -perëndim.

Burimet natyrore

Burimet e komunës janë të shumëllojshme dhe përbëjnë potencialin kryesor të zhvillimit të komunës. Malet dhe bjeshkët, bimësia dhe ujrat sipërfaqësore përbëjnë burimet natyrore kryesore të komunës.

Bjeshkët e Sefercës zënë skajin më verior të Kelmendit dhe kanë një sipërfaqe prej 6.6 km² dhe lartësi 1600 m mbi nivelin e detit. Në këto bjeshkë relievi është mjaft i valëzuar, klima është e ashpër, ka 17 burime uji, mbulesë floristike ndër më të pasurat në Alpe, 10,172 ha me bar alpin dhe 953 ha pyje.

Bjeshkët përbëhen nga dy kurrize ai Zhihovës dhe Marlulës dhe nga Lugu i Harushës. Kurrizi i Zhihovës ngrihet uniform si kufi administrativ dhe shtetëror, ka disa maja dhe qafa të emëruara si ajo e Mojanit 2.195 m, qafa e maja e Gjelijt 2.156 m, e Zhihovës 2.174 m.

Bjeshkët e Namuna zënë qendrën e Alpeve Shqipëtare duke pasur si kufi qafa e fshatra alpine. Në përfundim këto bjeshkë kufizohen me qafën e Vajushës, Lepushës, Jamës, Nikçit, Vuklin dhe pllajen karstike të Veleçikut, në jug me qafën e T'thores, Thethin, qafën e Valbonës dhe qafën e Valbonës së vogël. Në këtë zonë ndodhen rreth 70 maja pa emër nga ku 42 maja janë në lartësinë 2.000-2.300 m, 22 maja në lartësinë 2.300-2.500 m dhe pesë maja të tjera në lartësinë mbi 2.500 m mbi nivelin e detit. Maja më e lartë është Jezerca me 2500m që quhet çatia e Alpeve.

Blloku i Shenikut, shtrihet në veriperëndim të Bjeshkëve të Namuna, ka një sipërfaqe prej 31.2 km² dhe përbëhet nga kreshta shumë të ashpra në formë "S" ku numërohen 17 maja mbi 2.000 m. Maja më e madhe ka lartësi prej 2552.9 m dhe është mbizotëruese në bllokun e Shenikut. Në këtë zonë ndodhet edhe Koprishti i Ujk Carës që përbën një çift gropash që paraqesin interes si nga përmasat ashtu dhe për kullotat e pasura verore me sipërfaqe 125 ha.

Popullsia

Komuna e Kelmendit nga pikëpamja etnike është e përbërë nga popullsia shqiptare. Popullsia i përket besimit katolik në shumicë absolute. Ka vetëm disa familje të besimit musliman në fshatin Nikç.

Shëndetësia

Tabela 4. Të dhëna për shëndetësinë sipas fshatrave

Nr	Fshati	Objekti	Numri i Punonjësve	Infermiere, mami	Mjekë
1	Vermosh	Qendër shëndetësorë	3	3	-
2	Lëpushë	Ambulancë	1	1	-
3	Selcë	Ambulancë	1	1	-
4	Tamarë	Qendër shëndetësorë	6	5	1
5	Brojë	Ambulancë	1	1	-
6	Vukël	Ambulancë	2	2	-
7	Nikç	Ambulancë	1	1	-
TOTAL			15	14	1

Arsimi

Arsimi në komunë dominohet nga arsimi 8-vjeçar. Ka vetëm një shkollë të mesme e cila gjendet në fshatin Tamarë.

Bashkëpunimi në Projekte në Qarkun e Shkodrës

Bashkëpunimi dhe partneriteti mbeten në thelb të gjithë përpjekjeve zhvillimore dhe rrjedhimisht, mjaft të rëndësishme edhe për suksesin e konceptit të zhvillimit rajonal. Jo vetëm pozita gjeografike por edhe lidhjet tradicionale me rajone përtej kufijve shtetërorë përfshijnë në vetvete nevojën e konsolidimit të bashkëpunimit me rajonin ndërkufitar të Malit të Zi, bashkëpunimit me rajonin ndërkufitar të Malit të Zi.

Bashkëpunimi ndërkuftar me Malin e Zi ka shënuar ritme pozitive veçanërisht gjatë dekadës së fundit dhe tashmë duket se janë materializuar qartazi eksperiencat e partneritetit jo vetëm në shkëmbimet socio-kulturore apo ekonomike.

Gjithsesi, mbeten ende hapësira për të intensifikuar këto partneritete dhe për t'i shtrirë ato edhe në rajone të tjera jo vetëm në këto dy vende por edhe përtej (Kosova). Bashkëpunimet dy dhe shumë paleshe në kuadër të instrumenteve dhe programeve të ndryshme të Bashkimit Evropian tashmë pritet të futen në një stad të ri me marrjen e statusit kandidat nga të dy vendet, çka nënkupton mundësi të reja përfitimi në kuadër të të pestë komponentëve të asistencës së para-anëtarësimit (IPA).

Nga ana tjetër, instrumentet e BE shihen si një mundësi për të adresuar sfidat dhe prioritetet e përbashkëta midis qarkut të Shkodrës dhe Lezhës, veçanërisht duke nxitur zhvillime të reja në përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimit rural (me hapjen e komponentëve të tjerë të IPAs).

Krahas këtyre sektorëve, nevoja për bashkërendim dhe përpjekje të përbashkëta shihet si mjaft e rëndësishme edhe në sektorë të tjerë prioritarë, të përbashkët apo komplementarë, duke siguruar kështu një zë akoma më të fuqishëm në proceset politikëbërëse edhe në nivel kombëtar.

Të gjithë këta elementë e vendosin konsolidimin e bashkëpunimit – me rajonet kufitare malazeze – në qendër të vëmendjes të autoriteteve në favor të përcaktimit të prioritetëve rajonale dhe operacionalizimit të masave zbatuese për zhvillimin rajonal e në veçanti për zhvillimin social-ekonomik të qarkut Shkodër.

Ka një sërë faktorësh dhe premisash të cilat i japin qarkut të Shkodrës një pozicion parësor në nxitjen dhe konsolidimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar. Duke qenë një rajon kufitar, me një traditë të hershme të shkëmbimeve dhe bashkëpunimit ekonomik por jo vetëm ekonomik, me rajonet e vendeve të tjera dhe aktualisht, një rajon i cili është në fokusin e disa programeve evropiane të bashkëpunimit ndërkuftar (SEE, IPA Adriatik, IPA CBC etj.) Shkodra është njëherazi edhe një rajon i synuar nga një numër aktorësh publikë dhe private.

Shkodra si një nga qendrat kryesore të jetës akademike në vend dhe gjithashtu një qendër e rëndësishme për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore të rajonit dhe më gjerë, në funksion të sfidave të zhvillimit social – ekonomik, ofron inpute të vlefshme dhe me përfitime në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar. Gjithashtu, me një sektor të shoqërisë civile në zhvillim e sipër i cili në vazhdimësi ka gërshetuar kontributet e veta me përpjekjet e partnerëve rajonalë, qarku i Shkodrës merr pozitën e një rajoni i cili mund të ndërveprojë si partner i barabartë në kontekstin e partneriteteve mbarë-rajonale.

Në përfundim të analizës në Qarkun e Shkodrës në lidhje me situatën e përgjithshme social ekonomike, demografike, pozitës gjeografike konkludojmë se, ***turizmi dhe agrobiznesi mbeten dy prej sektorëve kryesorë të qarkut Shkodër, zhvillimi i të cilëve pashmangshmërisht lidhet me perspektivën e përgjithshme zhvillimore të qarkut.*** Bujqësia mbetet sektori kryesor që gjeneron të ardhura në zonat rurale, me një potencial për të nxitur gjithashtu edhe industrinë e përpunimit, ndërkohë që turizmi si sektor gjen ende hapësira të konsiderueshme për zhvillim të mëtejshëm.

Sipas Strategjisë së Turizmit të Qëndrueshëm të Qarkut Shkodër “***Eksplorimi i Alpeve Shqiptare***” është një nga paketat e propozuara për zhvillimin e turizmit. Kjo paketë turistike propozon zbatimin e projekteve të mëposhtëme:

Eksplorimi i Alpeve Shqiptare

- Përmirësimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve turistike
- Nxitja e konkurrencës në nivelet më larta të cilësisë dhe kategorizimi i operatorëve turistikë dhe i strukturave të akomodimit sipas standardeve ndërkombëtare të turizmit
- Rritja e arsimimit dhe e trajnimeve në sektorët që lidhen me turizmin
- Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në zonat malore
- Aktivitetet e qëndrueshme turistike në liqene
- Përfshirja e produkteve karakteristike në ofertën turistike rajonale
- Paketat e integruara të mikëpritjes
- Njohja, ruajtja, restaurimi dhe kualifikimi i vlerave historike

- Mbrojtja, vlerësimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm i zonave dhe i peisazheve natyrore dhe ruajtja e biodiversitetit
- Përmirësimi i rrjeteve të transportit për të rritur aksesin territorial në zonat turistike
- Promovimi i energjisë së rinovueshme dhe i kursimit të energjisë në zonat turistike
- Shërbimi emergjent mjekësor për turistët

Konektiviteti Broadband dhe infrastruktura TIK janë komponentë të rëndësishëm direkt dhe indirekt për realizimin e paketës së mësipërme. Konektiviteti është pjesë përbërëse e komponentit të parë: Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve, ndërkohe lidhet dhe indirekt ndikon në realizimin me sukses të gjithë komponentëve të tjerë.

3. QARKU KUKËS

Profili i qarkut Kukës

Qarku i Kukësit ndodhet në pjesën veri-lindore të vendit. Qarku kufizohet në anën e tij lindore me Maqedoninë dhe Kosovën, në veri me Malin e Zi, në perëndim me qarqet SHKODËR dhe Lezhë dhe në jug me Qarkun e Dibrës. Kukësi karakterizohet nga modele terreni të vështira. Lartësia mesatare e qarkut është e 680 metra mbi nivelin e detit. 41% e popullsisë jeton në zonat e maleve të ulët (mes 301 dhe 500 metra) dhe pjesa tjetër në zonat malore dhe ato me lartësi mesatare (501-800m). Qarku është shumë i pasur në mjedise ujore dhe burime hidrike. Aty bëhet grumbullimi i të gjitha rrjedhave dhe lumenjve që derdhen në Lumin Drin, që nga Liqenet e Prespës dhe Pogradecit, Bjeshkët e Namuna e deri tek bashkimi i Lumit Drin me Lumin Buna. Liqeni i Fierzës është qendra e të gjitha rrjedhave dhe mjediseve ujore dhe shumë i përshtatshëm për rritjen e peshve të llojeve të ndryshme.

Pasuritë ujore të rajonit përdoren edhe si burime energjie. Rajoni është i pasur me minerale të shumta metalore (sidomos krom, dhe më pak Nikel-Silikat, Hekur Nikel e bakër) dhe jo metalore

(kuarc, mermer). Lidhja me Tiranën bëhet nëpërmjet rrugës nacionale Kukës – Tiranë, me gjatësi 144 km dhe pershkohet për 120 minuta.

Me aeroportin e Rinasit rajoni lidhet me rrugën nacionale KUKËS – Vorë – Rinas, me gjatësi 124 km e cila pershkohet për 90 minuta. Distancat e rajonit nga portet kryesore të vendit, Durrës dhe Vlorë janë përkatësisht 160 km (135 min) dhe 291 km (300 min). Qarku ka akses në dy pika doganore; atë të Morinit nëpërmjet rrugës nacionale Kukës – Morin, me gjatësi 20.5 km dhe distancë kohore 20 minuta; dhe doganën Qafe Prush – rruga nacionale Kukës – Krume – Qafë Prush, me gjatësi 55 km e cila pershkohet për 90 minuta. Popullsia e rajonit sipas regjistrimit të fundit në Tetor të 2011, rezulton të jetë 85,239 banorë.

Qarku i Kukësit përbëhet nga 27 NJQV në tre rrethe: rrethi i Hasit (4 njësi, qendër Krumë); rrethi i Kukësit (15 njësi, qendër Kukës) dhe rrethi i Tropojës (8 njësi, qendër Bajram Curri). Lista e plotë e NQV-ve të Qarkut Kukës jepet në Aneksin 1 në fund të këtij studimi.

Popullsia e qarkut të Kukësit ishte 85.292 banorë në vitin 2011, ndër të cilët 56% (47.895 banorë) jetojnë në rrethin e Kukësit, 24% (20.517) jetojnë në rrethin e Tropojës dhe rreth 20% (16.790 banorë) jetojnë në rrethin e Hasit. (INSTAT, Census 2011). Qarku i Kukësit ka pasur një humbje neto të popullsisë prej rreth 23% ose mbi 25.000 banorë krahasuar me të dhënat zyrtare të Regjistrimit të Gjendjes Civile të vitit 2011. Sipas të dhënave zyrtare të RGJC-së në Janar 2012 në qarkun e Kukësit ishin të regjistruar 110.826 banorë, me përqendrim shumë të ngjashëm sipas rretheve me atë të raportuar nga Censusi 2011. Në Aneksin 2 jepet situata e ndryshimeve të popullsisë në këtë qark sipas INSTAT dhe RGJC në vitin 2011.

Popullsia e qarkut Kukës përbën më pak se 4% të popullsisë së vendit, referuar të dhënave të Census-it 2011 dhe popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 3.159 banorë/NJQV, ose 60% më e ulët se mesatarja kombëtare prej 8.016 banorë/NJQV. Rrethi i Tropojës ka mesataren më të ulët të popullsisë në qark. Njësitë më të vogla janë Arrën dhe Kalis në Kukës (më pak se 1.300 banorë së bashku).

Dendësia mesatare e popullsisë është çuditërisht më e lartë se kombëtarja: 141 banorë/km²

përkundrejt 97, 4 banorë/km² në rang vendi. Megjithatë, shumica e njësisve kanë dendësi shumë të ulët: gjysma janë nën nivelin 28 banorë/km², ndërkohë që dendësia mesatare e komunave është 33 banorë/km². Zonat urbane kanë dendësi më të lartë, si qyteti i Kukësit (1222 banorë/km²), Bajram Currit (1749 banorë/km²), ndërkohë që Kruma ka dendësi të ulët (81 banorë/km²).

Pesha e njësisve të qarkut Kukës në totalin e shpenzimeve vendore është rreth 2,8% në vitin 2012, me një rritje të lehtë krahasuar me vitet paraardhëse (2,5%, përfshirë edhe rritje në vlerë absolute). Shpenzimet operative zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale në qarkun e Kukësit, mesatarisht pothuajse 70% në vitet 2008 - 2012 dhe 65% në vitin 2012. Ndër këto, shpenzimet për personelin janë më shumë se gjysma e shpenzimeve operative gjithsej, ose mesatarisht 38% e shpenzimeve totale të NJQV-ve të qarkut. Shpenzimet kapitale kanë një peshë specifike prej 31% në strukturën totale, ose 35% në vitin 2012, me rritje në krahasim me 2011 (29%). Ky raport është më i ulët se raportet kombëtare prej 34% në 5 vite, por më i lartë për vitin e fundit (26% në vitin 2012 në nivel kombëtar). Bashkia e Kukësit, e cila ka rreth 19% të popullsisë së qarkut, zë një peshë prej rreth 26% në totalin e shpenzimeve të njësisve të qarkut, por vetëm 19% në shpenzimet për investime. Ndërkohë, pothuajse gjysma (49%) e të ardhurave të veta të qarkut të Kukësit gjenerohen në bashkinë Kukës.


Spektori i shërbimeve publike (që përfshin shërbimet e pastrimit e të ngjashme) zë pjesën dërrmuese të shpenzimeve edhe në qarkun e Kukësit, me rreth 63% të shpenzimeve, i ndjekur nga sektori i transportit (që përfshin infrastrukturën rrugore dhe mirëmbajtjen e saj) me rreth 23% mesatarisht.

Figura 1. Shpenzimet sipas sektorëve (funsioneve) në NJQV-të e qarkut Kukës




Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Kukës përbëjnë rreth 3, 5% të totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri. Në vitin 2009 të ardhurat janë më shumë se trefishuar në krahasim me vitin 2008, por kanë rënë gradualisht çdo vit në vitet 2010 - 2012 në vlerë absolute.

Figura 2. Të ardhurat e NJQV-ve të qarkut Kukës kundrejt totalit të të ardhurave vendore në Shqipëri



Të ardhurat nga burimet e veta përbëjnë më pak se 8% të totalit në qarkun e Kukësit, ndërkohë që në vitet 2009 - 2012 mbi 60% e të ardhurave vijnë nga transfertat e kushtëzuara. Në vitin 2012 të ardhurat nga burimet e veta përbënë 6%, ndërkohë që ka pasur një rritje të transfertës së pakushtëzuar (32%).

Figura 3. Përbërja e të ardhurave të NJQV-ve në qarkun e Kukësit



Të ardhurat: Njësia me buxhet (të ardhurat totale) më të madh është natyrisht bashkia e Kukësit (178 milionë në vitin 2012). Qyteti i Kukësit ka një peshë specifike prej 12% në buxhetin total të njësive të qarkut, ndërsa realizon rreth 49% të të ardhurave të veta totale. Bashkitë e tjera të qarkut si Bajram Curri dhe Kruma kanë buxhete më modeste rreth 7% të buxhetit total të njësive të Kukësit, ndërsa realizojnë përkatësisht 20% dhe 9% të të ardhurave të veta totale për njësitë e qarkut Kukës. Në përgjithësi komunat e qarkut realizojnë të ardhura modeste në përpjesëtim me popullsitë përkatëse.

Mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në NJQV-të e qarkut Kukës ulet nga 453 lekë (3,2 Euro) në vitin 2009, në rreth 290 lekë (2 Euro) për frymë në vitin 2011 dhe rritet në 485 lekë në vitin 2012 (3,5 Euro). Mesatarja e të ardhurave të veta për frymë në nivel kombëtar është përkatësisht 27 Euro dhe 25,4 Euro të mesatares kombëtare në 2009 dhe 2012. Të ardhurat totale për frymë në Kukës janë 19 Euro në vitin 2009 dhe 17 në vitin 2012. Siç është përmendur edhe më lart, vetëm bashkia Kukës gjeneron pothuaj 50% të të ardhurave të veta në rang qarku, ndërkohë që të ardhurat e veta për frymë edhe në bashkinë Kukës janë vetëm 70% e mesatares kombëtare (në ulje nga 97% në vitin 2010).

Shpenzimet operative janë mjaft të larta në njësitë e qarkut Kukës, ashtu si dhe në përgjithësi në nivel vendi. Në veçanti, shpenzimet për paga e sigurime zënë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale për çdo njësi, duke variuar nga 32% (Margegaj) deri në 88% (Fajzë) në vitin 2012. Peshat relative të zërit të pagave në shpenzimet e përgjithshme operative është rritur në mënyrë të vazhduar nga viti 2010 në 2012-ën në thuajse të gjitha njësitë.

Zhvillimi ekonomik lokal dhe konkurrueshmëria e NJQV-ve në qarkun Kukës

Qeverisja vendore luan një rol jo pak të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik lokal. Në këtë seksion do të hedhim një vështrim mbi të dhënat për prodhimin e brendshëm bruto (PBB) për qarkun e Kukësit, të dhënat mbi forcën e punës dhe punësimin (për sa të dhënat janë të disponueshme), si edhe sipërmarrjen e zhvillimit të bizneseve, të cilat analizohen si nga pikëpamja e përqendrimit në qark, ashtu edhe nga pikëpamja e të ardhurave që gjenerojnë në nivel kombëtar si dhe për çdo njësi.

Prodhimi i brendshëm bruto: Peshat specifike të rajonit të Kukësit ndaj PBB-së kombëtare në vitin 2011 është më e vogla ndërsa në të gjithë rajonet me 2,44%, ndërsa PBB për frymë në këtë qark është 2623 Euro për banor sipas të dhënave të popullsisë së Censur-it 2011, ose 20% më e ulët se mesatarja kombëtare, por më e lartë se PBB për frymë në Dibër, Lezhë, Shkodër dhe Korçë.

Tabela 5. PBB totale dhe PBB për frymë sipas qarqeve

Qarku	PBB, çmime korrente (mln lekë)	Pesha specifike	PBB për frymë në lekë	PBB për frymë Euro	PBB për frymë si % e kombëtares
Shqipëria	2 800 138	100%	457 926	3271	100,0%
Dibër	137 047	3,1%	291 528	2082	63,7%
Durrës	262 785	9,4%	458 656	3276	100,2%
Kukës	85 292	2,4%	367 221	2623	80,2%
Lezhë	134 027	3,6%	349 385	2496	76,3%
Shkodër	215 347	6,0%	361 626	2583	79,0%
Elbasan	295 827	9,2%	400 484	2861	87,5%
Tiranë	749 365	36,3%	621 460	4439	135,7%
Berat	141 944	4,8%	431 071	3079	94,1%
Fier	310 331	9,9%	405 412	2896	88,5%
Gjirokastër	72 176	2,7%	473 537	3382	103,4%
Korçë	220 357	6,2%	364 077	2601	79,5%
Vlorë	175 640	6,3%	456 462	3260	99,7%

Figura 4. PBB për frymë si përqindje e PBB-së për frymë në nivel kombëtar



Po të shohim strukturën e PBB-së për qarkun e Kukësit, vërejmë se sektori i bujqësisë ka peshën më të lartë në PBB rajonale me 34%, i ndjekur nga tregtia dhe shërbimet (20%). Industria është veçanërisht e ulët në Kukës, me një peshë specifike vetëm 3%.

Ekonomia e rajonit ka levizur nga bujqësia drejt ndërtimit, industrisë dhe shërbimeve. Ka shumë pak subjekte të mëdha private në rajon. Shumica e bizneseve kanë më pak se 7 punonjës pjesa më e madhe e të cilave drejtohen nga një person ose janë biznese familjare. Sektoret ekonomike prioritarë dhe me potencial të rëndësishëm zhvillimi, rritje e ekonomike dhe punësimi janë; turizmi, sektori mineral dhe bimët medicinale.

Rajoni ka asete të mjaftueshme për të tërhequr turistët, veçanërisht burimet e jashtëzakonshme natyrore në majat e maleve, kullotat alpine, luginat e thella si dhe liqenet dhe lumenjtë spektakolar. Atraksionet që tërheqin më shumë turistë janë; Lugina e Valbonës, Liqeni i Fierzës, Liqeni i Komanit, Shishtaveci etj.

Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në Kukës janë të regjistruara 1.592 biznese, ndër të cilat 54 ose pak mbi 3% janë biznese të mesme e të mëdha. Pothuajse gjysma e numrit të përgjithshëm të bizneseve (si dhe e bizneseve të mëdha) operojnë në qytetin e Kukësit. Të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël (tatim fitimi nga 1 janar 2014) janë mesatarisht 34 dhe 37 lekë për frymë në vitin 2012 dhe 2011. Këto vlera janë ndjeshëm më të ulëta se mesatarja kombëtare prej 532 dhe 621 lekësh për frymë përkatësisht në 2012 dhe 2011. Shumica dërrmuese e njësive nuk mbledhin asnjë qindarkë nga kjo taksë prej vitesh, ndërkohë që edhe në njësitë ku mblidhet (kryesisht bashkitë) të ardhurat kanë rënë në mënyrë shumë të ndjeshme nga viti në vit, me përjashtim të Bajram Currit.

Të ardhurat nga taksat e biznesit për banorë (ish-taksa e biznesit të vogël ose tatimi mbi fitimin e thjeshtuar).

Profili social

1. Gjeografia dhe popullsia

- Qarku i Kukësit ka 27 njësi administrative. Popullsia është 83.276 banorë dhe 17.126 familje.
- Qarku i Kukësit gjithashtu ka pësuar rënie në numrin e popullsisë në krahasim me 2001 (-25%). Kemi një kontrast për sa i përket zonave urbane dhe rurale. Zonat urbane kanë pësuar rritje popullsie me 4,2%, ndërsa ato rurale një rënie të ndjeshme (-35%). Dendësia gjithashtu ka rënë (-25%).
- Popullsia rinore (15 – 29 vjeç) është 28,7% e popullsisë.
- Qarku Kukës ka dhe përqindjen me të ulët të moshës së tretë me 8,1%.
- Shpërndarja e popullsisë në qarkun Kukës sipas gjinisë është 50,5% meshkuj dhe 49,5% femra.
- Popullsia në moshë pune është rreth 65% (54.832). Sipas të dhënave të katërmujorit të tretë të vitit 2013, në qarkun e Kukësit janë 11.125 persona të regjistruar si të papunë, nga këta persona 1183 përfitojnë pagesë papunësie.
- Ndërkohë që popullsia emigruese e kthyer është 1.116 persona, ku 86% e zënë meshkujt.

2. Strehimi

- 17.126 familje, me 14.959 banesa në pronësi ose në proces pronësimi, 677 me qira, 1.490 jetojnë falas.
- Një banesë në qarkun e Kukësit ka mesatarisht 2,92 dhoma.
- 1,188 banesa të banuara janë pa furnizim me ujë, 1,495 kanë furnizim me sistem të llojit tjetër (nga 16.618 banesa të banuara) ose rreth 16,1% nuk kanë akses në furnizim me ujë të rrjedhshëm.
- Rreth 2805 banesa të banuara janë pa tualet ose me tualet të llojit tjetër (nga 16.618 banesa të banuara) ose 16,8% tregues këto nga më të lartët në vend.

3. Varfëria

- Sipas LSMS në 2012, qarku i Kukësit shënon një nivel varfërie prej 21, 8%. Thellësia e varfërisë është 3, 7% dhe ashpërsia 0, 9%. Siç shihet ky qark ka numrin më të madh të njerëzve që jetojnë nën nivelin e varfërisë.
- Nga ana tjetër 11 705 janë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në qarkun e Kukësit ose rreth 12% në rang vendi (viti 2010). Në rang qarku, ky numër është i barabartë me rreth 68, 3% të totalit të familjeve që e rendit në vendin e parë në Shqipëri.
- Koeficienti GINI për qarkun e Kukësit është 25, 6%.
- Konsumi total për familje në qarkun Kukës është 51.410 Lekë, krahasuar me konsumin për person që është 9860 Lekë për person.

4. Shëndetësia

- 7, 2% (6152 persona) e popullsisë, janë persona me aftësi të kufizuara nga ku gati 1% e zë grupmosha 0 - 15 vjeç.
- 3 spitale me 372 shtretër, si dhe 43 qendra shëndetësore.
- Në qarkun e Kukësit kemi një numër total mjekësh prej 76.
- Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt në zonat urbane është 15 minuta, ndërsa në zonat rurale 22 minuta.
- Sipas ndarjes në të varfër dhe jo të varfër, distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më e/i afërt është 19 minuta për jo të varfrit dhe 22 minuta për të varfrit.

5. Arsimi

- Rreth 1.593 analfabetë të moshës mbi 10 vjeç, e barabartë me 2,2%.

Tabela 6. Shërbimet

Llojet e shërbimeve	Publike	Jo Publike
Shërbime sociale për të moshuar	1	2
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	2
Shërbime sociale për fëmijët	0	4
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	1	10
Shërbime sociale për PAK	0	0
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	1
Gjithsej	2	19

Burimi: Harta e Shërbimeve Sociale në Shqipëri 2013 – MMSR dhe UNICEF

6. Turizmi

Qarku i Kukësit ka asete të mjaftueshme për të tërhequr turistët, veçanërisht burimet e jashtëzakonshme natyrore në majat e maleve, kullotat alpine, luginat e thella si dhe liqenet dhe lumenjtë spektakolar. Nga një anketim i realizuar në kuadër të strategjisë së turizmit dhe planit të veprimit për rajonin e Kukësit, me bizneset që operojnë në sektorin turistik, ka treguar se rajoni ka kapacitete turistike të pashfrytëzuara maksimalisht. Norma e zënies së shtretërve në hotele dhe shtëpitë pritëse është vetëm 17% në vit. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në rajon është 2.9 ditë. Shpenzimi për një ditë është 7.705 lekë pjesa më e madhe e të cilit shkon për akomodim, ushqim/pije dhe blerje.

Strategjia e turizmit të rajonit përfshin një plan strategjik gjithëpërfshirës për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, si dhe mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit në këtë qark. Ajo merr në konsideratë njëherazi fokusin e politikës së BE-së për zhvillimin e turizmit dhe atë të strategjisë kombëtare që në thelb të dyja kanë si synim promovimin e aktivitetit ekonomik në zonat rurale të privuara dhe rritjen e cilësisë së jetës atje. Strategjia e vendit thekson gjithashtu zhvillimin e turizmit natyror dhe kulturor.

Zhvillimi rajonal ka të bëjë me adresimin e nevojave dhe mundësive të gjithë territorit rajonal (në nivelin "meso"). E njëjta gjë vlen edhe kur e shikojmë zhvillimin nga perspektiva lokale. Teorikisht veprime të caktuara të zhvillimit mund të bëhen në nivel lokal si p.sh: marketingu i turizmit, trajtimi i mbetjeve, mbështetje për NVM-të. Por në shumë raste - dhe kjo është përvoja e shumicës të botës dhe sidomos e pjesës tjetër të Evropës - zgjidhjet lokale nuk do të jenë efikase, efektive apo të qëndrueshme në këto dhe shumë fusha të tjera. Shumë veprime kërkojnë të jenë të planifikuara, të përgatitura dhe shpesh herë të zbatuara për një zone reference më të madhe, pra në një nivel më të lartë territorial. Në Shqipëri, në situatën aktuale ky nivel më i lartë ose madhësi është territori i qarkut (rajoni). Pyetja se kush i financon veprimet është një çështje krejt tjetër: në parim burimet mund të vijnë nga autoritetet qendrore tek ato rajonale dhe lokale përmes mekanizmave të ndryshëm të transferimit dhe/ose mund të dalin nga burimet lokale.

KOMUNA MARGEGAJ

Komuna Margegaj ndodhet në veriperëndim të rrethit të Tropojës. Ajo kufizohet;

- Në Veri me Republikën e Malit të Zi përgjatë 30 km duke përbërë pjesën dërmuese të vijës kufitare të rrethit të Tropojës me këtë shtet,
- Në perëndim me rrethin Shkodër (komuna e Shalës/Thethi) përgjatë 10 km
- Në jug me komunën Bujan 24 km dhe bashkinë e Bajram Currit 5 km,
- Në lindje me komunat Tropojë përgjatë 25 km dhe Llugaj 2 km.

Komuna ka një sipërfaqe prej 269.4 km² duke qenë kështu ndër komunat me territorin më të madh në republikë.

Lugina e Valbonës: Lugina e Valbonës zë $\frac{3}{4}$ e Komunës Margegaj dhe bën pjesë në zemër të Alpeve lindore shqiptare. Ajo kufizohet me bllokun e Jezercës në J.P., luginën e Lumit të Gashit në V.L, me Vuthajt (Malin e Zi) në V. dhe gropën e Bajram Currit në J.L. Lugina fillon në kanionin e Shtrejtit, 220 m mbi nivelin e detit dhe përfundon në qafën e Valbonës në 1,600 m mbi nivelin e detit me një gjatësi prej 27 km. Pamjet e saj befasuese me bukuri të rralla natyrore kanë motivuar Qeverinë Shqiptare që 8,000 ha te saj të shpallen Park Kombëtar i kategorisë së dytë me VKM Nr

102 datë 15.01.1996. Lugina është natyrshëm edhe simboli i komunës. Ajo ka si drejtim kryesor aksin lindje- perëndim deri në fshatin Valbonë ku ndryshon drejtimin drejt jugut. Në zgjerimet e saj vendosen fshatrat Dragobi, Valbonë e Rrogam, kullat e të cilëve ndodhen përgjatë të gjithë brigjeve të Valbonës. Shpatet e maleve janë pothuaj të pingulta, me pamje fasadash që ngrihen mbi lum, me maja në formë kullash të veshura me drurë sipas kateve, me cirqet e tyre me deborë të përjetshme në një disnivel me shtratin e lumit që shkon deri në 1,700 m. Në përbërje të Luginës së Valbonës janë edhe Luginat e Motinës, Çeremit, Kukaje, etj që janë xhepa me pamje shumë të bukura.

Bjeshkët zënë gjithë pjesën veriore dhe veri-lindore të komunës. Bjeshkët e pjesës Veriore ngrihen prej luginës si shpate të buta të veshura me pyje dhe perfundojnë në livadhet e gjelbëruara alpine të majave të rumbullakosura me një lartësi mesatare prej 2,100 m mbi nivelin e detit. Kjo zonë është shumë e populluar gjatë sezonit të verës.

Bjeshkët e krahut Jugor të luginës kanë shpate shumë të pjerrët në formë fasadash me maja në formë kullash me borë të përjetshme dhe pyje e kullota alpine. Bjeshkët përmbajnë pasuri të mëdha që pëfshijnë:

- Burime të bollshme ujore dhe përrenj të vegjël
- 11,000 ha pyje me ah, panjë, frashër, bredh, pishë, dëllënjë etj,
- 7,000 ha livadhe alpine
- 9,750 ha shkëmbinj të zhveshur të kombinuar me dëborë të përjetshme dhe kullota alpine.
- Shumëllojshmëri bimësh e kafshësh të egra prej të cilave shumë janë specie të rralla.
- Mbi 40 lloje bimësh mjekësore që mblidhen tashmë prej popullatës

Potenciali Turistik dhe zhvillimi aktual i tij

Turizmi përbën prioritetin parësor për zhvillimin e komunës Margegaj sepse:

1. Komuna ka burime natyrore të një niveli shumë të lartë të cilat janë:

- Lugina e Valbonës dhe lugina e lumit të Gashit të dyja parqe kombëtare
- Bjeshkët

- Lumenj
 - Burime ujore dhe liqene
 - Lumi i Valbonës në rrjedhjen e tij të poshtme krijon plazhe
2. Zhvillimi i turizmit nxit dhe shkon paralel me rritjen e prodhimeve bujqësore, blegtorale, rregullimin dhe mirëmbajtjen e banesave, ambjenteve të pushimit dhe argëtimit, prodhimeve artizanale të traditës etj.
3. Nxit dhe rrit nivelin arsimor dhe kulturor të banorëve, nivelin e jetesës dhe botëkuptimin për të zhvilluar veten dhe vendin edhe për të organizuar jetën në pronat e veta duke konsoliduar aftësitë dhe njohuritë për ekonominë e tregut.
4. Komuna ka Zona të Mbrojtura të Monumenteve të natyrës Shqiptare të shpallura me VKM Nr. 676, datë 20.12.2002 të cilat janë;
- Rasa e Pecmarrës,
 - Depozitimet fluvio-glaciale të Shoshajt,
 - Bredhishtja e Ragamit,
 - Shelgu i Rrjetëzuar,
 - Burimi i Qukut të Dunishës,
 - Burimi i Shoshanit,
 - Burimet e Valbonës,
 - Shpella e Akullit,
 - Lugina e varur akullnajore e Kukajt,
 - Lugina Akullnajore e Motinës
 - Kanioni i Shoshanit
 - Arra e Dragobisë
 - Shpella e Dragobisë,
 - Hormoqi i Valbonës
 - Ahishtja e Vranicës

Pika të forta për zhvillimin e turizmit:

Ambjente turistike; lugina të thella e male të larta, florë shumë e pasur, plazhe e sheshe pushimi e argëtimi, natyrë e virgjër, vende të panjohura jo vetëm për të huajt por edhe për vet shqiptarët, nuk ka ndërtime të betonuara. Ndonëse në zemër të Alpeve udhëtimi përmes saj me automjet është i lehtë nëpërmjet rrugës boshore.

Pika të dobëta:

Ambjentet e shërbimeve turistike ende të pamjaftueshme. Kulturë shërbimi ende jo në nivelin e kërkuar. Ndonëse shumë prezente në internet informacioni për Parkun Kombëtar të Valbonës ngelet shumë sipërfaqësor. Botëkuptime jo shumë të qarta të banorëve për zhvillimin dhe menaxhimin e turizmit. Një pjesë e mirë e Luginës nuk mbulohet nga valët e telefonisë mobile. Arritjet e deritanishme nga komuna për zhvillimin e turizmit si përparësi prioritare. Janë evidentuar vlerat më të spikatura turistike të zonës. Është hartuar Guida e parë turistike e komunës.

Është punuar me banorët për zhvillimin e turizmit familjar. Por kapacitetet ekzistuese mbeten të kufizuara: Akomodimi; 7 bujtina të regjistruara me 70 shtretër; Bar restorante 4; 1 fshat turistik.

I është dhënë prioritet zhvillimit të infrastrukturës të kësaj zone:

- Furnizimi me energji elektrike; Ndërtimi i linjës së re 10KV Shoshan – Rrogam (30 km e gjatë)
- Ambjentet e shërbimit shëndetësor dhe të arsimit janë sjellë në nivele të larta
- Është në zbatim projekti i rikonstruksionit të rrugës automobilistike Bajram Curri Valbonë (35 km e gjatë)
- Janë hartuar projekte për ujësjellës të ri në Valbonë.

7. Eksperiencia me projektet e zhvillimit

Gjatë periudhës shtatë vjeçare, 2005-2012, rajoni i Kukësit ka përfituar ndihmë financiare nga donatorë të ndryshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë të tillë si: BE, PNUD, SNV, FSHZH në

sektorë të ndryshëm të zhvillimit. Projektet e realizuara janë fokusuar kryesisht në ndërtimin e infrastrukturës, zhvillimin e turizmit dhe ngritjen e kapaciteteve.

Nga sa më sipër, konsiderojmë se aktualisht asgjë nuk e ndalon zbatimin e menjëhershëm të projekteve rajonale, në fushat kryesore të dhëna më poshtë, përveç burimeve financiare dhe kapaciteteve të përshtatshme. Me fjalë të tjera, nuk ka asnjë varësi apo kusht kufizues në politikat dhe programet kombëtare.

Fusha ku mund të zbatohen iniciativat rajonale janë:

- Të gjithë aktivitetet e investimeve dhe zhvillimit të turizmit përveç marketingut të përgjithshëm ndërkombëtar
- Zhvillimin e planeve menaxhuese mjedisore për zonat e mbrojtura dhe me ndjeshmëri të lartë natyrore
- Zhvillimi i strategjive të zhvillimit rural dhe të strukturave përkatëse.
- Investime sipas zonave për të rigjeneruar, ri-projektuar, rinovuar, pastruar, përmirësuar dhe në fund për të përforcuar atraktivitetin për tregtinë, vizitorët, investimet në fshatra dhe zona rurale, ndërtimet dhe rikonstruksionet e rrugëve lokale për të cilat ka edhe një kërkesë të lartë (sidomos për transportimin e prodhimeve)
- Promovimi i Biznesit - marketingu rajonal dhe promovimi - "Pse të investosh në rajonin tonë?", "Çfarë ka Rajoni ynë për t'i ofruar Investitorëve".

Në përfundim të analizës në Qarkun e Kukësit në lidhje me situatën e përgjithshme social ekonomike, demografike, pozitës gjeografike konkludojmë se, *turizmi dhe agrobiznesi mbeten dy sektorëve të rëndësishëm për zhvillimin e qarkut. Infrastruktura TIK dhe konektiviteti broadband janë të lidhur me perspektivën e përgjithshme zhvillimore të qarkut.*

4. PANORAMA E PËRGJITHSHME E TREGUT TELECOM

Bazuar ne analizat periodike dhe të dhenat statistikore te publikuara nga AKEP, në vitet e fundit sektori i komunikimeve elektronike ka pasur rritje të përdorimit të shërbimeve të rrjeteve celulare dhe aksesit me internet, ndërsa ka pasur ulje të segmentit të telefonisë fikse. Përdorimi i telefonisë fikse ka qënë në rënie duke u zëvendësuar me telefoninë celulare, dhe aksesit me internet ka pasur rritje në të dy segmentet: nga rrjete fikse dhe rrjete celulare.

Numri i përdoruesve celularë aktive (pajtimtarë që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit) në fund të vitit 2013 arriti ne 3.7 milion, krahasuar me 3.5 milion në fund të vitit 2012. Kjo përbën një rritje vjetore me 4% për të katër operatorët, ndërkohë që numri i perdoruesve të telefonisë së lëvizshme sipas kartave SIM aktive, pati reduktim me 6%, duke arritur në 5.3 milion krahasuar me 5.6 milion në fund të vitit 2012. Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në 2013 ishte 130% sipas përdoruesve aktivë dhe 187% sipas kartave SIM.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2013, arriti në rreth 281 mijë, krahasuar me rreth 311 mijë që ishte në fund të vitit 2012, pra një rënie me 10%. Rënia e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse është në vijim të tendencës rënëse të nisur në 2010, me përjashtim të vitit 2011 që pati rritje. Rënia ka ardhur për shkak të vazhdimit të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me 9% si dhe rënies me 13% të numrit të pajtimtarëve të operatorëve alternativë. Norma e penetrimit të telefonisë fikse në fund të vitit 2013 ishte rreth 10%.

Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks dhe celular (3G me karta USB/modem) në fund të vitit 2013 arriti në rreth 294 mije, që përbën një rritje me 36% në krahasim me vitin 2012. Në 2013 të dy segmentet e aksesit broadband, fiks dhe 3G (me karta USB/modem), kanë pasur rritje me 14% dhe 101% respektivisht. Norma e penetrimit me të dy llojet e aksesit së bashku është 10.4% për popullsi dhe 37% për familje.

Dy figurat e mëposhtëme paraqesin ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë celulare (përdorues aktivë) dhe telefonisë fikse në raport me aksesin broadband me rrjete celularë dhe fiks. Figurat tregojnë qartë se normat e rritjes së aksesit me internet broadband në të dy llojet e rrjeteve janë më të


larta se të telefonisë. Për rrjetet fikse ka madje tendenca të kundërta: rritje e aksesit internet broadband dhe rënie e telefonisë fikse. Në 2013, 33% e përdoruesve aktive celularë përdorin akses broadband 3G, dhe numri i pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse përbën 65% të pajtimtarëve të telefonisë fikse. Gjatë vitit 2013 sektori i komunikimeve elektronike ka pasur rritje të përdorimit të shërbimeve të rrjeteve celulare dhe aksesit broadband Internet, ndërsa ka pasur ulje të segmentit të telefonisë fikse. Këto tendenca janë të ngjashme me tendencat e viteve të fundit, ku përdorimi i telefonisë fikse ka qënë në rënie duke u zëvendësuar me telefoninë celulare, dhe aksesit broadband ka pasur rritje në të dy segmentet: nga rrjete fikse dhe rrjete celulare.

TELEFONIA CELULARE

Numri i përdoruesve celularë:

Numri i përdoruesve celularë aktivë në fund të vitit 2013 arriti në 3.7 milion, krahasuar me 3.5 milionë në fund të vitit 2012. Kjo përbën një rritje vjetore me 4% për të katër operatorët, ndërkohë që norma e rritjes ndryshon sipas operatorëve: Plus dhe Vodafone kanë rritje me 9 dhe 11% respektivisht, ndërsa Albtelecom (EM) dhe AMC kanë reduktim 2 dhe 3% respektivisht. Figura 2, paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë aktivë në periudhën 2010-2013.

Figura 5: Ecuria e numrit të përdoruesve celularë aktivë 2010-2013



TELEFONIA FIKSE

Telefonia fikse edhe gjatë vitit 2013 ka vazhduar tendencën rënëse të viteve të fundit, e cila megjithëse është në linjë me tendencën rënëse në vendet e BE, norma e penetrimit prej 10% është shumë më ulët se në vendet e BE. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2013, arriti në rreth 281 mijë, krahasuar me rreth 311 mijë që ishte në fund të vitit 2012, pra një rënie me 10%. Rënia ka ardhur për shkak të vazhdimit të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelcom me 9% si dhe rënies me 13% të numrit të pajtimtarëve të operatorëve alternativë.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse dhe Albtelcom dhe operatorëve alternativë në periudhën 2000-2013.

Figura 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2013





Tabela e mëposhtëme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse të operatorëve kryesorë në periudhën 2010-2013. Siç shihet, ka një rënie të konsiderueshme të pajtimtarëve fiks, që do të thotë se ky treg nuk paraqet më interes për shërbimin fiks.

Tabela 7. Ecuria e pajtimtarëve 2010-2013

Operatorët	2010	2011	2012	2013	Ndryshimi 2013/2012
Albtelecom	277,763	258,943	230,397	210,382	-9%
Abcom	19,975	27,167	33,000	13,680	-59%
ASC	7,408	10,129	7,649	15,047	97%
Nisatel	5,900	4,950	5,500	7,166	30%
AMC Fiks	-	7,565	6,119	6,950	14%
OA te tjere	20,456	30,090	28,996	27,975	-4%
Total Fiks	331,502	338,844	311,661	281,200	-10%

Figura e mëposhtëme paraqet pjesët e tregut të operatorëve kryesorë të telefonisë fikse, ku vihet re se Albtelecom vazhdon të ketë 75% pjesë tregu, pasi rënia e numrit të pajtimtarëve fiks ka qenë tendencë e të gjithë tregut.

Figura 7: Pjesët e tregut të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2013



Kjo tendencë, pa dyshim që është ndjerë dhe në dy qarqet që po studiojmë.

INTERNETI


Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks dhe celular (3G me karta USB/modem) në fund të vitit 2013 arriti në rreth 294 mijë, që përbën një rritje me 36% në krahasim me vitin 2012. Tabela e mëposhtëme paraqet numrin e pajtimtarëve broadband fiks dhe 3G, dhe numrin e pajtimtarëve si përqindje e popullsisë dhe numrit të familjeve (penetrimi). Në 2013 të dy segmentet e aksesit broadband fiks dhe 3G (me karta USB/modem) kanë pasur rritje me 14% dhe 101% respektivisht.

Norma e penetrimit për të dy llojet e aksesit së bashku është 10.4% për popullsi dhe 37% për familje.

Tabela 8: Numri i pajtimtarëve me akses broadband dhe normat e penetrimit 2011-2013

VITET	Numri i pajtimtarëve			Penetrimi				
	Total Fiks	Total 3G	Total Fiks + 3G	Popullësi			Familje	
				Fiks	3G	Fiks +3G	Fiks	Fiks +3G
2011	139,697	34,493	174,190	4.9%	1.2%	6.2%	17%	22%
2012	160,088	55,405	215,493	5.7%	2.0%	7.6%	20%	27%
2013	182,556	111,367	293,923	6.4%	3.9%	10.4%	22%	37%
Ndryshimi 2013/2012	14%	101%	36%					

Figura 8: Ecuria e numrit të pajtimtarëve me akses broadband 2007-2013



Numri i pajtimtarëve me akses broadband me rrjete fikse pati një rritje prej 14%, ku shumica e operatorëve kanë pasur rritje të numrit të pajtimtarëve. Albtelecom në 2013, pati rritje me 10% të numrit të pajtimtarëve broadband.

Tabela 9: Numri i pajtimtarëve me akses broadband fiks 2010-2013

	Albtelecom	Abcom	Abissnet	ASC	OA te tjere	Total Broadband Fiks
2010	70,597	13,575	7,000	5,666	23,162	120,000
2011	60,055	29,321	15,321	10,129	24,871	139,697
2012	66,757	35,870	17,719	11,777	27,965	160,088
2013	73,242	43,430	20,562	15,432	29,890	182,556
Ndryshimi 2013/2012	10%	21%	16%	31%	7%	14%

Numri i pajtimtarëve me akses broadband celular (3G me karta USB/modem për përdorim me kompjuter) në fund të vitit 2013 arriti në rreth 111 mijë nga 55 mijë në fund të 2012, që përbën dyfishim të numrit apo rritje me 101%. Të dy operatorët celularë Vodafone dhe AMC, kanë pasur rritje të ndjeshme me 76 dhe 80% respektivisht, si dhe Eagle Mobile si operatori më i ri që filloi ofrimin e shërbimeve 3G në 2013, ka arritur të ketë rreth 13 mijë pajtimtarë gjatë vitit 2013. Rritje të madhe me 88% pati edhe numri i përdoruesve me akses broadband 3G nga aparatet celulare, duke arritur në rreth 1.1 milion në fund të 2013, krahasuar me 594 mijë në 2012. Në total numri i përdoruesve me akses broadband 3G (aparate celulare dhe karta USB) në 2013 arriti në 1.2 milion në krahasim me 694 mijë në 2012.

Nga sa më lart vëmë re një rritje të kërkesës për broadband në të gjithë vendin e normalisht kjo rritje pasqyrohet dhe në këto dy qarqe.

SITUATA E INTERNET BROADBAND NË QARQET SHKODËR E KUKËS

Nga analiza demografike e sociale e zonës së veriut gjykojmë që penetrimi i telefonisë celulare është shumë më i lartë dhe se ky është mjeti kryesor i komunikimit. Ndërsa përdorimi internetit është shumë i kufizuar.

Tabela e mëposhtme jep informacionet mbi operatorët telekom që operojnë në zonat Shkodër e Kukës, përfshirë dhe komunat që janë objekt i këtij studimi. **(Shiko Aneksin1)**

SITUATA E FIBRES OPTIKE

Shkodër : *Operatorët kryesorë që janë prezent me investimet e tyre në Fiber Optike zonat Shkodër e Kukës: Altelecom, ATU, Abissnet e ASC.* Investimet e tyre janë kryesisht në zonat brenda qyteteve dhe ne periferi të tyre, sic duket dhe nga skemat e mëposhtme.




Fig. 1/1 Rrjeti i Fibres Optike i Altelecom Shkodër




Fig : 2/1 Abcom Shkodër




Fig 3/1: Abisnet Shkodër




Fig.4/1 ASC Shkodër




Fig. 5/1 ATU Shkodër

Nga sa shikohet në këto harta, Shkodra mbulohet me FO kryesisht brënda qytetit dhe në zonen jug-lindore të qytetit. Nuk kemi rrjet te fibres optike ne komuna.

Kukës

Në Kukës rrjet të fibres optike kemi të dy operatoreve Altelecom dhe ATU sikurse jepet ne figurat më poshtë :



Rrjeti FO Altelecom Kukës



Rrjeti FO ATU Kukës

Pajtimtaret e telefonisë fikse

Situata e pajtimtarëve të telefonisë fikse në këto dy zona janë sipas tabelës së mëposhtme:

Në zonat rurale vihet re një ulje e numrit të pajtimtarëve fiks si rezultat i dëmtimeve në rrjetin me bakër. Ndërkohë vihet re një rritje e pajtimtarëve që përdorin rrjetin e operatorëve alternative si ABCOM, ABissnet krahas atij të Altelecom.

Tabela 10. Pajtimtarët për qarqe

	Gjithsej		Vetem nga Albtelecom	
	Shkodër	Kukës	Shkodër	Kukës
Total pajtimtare	12.026	2.271	10790	2183
Pajtimtar Biznes	518	202	10295	226
Pajtimtar Familjar	11.508	2.069	495	1957

Penetrimi mbi bazë familjesh në Shkodër rezulton 21.14% dhe në Kukës 12%. Nga tabela e mësipërme, rezulton se Albtelecom ka numrin më të madh të pajtimtarëve në këto dy qarqe, pavaresisht se është në një nivel të ulët penetrimi.

Në lidhje me shërbimet e komunikimit që janë në dispozicion të familjeve në vitin 2014, rezultatet tregojnë se 38,5% e familjeve në Shqipëri kanë një telefon fiks në shtëpi, duke qenë të përqëndruara kryesisht në zonat urbane, ku 44,2% e familjeve kanë lidhje telefonike fikse, krahasuar me 7,9% të familjeve në zonat rurale.

Pajtimtarët e telefonisë mobile

Sipas Census 2011 rezulton se 86,8% e familjeve në Shqipëri kanë të paktën një anëtar që ka një telefon celular. Përqindja është shumë e lartë për të dy zonat; megjithatë, ajo është më e lartë në zonat rurale, pjesërisht si kompensim për linjat më të pakta të telefonisë fikse. Lidhja me internet vazhdon të mbetet ende një fenomen urban: 19,1% e familjeve urbane kanë lidhje me internet krahasuar vetëm 3,5% të familjeve rurale.

Ky rezultat përputhet me zotërimin e kompjuterit në të dy zonat: 29,2% e familjeve në zonat urbane, përkundrajt 8,2% në zonat rurale.

Tabela 11. Numri total i pajtimtarëve në dy qarqet e Shodës dhe Kukësit është:

	Shkodër	Kukës
Numri i përdoruesve celularë (GSM)	116,168.33	96,485.00
Numri i përdoruesve celularë (GSM) me karte të parapaguar	113,181.67	96,330.00
Mbulimi i territorit me shërbim (GSM) (%)	95.00	93.00
Mbulimi i popullsisë me shërbim (GSM) (%)	99.70	99.60

Informacion i marre nga AKEP për periudhën janar-qershor 2014

Në ndryshim me telefonine fikse, telefonja mobile shkon në përpjestim me numrin e popullsisë së zonave. Por nga raportet e marra nga AKEP, rezulton se pjesa e Bjeshkëve të Namuna, ka një mbulim jo të mirë me sinjalin mobile. Gjatë matjeve të kryera përgjatë aksit Bushat-Pukë-Qafë Mali-Tropojë-Valbonë-Has-Kukës edhe pse sistemi tregonte në punë, nga përpunimi i të dhënave në hartat respektive duket mosfunksionim i tij (GPS), pasi të dhënat nuk përputhen me aksin e rrugës.

Rezulton se AMC ka mungesë të sinjalit në Qafën e Malit (Kukës); në dalje të Fushë Arrëzit për në Mirditë; Valbone-Dragobi ; ka sinjal të dobët në Burrel-Batër e vogël; Kujtim-Klos; Klos-Plani i Bardhë; Bulqizë-Dragua;; Ura e Bunës; Shënmëri; Lajthizë-Qafa e malit; Qafa e malit-Fushë Arrëz; Shkozë; Gjegjan; Gëziq; Fierzë-Fang (Mirditë) etj.

Rezulton se Vodafone ka mungesë sinjali ose ai është shumë i dobët në këto zona: Qafa e malit; dalja e Fushë Arrëzit për në Mirditë, Hyrja e Burrelit; Kujtim-Klos; Ura e vashës-Klos Katund; Plani i Bardhë-Bulqizë; Dragua; Sofraçan; Shupenzë; Blladë; Oblik e Madhe; Obot-Muriqan; Lajthizë; Qafa e malit-Fushë Arrëz; Gjegjan-Rrëshen;

Rezultton se Eagle Mobile ka mungesë sinjali ose ai është shumë i dobët në këto zona: Shoshan-Valbonë; Fushë Arrëz-Gjegjan mungon sinjali ECDMA; Hyrje e Burrelit; Dalja e Burrelit; Batër e vogël- Buc (Burrel); Fshat-Klos Katund; Krajkë-Sofraçan; Topojan-Maqellarë; Blladë-Maqellarë; Pesjakë-Erebarë; Peshkopi-Pilafë;

Në aksin Tyneli i Kalimashit-Fan, për rrjetin WCDMA rezultton të ofrojë këtë shërbim dhe operatori Plus Communication.

Pra nga analiza e bërë pajtimtarëve fiks e mobil, vëmë re që edhe pse tepër i ulët, penetrimi i telefonisë fikse nuk ka rritje duket sikur është në “ngopje”, ndërsa mobile vjen në rritje. Kjo është e lidhur me efektin e zëvendësueshmërisë që ka shërbimi i telefonisë së lëvizshme ndaj atij fiks. Ndërkohë lidhur me aksesin e internetit broadband, nga të dhënat më sipër por dhe nga rezultatet e takimeve të zhvilluara me përfaqësues të zonës, mbulimet me anë të satelitit, hotspotet e kompanive mobile apo dhe vetë mobile broadbandit, nuk kënaqin kërkesat e banorëve të zonës.

ANALIZA E ZHVILLIMIT TË INTERNETIT DHE TIK NË SHKODËR E KUKËS

TIK konsiderohet si një nga mjetet kryesore për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të nje vendi. Si e tillë politikat qeveritare kanë mundësuar e nxitur shpërndarjen e internetit dhe të telefonive fikse e mobile në mbarë vendin. Po ashtu, njohja e rolit të TIK në zhvillimin ekonomik e social duke përfshirë tregëtinë, shëndetësinë, edukimin, shërbimet publike të ofruara nga qeveria kërkojnë zhvillimin e shërbimeve të komunikacionit si një prioritet kyç. Operatorët që ofrojnë shërbimet e komunikimeve elektronike janë të interesuar të kryejnë investime në ato zona ku ka kërkesa për këto shërbime.

Nga hartat e paraqitura më sipër, në lidhje me shtrirjen e fibrës optike, shihet që është investuar brenda qyteteve, në rrethinat e tyre dhe në akset kryesore të rrugëve dhe duke qenë se investimet në FO janë me vlera të konsiderueshme, mendohet e vështirë tërheqja e tyre për të vijuar me të tilla investime.

Në këto kushte, duhen konsideruar zgjidhje të tjera për t'u ofruar internetin familjeve e bizneseve familjare apo të tjera, në këto zona.

Njëkohësisht edhe përdorimi i pajisjeve kompjuterike apo smart phone është një i nevojshem për të patur akses në internet. Statistikat e INSTAT sipas LSMS 2008 dhe LSMS 2012 japin nje rritje me disa here te numrit te familjeve qe kane PC ne qarkun e KUKËSit dhe Shkodres si ne table.

a) % e familjeve që zotërojnë PC sipas qarqeve (marrë nga INSTAT) :

	Viti 2008	Viti 2012
KUKËS	2.4%	17.2%
SHKODËR	1.6%	22.3%

Megjithatë numri i familjeve që zotërojnë një PC sipas LSMS 2012 mbetet ende i ulët, vetëm 17.2% e familjeve në Kukës dhe 22.3% e familjeve në Shkodër. Kjo shifër jepet në nivel qarku dhe kuptohet që ky rezultat do jetë dhe me i ulët për zonat e thella apo komunitat.

b) % e familjeve me lidhje Interneti në banesë në raport me ato që kanë PC sipas qarqeve:

	Viti 2008	Viti 2012
KUKËS	55.3 %	63.2 %
SHKODËR	63.2 %	77 %

Këto janë sipas rezultateve të LSMS 2008 dhe LSMS 2012: Pra përdorimi i PC për familje në këto dy zona është tepër i ulët. Megjithatë ndjehet një rritje e konsiderueshme në lidhje me rritjen e numrit

të PC në familje, pavarësisht se mbetet një nivel i ulët i përdorimit të PC në familje. Dhe gjithashtu jo çdo familje që zotëron një PC ka internet. Vetëm 63.2% e 17.2% të familjeve në Kukës, kanë internet në familje dhe 77% e 22.3% të familjeve në Shkodër kanë internet. Vihet re se këto kryesisht janë të lidhura me operatorët e përmendur dhe janë shtrirë në zonat urbane e shumë pak në ato rurale.

Ka një diferencë gjithashtu edhe në kërkesën për lidhje me internet në shtëpi midis të dyja zonave: vetëm 42,0% e familjeve që zotërojnë një kompjuter edhe kanë lidhje me internet në shtëpi në zonat rurale, krahasuar me 65,5% e familjeve në zonat urbane.

Në takimet e zhvilluara me përfaqësues të zonës, ngrihej si problem dhe tarifa e lartë e aksesit të Internetit në veçanti kjo për lidhjet satelitore (në disa raste arrin dhe mbi 100 Euro për bizneset e vogla familjare). Kjo mund të shpjegojë % e vogël të aksesit në internet, si pasojë e tarifave të larta të ofruara nga operatorët alternative. ADSL në këto dy qarqe nga shifrat e marra nga Albtelecom është si më poshtë :

Tabela 12. ADSL e ndarë sipas qarqeve Kukës dhe Shkodër

Lidhje ADSL	Gjithsej	
	Shkodër	Kukës
Total pajtimtarë	4.067	1.649
Pajtimtarë Biznes	199	122
Pajtimtarë Familjar	3.868	1.527

Duke konsideruar numrin e bizneseve (ndërmarrjeve) dhe ADSL së biznesit, konkludojmë që penetrimi i internetit nëpërmjet ADSL është tepër i ulët , në nivele të 11% në Kukës e 4 % në Shkodër.

Pra, nga sa studiuam, mund të konkludojmë:

1. Në këto zona, mbulimi me rrjet fiks duket i ezauruar. Si familjarët dhe biznest kanë një kërkesë të vogël për këtë shërbim gjë që shpjegohet dhe me efektet e zëvendësimit të shërbimit me atë të telefonise cellularë.
2. Operatorët alternative ofrojnë çmime relativisht të larta, të cilat janë të papërballueshme nga tregu.
3. Rrjeti 3G përdoret gjërësisht, pasi banorët e këtyre zonave kanë pjestarë të familjeve të tyre të emigruar jashtë.
4. Penetrimi i Internetit është ende i ulët por me tendencyë rritje të fortë.
5. Bizneset kanë nevojë për akses internet, internet është i nevojshëm.
6. Projekte të ndryshme të zbatuara në komuna të ndryshme të këtyre zonave, kanë nxitur publikimin e natyrës, produkteve bio, faktorë këto mjaft të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit por dhe të bizneseve te vogla.
7. Projektet në infrastrukturë rrugore, kanë mundësuar rritjen e aksesit në mjaft zona, rritjen e komunikimit e marrëdhënieve mes komunave, lehtësimin e lëvizjeve në disa zona, dhe për rrjedhojë dhe nxitjen e zhvillimit.

Të gjitha sa më lart janë premisa për operatorët që të investojnë në ngritjen apo zgjerimin e infrastrukurave të komunikacioneve e të IT.

PËRPARËSITË E ZHVILLIMIT TË EKONOMISË PËRMES TEKNOLOGJISË

Interneti ka ndikuar jetën tonë në mënyrë të konsiderueshme. Ai ka transformuar mënyrën se si njerëzit punojnë, se si kryejnë biznes, tregëti, si kërkojnë informacion dhe madje ka ndryshuar dhe mënyrën e komunikimit. Në kohën e internetit, njerëzit, tregjet dhe ekonomitë janë të ndërlidhura më shpejt; shkëmbimi i mallrave, shërbimeve dhe njohurive realizohet pa pengesa; dhe përhapja e lajmeve realizohet në mënyrë të menjëhershme.

Interneti ka lehtësuar gjithashtu zhvillimin e bizneseve online. Përafërsisht 8 trillion USD transaksione realizohen çdo vit përmes e-commerce. Në vende të zhvilluara, rreth dy të tretat e të gjitha bizneseve kanë një faqe web-i, ndërsa një e treta e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) përdorin gjerësisht teknologjitë.

Siç shihet gjatë viteve të fundit, ka pasur përshpejtim të dukshëm në ndikimin e ekonomisë dixhitale për bizneset dhe individët. Në veçanti, adoptimi dhe shpërndarja e teknologjive të përparuara të informacionit (p.sh. përmes aplikacioneve të mediave sociale) kanë shtyrë ndryshimet e shpejta në industri të caktuara të tilla: si shitje dhe media.

Ky ritëm i ndryshimeve të viteve të fundit nuk pritet të zvogëlohet, por në mënyrë efektive pritet të zgjerohet në të gjithë sektorët.

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore përmes internetit janë dy fusha prioritare të cilat tregojnë transformim. Opsionet e reja dixhitale të ofrimit të shërbimeve në këto sektorë si e-health, kanë potencial për të bërë ndryshimin e madh në momentin që ato përdoren.

Qytetet e mëdha kanë përfituar nga aksesimi në tregjet më të mëdha, dhe kanë tërhequr një pjesë më të madhe dhe më të kualifikuar të forcës së punës. Megjithatë, me ardhjen e teknologjive dixhitale të gjitha bizneset kanë mundësinë për një qasje më të madhe në tregje pa qënë e nevojshme prania fizike, dhe të sigurojnë punonjës me fleksibilitetin për të jetuar dhe punuar në vende të ndryshme. Adoptimi i teknologjive dixhitale është faktor për rritjen ekonomike dhe diversifikimin e aktivitetit duke rritur numrin e bizneseve që shërbejnë në zonë për të promovuar zhvillim më të ekuilibruar.

Turizmi si industria më e madhe është dhe ofruesi i vëndeve më të mëdha të punës. Rritje dhe zhvillime të konsiderueshme pasqyrohen nga rritja dhe zhvillimi i TIK. TIK ka ndryshuar gjithashtu rrënjësisht efikasitetin dhe efektivitetin e organizmave turistike, mënyrën e të bërit biznes.

TIK i mundëson turistëve të marrin informacion të besueshëm dhe të saktë dhe ndihmon në përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe kontribuon në rritjen e kënaqësisë së turistëve. TIK vendos përdoruesit në mes të funksionalitetit dhe produktit të saj. Çdo turist është i ndryshëm, duke pasur një përzierje të eksperiencave, motivimeve dhe dëshirave. Turistët nga rajonet kryesore të botës janë bërë udhëtarët e shpeshtë, janë gjuhësisht dhe teknologjikisht të aftë për të funksionuar në mjediset multikulturore dhe shumë “kërkues” jashtë shtetit. Zhvillimi i TIK dhe veçanërisht i Internetit ka fuqizuar turistin “e ri” i cili është duke u bërë i ditur dhe është duke kërkuar vlera të jashtëzakonshme në vlerë monetare dhe në kohë. Turistët janë bërë më pak të interesuar në ndjekjen e turmave në ture të organizuara dhe shumë më tepër të prirur të ndjekin preferencat dhe oraret e tyre. Gjithnjë e më shumë, organizimi i paketave turistike është duke humbur pjesën e tregut në favor të turizmit të organizuar në mënyrë të pavarur, i lehtësuar ky nga udhëtimi dinamik. Konsumatori i ditëve të sotme është më pak i gatshëm që të presë, pasi çelësi i suksesit qëndron në identifikimin e shpejtë të nevojave të konsumit dhe në arritjen e klientëve të mundshëm me produkte dhe shërbime që plotësojnë nevojat e tyre.

Interneti ka ndryshuar sjelljen e turistëve në mënyrë dramatike. Turistët kërkojnë të kenë kontakt me ofruesit e shërbimeve turistike, me hotelet apo guest house-t dhe gjithnjë janë në kërkim të informacionit, destinacionit dhe produkteve për t'u konsumuar. TIK ofron një gamë të gjerë të mjeteve për të lehtësuar dhe përmirësuar procesin. Konsumatorët janë të lirë për të kërkuar informacionin e udhëtimit të tyre, të bëjnë rezervime në internet të biletave të udhëtimit, rezervimet e dhomave online, dhe blerje të tjera që mund të realizohen nga ata vet në mënyrë të drejtpërdrejtë pa qënë nevoja e agjencisë turistike si ndërmjetës i këtij procesi. Për shkak të popullaritetit të aplikacioneve të ndryshme të internetit, organizma të ndryshme turistike si hotelet, linjat ajrore dhe agjencitë e udhëtimit kanë përqafuar teknologjitë e internetit, si pjesë e marketingut dhe e strategjisë së tyre të komunikimit.

Kërkimi i informacionit është një pjesë e rëndësishme e procesit të vendimit për blerjet dhe është revolucionarizuar si rezultat i internetit. Mundësimi i TIK jo vetëm të reduktuar pasigurinë dhe rreziqet, por ka rritur cilësinë e udhëtimeve. Një turist i mirinformuar është në gjendje të bashkëveprojë më mirë me burimet dhe kulturat lokale, të gjej produktet dhe shërbimet që plotësojnë kërkesat e tij / saj dhe të përfitojë nga ofertat speciale dhe çmimet e reduktuara.

Katër faktorët kryesorë që ndikojnë në kërkimin e informacionit në kontekstin e turizmit janë:

- (i) përbërja e grupeve turistike,
- (ii) prania e familjeve dhe miqve në destinacionin e dëshiruar,
- (iii) vizita të mëparshme në destinacion, dhe
- (iv) shkalla e rrisë lidhur me destinacionin.

Çmimi është një nga çështjet kryesore të e-turizmit ku shumë turiste përdorin TIK për të komunikuar direkt për tarifatat on-line duke përfituar nga ulje të mundshme apo komisione të ndryshme. Interneti është një nga teknologjitë që ka influencuar më shumë turistët. Kërkime të ndryshme kanë treguar se turistët që kërkojnë në internet priren të shpenzojnë më shumë në destinacionet e tyre sesa të tjerë të cilët konsultoheshin nga burime të tjera.

Aktualisht, ka një rritje të madhe në numrin e konsumatorëve të cilët bëjnë rezervime direkt nga faqet e internetit të hotelit. Me transmetimin e shpejtë të të dhënave në internet, koha e prituri për përgjigje nga hotelet për turistët është reduktuar në masë të madhe. Përgjigja e shpejtë e pyetjeve në internet ka rritur kënaqësinë e klientëve dhe ka rritur numrin e prenotimeve on-line. Si rezultat, përgjigja e shpejtë bëhet një faktor thelbësor për suksesin e ndërmarrjeve turistike të vogla dhe të mesme.

TIK dhe përdorimi i internetit kanë rritur në mënyrë dramatike numrin e turistëve në zona të ndryshme turistike të Shqipërisë, përfshirë këtu zona bregdetare apo zona malore.

Sektori i turizmit është një nga sektorët që ka përjetuar ndikime të rëndësishme nga internet broadband. Shumë aktorë të këtij sektori, duke përfshirë linjat ajrore, ofruesit e shërbimeve turistike,

operatorëve turistikë dhe të agjentëve të udhëtimit, kanë përdorur platformat e ndryshme të TIK për të bërë marketing, dhe për të pasur përfitime pozitive.

Platformat specifike TIK që janë në përdorim përfshijnë lidhjen e internetit, sistemet e aplikacioneve të informacionit (sistemet e rezervimit në internet, sistemet online marketing, sistemet e pagesave online, etj), web hosting, rrjetet sociale (LinkedIn, YouTube, Facebook), faqet e internetit të palës së tretë, dhe kështu me radhë. Aktorët turistikë përdorin këto platforma të TIK në paketat e tyre dhe presin për pyetje nga klientët të cilët janë të shpërndarë globalisht.

Mund të thuhet se shitjet online janë bërë zëvendësuese të ofrimit të shërbimeve tradicionale nga agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë. Për shembull, përmes internetit, tashmë konsumatorët janë në gjendje për të rezervuar hotele direkt, pa pasur nevojë të shkojë nëpër agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë.

Nga njëra anë, interneti ka bërë të lehtë që të shkojë direkt blerësi të shitësi, dhe si rezultat roli i ndërmjetësit zvogëlohet apo edhe të eliminohet.

Nga udhëtime në terren është parë se hotelet apo guest house-t kishin nevojë për të shfrytëzuar shitjet në internet dhe mungesa e tij e bënte të pamundur.

Teknologjia që do t'i mundësohet këtyre zonave do të rrisi në mënyrë drastike rritjen e numrit të turistëve në Shqipëri duke i dhënë mundësinë hoteleve të kenë akses në faqe interneti, të publikojnë ofertën e tyre turistike on-line.

Një nga sfidat është kosto e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së platformës TIK, duke marrë parasysh se kosto për zhvillimin e një web-i dhe mirëmbajtja e tij është shumë e shtrenjtë për një biznes. Përmes këtij projekti krijohet mundësia që një pjesë e guest-houseve të pajisen me faqe web-i, dhe të trajnohen mbi promovimin e ofertës së tyre turistike online. Kjo është një sfidë për zhvillimin e turizmit në këto zona.

Në përfundim mund të themi se internet broadband luan një rol shumë të rëndësishëm në menaxhimin strategjik dhe operativ, si dhe në marketing për të gjithë aktorët turistikë

sidomos nga pikëpamja e konkurrencës. Përdorimi i platformave TIK është faktor i rritjes së konkurrencës. Për shembull, përdorimi i rrjeteve sociale, faqet e internetit dhe rezervimet online kanë një rol të rëndësishëm në industrinë e turizmit. Kjo tregon se të gjitha hotelet dhe aktorët e tjerë të cilët nuk e përdorin TIK janë jashtë këtij zinxhiri. TIK ka ndryshuar rolin e agjencive turistike dhe operatorëve turistikë. Aktivitete të tilla si rezervimet e biletave online apo rezervimi i hoteleve në po të njëjtën formë ishte i pakonceptueshëm para disa kohësh. Përveç kësaj ata kanë mundësinë për të reklamuar produktet dhe shërbimet e tyre me ritme të reduktuara për një audiencë më të gjerë dhe të përhapur në të gjithë botën. Studimi ka bërë një kontribut për efektet e internetit broadband në sektorin e turizmit.

TURIZMI DHE TIK

Turizmi është ndikuar në mënyrë të pashmangshme nga proceset e reja të biznesit me përvojë për shkak të revolucionit teknologjik. Informacioni është jetësor për industrinë e udhëtimit dhe përdorimi efektiv i saj është i rëndësishëm. Prandaj, "një sistem i IT-së është duke u përhapur me shpejtësi në të gjithë industrinë e turizmit dhe asnjë aktor nuk do të shpëtoj nga ndikimet e saj". Ndryshe nga mallrat e prekshëm dhe të qëndrueshmë, shërbimet e turizmit të paprekshme nuk mund të shfaqet fizikisht në pikën e shitjes para blerjes. Ato janë blejre para kohës së përdorimit të tyre dhe larg nga vendi i konsumit. Prandaj ata varen ekskluzivisht nga përshkrimet, të siguruara nga tregtia e udhëtimit, (p.sh. informacionet në broshura), dhe nga aftësia e tyre për të tërhequr konsumatorët. Informacionet në kohë dhe të sakta, shumë të rëndësishme për nevojat e konsumatorëve, shpesh janë çelësi për kënaqësinë e kërkesës turistike. Prandaj, informacioni lehtëson zhvillimin e turizmit.

Revolucioni i TIK ka ndikim të thellë në menaxhimin e industrisë së turizmit, kryesisht ndikon duke bërë të mundur bashkëpunimin efikas në kuadër të industrisë si dhe duke ofruar mjete për globalizimin e saj. Në aktivitete të tjera ekonomike - gjenerimi, grumbullimi, përpunimi, zbatimi dhe komunikimi i informacionit është i rëndësishëm për punët e përditshme. Zhvillimi i shpejtë i kërkesës dhe ofertës e bën TIK një partner të domosdoshëm, duke luajtur në këtë mënyrë një rol gjithnjë e më shumë të rëndësishëm në fushën e marketingut turistik, në shpërndarje, promovim dhe koordinim.

Teknologjitë e Informacionit dhe rritja e Kërkesës për Turizëm tregojnë se "çelësi i suksesit qëndron në identifikimin e shpejtë të nevojave të konsumatorit dhe në arritjen e klientëve të mundshëm me informacion të plotë dhe të personalizuar sipas nevojave".

Turistët sa po vjen dhe po bëhen më të sofistikuar në kërkesat e tyre duke kërkuar produkte me cilësi të lartë. Kështu, destinacionet turistike duhet të ofrojnë metoda të reja për ofrimin e e ofertës së tyre turistike. Përdorimi i internetit ka rritur kërkesën e turistit për të marrë vesh më shumë informacione rreth zonës dhe vendeve turistike. Në mënyrë që të plotësohet kërkesa e turistëve dhe në mënyrë që kjo kërkesë të zgjasë në kohë duhet përfshirë teknologjia, për të rritur sa më shumë interaktivitetin. Interneti bën të mundur që udhëtarët të kenë një informacion të besueshëm dhe të saktë, si dhe ju jep mundësinë për realizimin e rezervimeve në kohë reale dhe me kosto sa më të ulët. Interneti përmirëson cilësinë e ofrimit të shërbimit dhe e bën turistin më të kënaqur.

Kënaqësia e turistit varet shumë nga saktësia dhe tërësia e informacionit të ofruar për destinacione specifike, shërbimet, atraksionet dhe aktivitetet. Informacioni zvogëlon sa më shumë- hendekun e surprizave të pakëndshme midis asaj që pritet nga turisti dhe realitetit. Përveç kësaj interneti jep mundësinë për të rritur kënaqësinë e turistit dmth: turisti ka më shumë informacion dhe ka mundësi për zgjedhje, zvogëlon burrokracitë për shërbimin ndaj klientit, personalizon produktin sipas individit (psh kërkesat dietike, apo ushqimet alergjike), shërbime të personalizuar dhe në fund një integrim sa më i mirë i shërbimeve për një organizim më të mirë.

Interneti plotëson nevojat e turistit për një akses në informacion sa më të thjeshtë dhe transparent. Interneti mundëson ofrimin e disa varieteteve të ndryshme udhëtimi si: strehim, shërbim në kohën e lirë, destinacionet, paketa pushimesh, si dhe të shfaqin çmimet aktuale dhe disponueshmërinë e shërbimeve të tilla. Këto shërbime në të njëjtin moment japin një konfirmim të menjëhershëm dhe rezervim të menjëhershëm , duke lejuar në këtë mënyrë fleksibilitet dhe duke i dhënë mundësinë turistit të lëvizë dhe në "minutën e fundit". Aksesit në informacion që përfshin të gjitha aspektet e veprimtarive turistike ofron kornizën për ofrimin e shërbimeve të personalizuar në nivelet e çmimeve, të krahasueshme këto me ato të paketave turistike.

Përdorimi i internetit i jep të drejtën turistëve të shfrytëzojnë faqet komerciale dhe jo-komerciale të Internetit për planifikim, kërkim, blerje dhe ndryshim në udhëtimin e tyre. Nga studime të ndryshme është vërejtur se turistët kanë më shumë besim në informacionet e ofruara në internet për udhëtimet e tyre.

SINTEZË - KONTRIBUTI I TIK NË INDUSTRIJËN E TURIZMIT NË TË ARDHMEN

Teknologjitë e informacionit ndikojnë në menaxhimin strategjik dhe në marketingun e organizatave bashkëkohore, duke transformuar praktikën "më të mira" të biznesit në praktika në nivel global. TIK transformon pozicionin strategjik të organizatave duke ndryshuar efikasitetin, diferencat, kostot operative dhe përgjigjen në kohë.

Në mënyrë të veçantë, TIK ka nxitur ndryshime rrënjësore në funksionimin dhe shpërndarjen e industrisë së turizmit. Ndoshta shembulli më i dukshëm në turizëm është procesi i rezervimit, i cili gradualisht i mundëson konsumatorëve dhe industrisë për të kursyer kohë të konsiderueshme në identifikimin, grupimin, rezervimin dhe blerjen e produkteve të turizmit. Në fund të fundit, turistët e ardhshëm do të jetë në gjendje të kërkojnë nëpër internet dhe të identifikojnë një shumëllojshmëri të pasur të ofertave në mënyrë që të bëjnë zgjedhjen më të përshtatshme të udhëtimit duke përmbushur kërkesat e tyre personale.

Fokusi është duke u zhvendosur drejt paketave të udhëtimit individuale dhe dinamike, duke synuar mini-segmente. Vizibiliteti në treg do të jetë në funksion të teknologjive dhe rrjeteve që përdoren për të bashkëvepruar me klientët individualë dhe institucionalë. Një bashkëpunim më i ngushtë është i nevojshëm në të gjithë industrinë e turizmit, si dhe një shkallë të caktuar e standardizimit e cila do të përmirësojë shërbimin dhe do t'i mundësojë organizatave të turizmit për të menaxhuar konkurrencën e tyre në kuadër të mjedisit të ri të vendosur nga zhvillimet bashkëkohore, të tilla si liberalizimi dhe globalizimi. TIK ofron një mundësi të paparë për integrimin horizontal, vertikal dhe diagonal, si dhe për zhvillimin e ndërmarrjes.

TIK mundëson trajnim dhe edukim të burimeve njerëzore si dhe ndihmon në menaxhim dhe i mundëson industrisë për të kuptuar dhe zhvilluar një vizion për të ardhmen. Megjithatë, TIK nuk

është një “ilaç” dhe për këtë arsye, një rishikim të plotë të të gjitha praktikave menaxhuese operacionale dhe strategjike janë të nevojshme për të arritur përfitimet e duhura dhe të pritshme.

Nëse operatorët turistikë e lenë pas dore rëndësinë e saj, ata rrezikojnë konkurrencën e tyre në mënyrë efektive dhe bëhen të marginalizuar nga rrjedhat e sektorit të turizmit. Si rezultat, aktorët turistikë duhet të kuptojnë, të përfshihen dhe të shfrytëzojnë TIK në mënyrë që të jenë në gjendje për t'i shërbyer tregjeve të synuara, për të përmirësuar efikasitetin e tyre, për të maksimizuar përfitimin, për të rritur shërbimet. Suksesi i aktorëve turistikë do të përcaktohet nga një kombinim i menaxhimit inovativ dhe marketingut, intelektit dhe vizionit, si dhe përdorimit në mënyrë strategjike të avantazheve të tij.

PROJEKTE

TIK përdoret për qëllime të marketingut të turizmit në rajone të ndryshme Alpine siç mund të përmbledhen më poshtë:

a. në Valle d'Aosta, ka filluar vite më parë një projekt të financuar nga Bashkimi Evropian për menaxhimin e automatizuar të informacionit turistik, me qëllim krijimin e një rrjeti midis aktorëve turistik dhe lidhja me rajonet e tjera evropiane. Baza e të dhënave u hodh dhe në një faqe web-i (www.regione.vda.it) e cila ka një seksion të dedikuar për turizmin. Nga ana tjetër, faqja është e lidhur nëpërmjet një seri lidhjesh me bazat e tjera të të dhënave të operatorëve, duke përfshirë hotelet, operatorët lokal, organizatat dhe shoqatat që merren me turizmin dhe që ofrojnë oferta turistike.

Hotelet që janë të vendosura në rrjetin turistik kanë mundësi për të vendosur një përshkrim të strukturës së tyre, kontakte dhe ekziston mundësia për akses direkt me e-mail ose rezervim online.

b. Piemonte, ka një websitë të Rajonit i cili nuk është i zhvilluar specifikisht për turizmin. Nuk ka asnjë bazë të dhënash qendrore, ku agjencitë turistike lokale të kenë mundësi të dërgojnë informacionet e tyre. Një realitet në zhvillim është "Agjencia e pranimit dhe promovimit të turizmit në Valle di Suza, Sangone dhe Pinerolo - Montagnedoc", i cili synon të promovojë

veprimtarinë turistike, operatorët publikë apo privatë turistikë që operojnë në zonë. Gjithashtu realizon dhe veprime komerciale për informim dhe rezervim online.

- c) Në Lombardi ka një web zyrtar për promovimin e turizmit (www.regione.lombardia.it). Vendpushimet alpine në Lombardi përfaqësohen nga zonat e Valtellina dhe Livigno, dhe të dyja këto zona kanë web-site t e tyre për të promovuar turizmin, shërbimet online, duke u mbështetur në një mjedis shumë të favorshëm pasi në zonë ka shumë ofrues interneti dhe Tik është e përhapur dhe është në dispozicion të hoteleve. Gati të gjithë hotelet kanë një faqe interneti dhe kanë dhe ofrojnë mundësinë e rezervimeve online. Këtu mund të gjejmë dhe informacione që kanë të bëjnë me aktivitetet e skive në dimër, çmimet, kushtet e motit etj. Megjithatë, qëllimi është që në të ardhmen të zhvillohen marketim i shërbimeve turistike të integruara.
- d) Në Friuli ka një web-sit zyrtar të rajonit i i cili nuk ka një seksion të dedikuar turizmit. Pjesa e aktorëve turistikë që operojnë në zonë kanë një faqe interneti www.piancavallo.com me karakter vetëm informues.
- e) Në zonën e Venetos, është realizuar projekti “Sistemi Informativ Rajonal Territorial dhe Turistik” i cili bëri të mundur lidhjen e shërbimeve turistike dhe lidhjen e të gjitha enteve turistike në një server qëndror. Në këtë rrjet bëjnë pjesë Shërbimet e Departamentit Turistik, entet lokale, organizatat institucionale, hotelet, operatorët turistik, agjensitë e udhëtimeve (www.apt-dolomiti-cortina.it).
- Ky shërbim bën të mundur dhënien e një informacioni të plotë tek turistët e interesuar.
- f) Në zonën e Alto Adige, për promovimin e turizmit të zonës dhe marketimit të saj në internet, është krijuar një ndërmarrje specifike, SinfoNet. Kjo kompani ka krijuar një faqe interneti e cila mundëson marrjen e të gjithë informacionit turistik dhe kryerjen e prenotimeve online për akomodim apo shërbime të tjera turistike që ofrohen në Alto Adige, www.hallo.com. Gjithashtu, ka edhe iniciativa të tjera të ofruara online për turistët si aplikacione në telefona për gjetjen e një vendodhjeje të caktuar, blerje e biletave online pa patur nevojën e qëndrimit në rradhë apo prenotimin e një turi turistik malor. (www.altabadia.it, www.val-gardena.com, www.dolomitisuperski.com).

Në Austri, Turizmi si shumë sektorë të tjerë, është i organizuar në mënyrë shtetërore.

Për menaxhimin e turizmit është krijuar shoqata autonome Tiroi, e cila mbledh në ombrellën e saj 160 organizata turistike lokale. Shoqatat e turistike lokale luajnë një rol kryesor me tregtarët duke kryer funksionet e rezervimit dhe organizimin e aktiviteteve në zonë.

Në kushtet e teknologjive të informacionit, Tiroi ka një Sistem të Menaxhimit të Destinacionit, e cila lejon mbledhjen e çdo informacioni turistik, qoftë dhe shërbime turistike apo rezervim hoteli. Faqja e internetit zyrtare për promovimin e turizmit është www.austria-tourism.at. Sistemi që përdoret është zgjedhur për të përmbushur nevojat e bizneseve dhe organizatave turistike të madhësive dhe kategorive të ndryshme si: hotele, guest house, hostele, Campgrounds, shkolla e skive dhe e sportit. Shërbimet e ofruara janë të ndryshme, duke filluar nga krijimi i faqes, trajnimi për përdorimin e tij, menaxhimi i proceseve të biznesit, krijimi i ofertave turistike. Është e rëndësishme të theksohet se sistemi lejon përdorimin e teknologjive hap pas hapi, duke nisur nga një proces i ngadaltë i cili nuk e detyron pronarin të blejë një kompjuter por e lejon që në fazën fillestare të përdorë faks ose telefon.

Interneti dhe Turizmit Kulturor - projekti MEDINA: Turizmi kulturor është një shembull shumë i mirë për të treguar se si teknologjia online apo përdorimi i internetit ka ndikuar në zhvillimin e turizmit. Turizmi kulturor fokusohet në prezantimin e trashëgimisë kulturore të zonës, duke filluar nga mjedisi nëpërmjet komponentëve historikë, artistikë, arkeologjikë dhe folklorikë. Një shembull specifik i kësaj forme të turizmit është projekti MEDINA (Mesdheut nga qasja në internet). Ky projekt është realizuar në 2002-2005 si një projekt shumë i suksesshëm i cili krijoi një portal web-i për kulturën e 14 vendeve të mesdheut. Qasja në portal nga ana e turistit mund të realizohet edhe përmes telefonit apo pajisjeve të tjera mobile, duke lejuar që të marrë informacione mbi kulturën e zonës. Pajisjet e lëvizshme janë duke u përdorur gjithnjë e më shumë për konsumimin e shërbimeve turistike.

Këto projekte janë një eksperiencë e mirë për t'u përshtatur dhe ndjekur për zhvillimin e turizmit në zonën e mbuluar nga projekti IBB e parë në marrëdhënien ndërkufitare dhe si pjesë e zhvillimit rajonal.

KAPITULLI II

“Përgatitja e listës së operatorëve dhe ofruesve të internetit broadband në zonën e përzgjedhur, vlerësimi i kuadrit ekzistues ligjor dhe i dokumenteve politike shoqëruar me sugjerime për përmirësimin e tyre, evidentimi i sinergjive të përdorimit të internet broadband për rritjen e bashkëpunimit ndërkuftar në shkëmbimet e vizitorëve/turistëve si dhe në rritjen e shkëmbimeve tregëtare”

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe zhvillimet në rrjetet dhe shërbimet broadband janë duke u bërë gjithnjë e më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik e social të vendeve kudo në botë. Kur flasim për TIK, shpesh kuptojmë një teknologji të interesit të përgjithshëm, pasi është e një rëndësie jetike në vargun e shërbimeve utilitare si energjia, uji etj. për çdo sektor të ekonomisë dhe shoqërinë në tërësi.

Zhvillimi i broadband është pjesë e objektivave globale të përcaktuara nga ne Samitin Botëror për Shoqërinë e Informacionit (WSIS) dhe Komisioni i Broadband i krijuar nga ITU, UNESCO dhe UN. Ka katër objektiva të qarta janë në nivel global për zhvillimin e broadbandit:

- Objektivi 1:** Broadband një politikë e përgjithshme. Në fund të vitit 2015, çdo vend të ketë adoptuar strategjinë e broadbandit.
- Objektivi 2:** Broadband të jetë i përballueshëm. Në fund të vitit 2015, shërbimet bazë të broadband të jenë të përballueshëm në vendet në zhvillim.
- Objektivi 3:** Broadband në shtëpi. Në fund të vitit 2015, 40% e shtëpive të kenë akses në broadband në vendet në zhvillim.
- Objektivi 2:** Akses në Internet. Në fund të vitit 2015 penetrimi i Internetit të jetë 60% në vendet në zhvillim dhe 15% në vendet me pak të zhvilluara.

Shkalla e përdorimit të TIK është rritur ndjeshëm në nivel global, rajonal dhe lokal. Përdorimi i telefonisë celulare në shumë vende në bote e kapërcen shkallen 100% të penetrimit dhe përdorimi i Internetit është rritur shpejt. Shumë shërbime publike janë duke u zhvilluar mbështetur në platformat elektronike. Biznesi është duke adoptuar modele të reja të mbështetura në TIK dhe mjedisin online. Sasi e madhe informacioni shkëmbehet sot në rrugë elektronike. Interneti dhe faqet elektronike të biznesit janë një mundësi shumë e mirë për rritjen e prezencës tregëtare edhe për

biznese të vegjël dhe nga vende të vogla. Përdorimi i broadbandit dhe shërbimeve online është gjithashtu një mjet për rritjen e efektivitetit dhe transparencës së qeverisjes si në nivel qendror dhe lokal.

Sipas të dhënave të fundit të publikuara nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve:

- Penetrimi i përdoruesve të Internetit ka arritur në nivel global në 40%. Numri i përdoruesve të Internetit në botë në fund të vitit 2014 pritet të arrije në 3 miliard. 2/3 e tyre i përkasin vendeve në zhvillim.
- Në fund të vitit 2013 penetrimi i mobile broadband arriti në 32% ose në 2.3 miliard përdorues që përbën një dyfishim kundrejt vitit 2011 ose një rritje me pesë herë kundrejt vitit 2008.
- Mobile broadband mbetet segmenti më i shpejtë i rritjes në tregun e telekomunikacioneve. Penetrimi mobile broadband sipas treguesve mesatare sipas rajoneve është në nivelet më të larta në Europë me 64% dhe në Amerikë me 59% .
- Numri total i abonentëve celularë në bote në fund të 2012 arriti në 6.8 miliardë dhe në fund të këtij viti mendohet të arrije në 7 miliardë abonentë.

Përdorimi TIK është rritur ndjeshëm dhe në Shqipëri në dhjetëvjeçarin e fundit. Referuar të dhënave për treguesit kryesor TIK si penetrimi i telefonisë celulare, rritja e lidhjeve broadband dhe në veçanti penetrimi i mobile broadband tregon që zhvillimet në vendin tonë, ndjekin trendin global dhe rajonal.

Sipas të dhënave të publikuara nga AKEP, penetrimi i telefonisë celulare bazuar në kartat SIM aktive është në 130%. Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks dhe celular (3G me karta USB/modem) në fund të vitit 2013 arriti në rreth 294 mijë që përbën një rritje me rreth 36.7% në krahasim me vitin 2012.

Numri i pajtimtareve me akses broadband mbështetur në celular (3G me karta USB/modem për përdorim me kompjuter) në fund të vitit 2013, arriti në 111 mijë nga 55 mijë në fund të vitit 2012, që përbën një rritje me mbi 100%.

Rritje të madhe ka dhe numri i përdoruesve me akses broadband 3G nga aparatet celulare, smart phone duke arritur në fund të vitit 2013 në 1,119,892 kundrejt 594 mijë në fund të vitit 2012. Kjo përbën një rritje me 88%.

Me rritje me 14% është dhe numri i lidhjeve fikse broadband ndërkohë penetrimi i telefonisë fikse është ulur dhe mbetet në 10%.


Një veçori tjetër e viteve të fundit është rritja e shpejtësisë/kapacitetit të ofruar të internetit dhe ulja e çmimit për aksesin internet.

Pavarësisht treguesve pozitive për rritjen e përdorimit të TIK dhe shërbimeve broadband në shkallë vendi, situata nuk është e njëjtë në të gjithë vendin. Studimet e kryera dhe rezultatet e Census 2011, të kryer nga INTAT tregojnë se shkalla e përdorimit TIK është e ndryshme në qarqe të ndryshme të vendit. Shkalla e mbulimit me shërbim broadband është gjithashtu jo e njëtrajtshme në të gjithë vendin. Zona rurale mbeten ende pa shërbime broadband.

Potencialet dhe përfitimet që ofron teknologjia TIK janë një mundësi e mirë për të mbështetur dhe komunitetin e bizneset në zonen e Bjeshkëve të Namuna që ky projekt dhe ky studim analizojnë në veçanti.

Duke pasur parasysh që zhvillimi i broadband përmbledh disa aspekte të ndërthura midis tyre sikurse jepet në skemën e thjeshtë të ekosistemit të broadband më poshtë:

SKEMA 1



Modeli i prezantuar me sipër mbështetet në tri shtresa që ndërthurin katër fusha të lidhura. Ky studim analizojnë dy nga shtresat e ekosistemit duke u ndalur fillimisht në anën e ofrimit të shërbimit dhe infrastrukturës broadband dhe më pas në analizën e politikave, kuadrit ligjor e rregullator që mbështesin zhvillimin e broadbandit.

Duke identifikuar listën e operatorëve që ofrojnë shërbime dhe rrjete në zonën e Bjeshkëve të Namuna studimi ndihmon në identifikimin e gadishmërisë nga ana e ofruesit, “supply side” për zhvillimin e broadbandit në zonë. Ndërsa analiza e kuadrit ligjor dhe politikave për zhvillimin e

broadbandit ndihmon në identifikimin e çështjeve që duhen mirë adresuar me qëllim nxitjen e zhvillimit të broadbandit në këtë zonë.

Në tërësi kuadri ligjor për komunikimet elektronike që rregullon veprimtarinë për ofrimin e aksesit në rrjetet broadband është i përputhur dhe në harmoni me acquis të BE-së. Plani Kombëtar i Broadbandit është miratuar vitin e kaluar po ende nuk ka filluar një zbatim konkret i tij në të gjitha nivelet e parashikuara. Legjislacioni për planifikimin e territorit është në ndryshim. Pritet të adoptohet kuadri nënligjor për lejet për zhvillimin e infrastrukturës.

Strategjitë rajonale për zhvillim në qarkun e Shkodrës dhe Kukësit aktualisht nuk mbulojnë qartesisht TIK. Këto dokumenta janë në proces rishikimi.

Strategjia e re Dixhital Axxhenda 2014-2020 është në proces draftimi. Kjo strategji duhet të mbështesë zhvillimet e rrjeteve dhe shërbimeve broadband në zonat rurale dhe në Bjeshtëkët e Namuna.

Strategjitë ndërsektoriale si e turizmit, planifikimi i territorit, strategjie për Axxhendën Dixhitale duhet të harmonizohen me qëllim rritjen e sinergjive për projektet në zhvillim dhe në të ardhmen. Projektet e financuara nga FSHZH duhet të konsiderojnë infrastrukturën TIK si pjesë e të gjitha zhvillimeve për infrastrukturën rrugore, të utiliteteve etj.

Edhe pse nuk është pjesë e studimit analiza e gadishmërisë së përdoruesit të shërbimeve broadband në zonën e Bjeshtëkëve të Namuna kjo nuk është lënë jashtë vëmendjes. Në studim kjo sillet përmes nënvizimeve nga studime dhe vrojtme të mëparshme të hulumtuara në kuadër të këtij studimi. Në tërësi evidentohet mungesa e përvojës në përdorimin TIK, kryesisht nga personeli i hoteleri turizëm si dhe mungesa e stafit TIK në disa nga NJQV-të e vrojtuar.

Përmirësimi i situatës së TIK dhe përdorimit të broadband në këtë zonë do t'i shërbejë zhvillimit ekonomik të zonës dhe rritjes së bashkëpunimit ndërkufitar, shkëmbimit të vizitorëve, turistëve në dy anët kufitare të Bjeshtëkëve të Namuna dhe rritjes së shkëmbimit tregtar.

Hyrje

Zhvillimi i broadbandit shihet sot si një motor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe social të vendeve. Komunikimet në tërësi dhe sektori TIK janë gjithnjë e më shumë një nevojë e qenësishme në vargun e utiliteteve jetike për shoqërinë.

Plani kombëtar për zhvillimin e broadbandit¹ i miratuar vitin e kaluar në hyrje të tij ka nënvizuar për situatën në Shqipëri se:

Akoma ekzistojnë në vend, shumë zona të quajtura “zona të bardha”, në të cilat nuk ofrohen shërbimet Broadband, veçanërisht në zonat më të thella rurale. Për të nxitur shtrirjen dhe rritur ndërgjegjësimin për përfitimet nga TIK në jetën e përditshme, në punë, në edukim, tregti, në qeverisje dhe shëndetësi si dhe për të rritur investimet në të gjithë vendin, do të përcaktohen masa të veçanta që do të kenë si objektivat zonat ku nuk ofrohet shërbim dhe zonat ku ofrohet pak shërbim, përfshirë zonat e thella rurale.

Zona e mbuluar nga projekti “Promoting Connectivity of Internet Broadband in the Accursed Mountain Border Area”, përfshin komuna dhe fshatra të thella ku shërbimet broadband nuk janë prezent dhe të mundura për të gjithë.

Ky studim, përfshin tri seksione kryesore:

- Evidentimin e listës së operatorëve të komunikimeve elektronike që operojnë në zonë
- Analiza dhe vlerësimi i politikave legjislatoni në fuqi për broadband
- Evidentim i projekteve të zhvilluara dhe në proces në zonën e Bjeshkëve të Namuna

Përmes evidentimit të listës së operatorëve të komunikimeve elektronike që operojnë në zonë synon të japë një tablo për gadishmërinë e tregut në ofrimin e shërbimeve broadband në *kejtë* zonë. Studimi konsideron dhe situatën faktike të evidentuar gjatë takimeve të zhvilluara nga grupi i projektit në komunat e zonës në lidhje me prezencën e shërbimeve të internetit dhe broadbandit.

Në vijim, përmes analizës dhe vlerësimit të legjislatoni në fuqi, politikave për zhvillimin e broadbandit, por dhe ato për zhvillimin ekonomik e social të zonës studimi synon të evidentojë

¹ Plani Kombëtar për Zhvillimin e Broadbandit, VKM Nr. 468 date 30.5.2013

hapësirat për përmirësim në legjislacion si dhe politikat e nevojshme me qëllim nxitjen e zhvillimit të broadbandit në Bjeshkët e Namuna si nxitës për zhvillimin ekonomik dhe social të kësaj zone.

Një shikim mbi projektet e zhvilluara, projektet në proces dhe ato të planifikuara për këtë zonë i shërben analizës për sinergjitë në zhvillimin e broadbandit në interes të përmirësimit të jetës, aktivitetit të përditshëm të komunitetit në këtë zonë, biznesit dhe turizmit.

OPERATORËT & OFRUESIT E INTERNETIT NË ZONË

Ofruesit e shërbimit telefonik dhe Internetit

Numri i sipërmarrësve të autorizuar për të ofruar shërbime telefonike dhe Internet është rritur shumë pas hapjes së plotë të tregut të telekomunikacioneve në vitin 2008. Aktualisht në tregun e shërbimit Internet janë autorizuar nga AKEP mbi 130 ofrues të shërbimit Internet, ISP.

Në treg operojnë katër operatorë të telefonisë celulare që njëkohësisht ofrojnë shërbime data dhe Internet. Tre prej tyre ofrojnë mobile broadband data në 3G bazuar në HSPA dhe HSPA + me shpejtësi masimale deri në 42 Mbit/s.

Aktualisht numri i operatorëve alternative me të drejtën e ofrimit të shërbimit telefonik fiks është mbi 80, por operatorë aktive që ofrojnë shërbim janë 77.

Lista e plotë e operatorëve alternative që ofrojnë telefoni fikse dhe Internet jepet në Aneksin 1. Për ofrimin e shërbimit me ndryshimet ligjore në 2008 nuk ka kufizime gjeografike, por pjesa më e madhe e tyre janë me shtrirje lokale ose rajonale.

Në zonën e mbuluar nga projekti që shtrihet në Qarkun e Shkodrës dhe Kukësit, numri i operatorëve që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike është rreth 20. Në këtë listë përfshihen operatorët kryesore me shtrirje kombëtare si Albtelecom sh.a., AMC sh.a., Vodafone Albania sh.a., Plus Communications, operatorët alternative si Abcom, Abissnet, Primo, ASC si dhe një numër operatorësh që veprojnë kryesisht lokalisht në zonë si Xheni Ad, Sajet shpk, Ej&Bi, Telekom Postriba, I.B.C etj.

Tabela 13

Në tabelën më poshtë jepet lista e operatorëve në zonen Shkodër, Kukës dhe shërbimet kryesore që ofruara.

Nr.	Operatori	Shërbimet	Zona e operimit/shtrirja
1.	Albtelecom sh.a.	Telefoni fikse dhe celulare, internet fiks broadband, data linja me qera etj.	Kombëtare
2.	AMC sh.a.	Telefoni fikse dhe celulare, internet 3G, data, linja me qera etj	Kombëtare
3.	Vodafone Albania	Telefoni fikse dhe celulare, internet 3G, linja me qera etj	Kombëtare
4.	Plus Communications	Telefoni celulare, internet EDGE, linja me qera etj	Kombëtare
5.	Abcom sh.p.k.	Telefoni fikse internet fiks broadband, data, linja me qera etj	Kombëtare/qytetet kryesore
6.	Abissnet sh.a.	Telefoni fikse, internet fiks broadband, data, linja me qera etj	Kombëtare/qytetet kryesore
7.	ATU	Rrjet FO, broadband, data, linja me qera	Akset kryesore rrugore
8.	Primo	Telefoni fikse, internet fiks broadband, data, linja me qera etj	Kombëtare/qytetet kryesore
9.	ASC/Tring	Internet/lidhje satelitore	Rajonale/lokale
10.	Interpost shpk (Posta Shqiptare)	Internet	Pikat e aksesit
11.	Telekom Postriba shpk	Telefoni fikse, internet etj	Lokale
12.	Xheni Ad	Telefoni fikse, internet etj	Lokale
13.	Ej&Bi shpk	Telefoni fikse, internet etj	Lokale
14.	Cable Albania shpk	Rrjet/linja me qera	Rajonale/lokale
15.	DOVA shpk, Komuna Ana e Malit	Telefoni fikse, internet etj	Lokale
16.	I.B.C. shpk	Telefoni fikse, internet etj	Lokale
17.	Popaj Klodiano shpk, Komuna Kastrat, Bajze, Malesi e madhe	Telefoni fikse, internet etj	Lokale
18.	Sajet shpk	Telefoni fikse, internet etj	Lokale
19.	A.T.N sh.p.k.	Telefoni fikse, internet etj	Lokale
20.	Bujar Shimaj	Telefoni fikse, internet etj	Lokale
21.	Satlink	Telefoni fikse, internet etj	Lokale
22.	Shkodra Intel TV shpk	Telefoni fikse, internet etj	Lokale

Një përshkrim i detajuar mbi shërbimet e komunikimeve elektronike për të cilat janë autorizuar këta operatorë jepet në Aneksin 2.

Ofruesit e linjave me qera

Bazuar në analizën e tregut për linjat me qera të AKEP², rezulton se sipërmarrës të autorizuar për ofrimin e shërbimit të linjave me qera në vitin 2013 janë 22 sipërmarrës. Jo të gjithë këta sipërmarrës janë aktive dhe ofrojnë shërbim. Rezulton se rreth 15 sipërmarrës ofrojnë linja me qera por operatorët kryesore që ofrojnë linja me qera janë:

- Albtelcom sh.a
- IT-Tirana
- Tel-Kom
- Primo communication
- AMC
- Vodafone
- Abcom
- Communication Progres shpk dhe
- ATU.

Ofrimi i linjave me qera bëhet në nivel shumice dhe në nivel pakice për përdoruesit. Ofrimi në nivel shumice shërben përmbushjen e kërkesave/kapaciteteve shtesë për telefoninë fikse, internetin për operatorët e tjere dhe pastaj mund të dedikohen për nivelin e pakicës për shërbimet e telefonisë fikse, celulare, linjë me qera, për internet etj.

Në nivel backbone kemi një situatë ku dy janë sipërmarrësit me prezencë më të madhe sic jepet në tabelën e mëposhtme:

Operatori	Gjatesia e rrjetit FO (ne km)	Prezenca
Albtelcom	1409	Në qytetet kryesore dhe akset rrugore kryesore
ATU	752	Akset rrugore Tiranë-Vlore, Rrogozhinë-Korcë, Tirane-Kukës; Tiranë-Shkodër-Han i Hotit
Abcom	240	Qyteti: Tiranë, Durrës, Shkodër, Lushnjë, Vlorë
Primo	230	Qyteti: Tiranë, Durrës, Shkodër, Aksi Tiranë-

² www.akep.al/konsultime/ konsultime te perfunduara

		Rinas
Abissnet	152	Qyteti: Tiranë, Durrës, Shkodër, Golem (Kavajë)
Itel	147	Qyteti: Tiranë
Nisatel	129	Qyteti: Vlorë
ITirana	92	Qyteti: Tiranë
Tring	69	Qyteti: Tiranë
Keminet	12	Qyteti: Tiranë

Sikurse jepet në zonën e mbuluar nga projekti operatorët që mundësojnë shërbimin e linjës me qera janë katër:

- Albtelecom sh.a.
- ATU
- Abcom shpk
- Abissnet shpk

Në tregun e linjave me qera ka 10 operatorë që kanë investuar në rrjete me fibra optike dhe janë prezent në qytetet kryesore me këto infrastruktura. ATU ka investuar në rrjet backbone me fibra optike dhe është prezent në akset rrugore kombëtare që lidhin qytetet kryesore ku është prezent Albtelecom.

Një numër i madh operatorësh kanë lidhje mikrovalore në rrjetin e tyre backbone. Albtelecom ka rreth 1400 km fibra optike dhe 2150 km kabell bakri dhe është prezent në të gjitha akset kryesore me rrjet transmetimit. Operatori ATU ka një shtrirje në akset kryesore rrugore si: Tiranë-Vlorë, Rrogozhinë-Korçë, Tiranë-Kukës, Tiranë –Shkodër – Hani i Hotit etj (rrjet me fibër optike).

Në qytetet Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Lushnjë ka 239 km fibër të Abcom. Abissnet ka shtrirë me fibër optike prej 152 km në Tiranë, Durrës, Shkodër, Kavajë, Lushnjë, Fier, si dhe 338 km kabell bakër. Në qytetet Tiranë, Durrës, Shkodër është prezent me një shtrirje prej 230 km fiber dhe Primo shpk.

Situata faktike për shërbimin e Internetit në Komunitet e zonës

Vizitat në terren të kryera nga stafi i projektit në Komunën Kelmend, Komunën Kastrat, Komunën Qendër Koplik, Komunën Shkrel-Dedaj, Komunën Margegaj, Komunën Lekbibaj, Komunë Tropojë e Vjetër, Komunën Bujan, Komunën e Shalës japin këtë situatë për sigurimin e Internetit:

Qarku Shkodër:

Në qark ka prani të fibrës optike të Albtelecom dhe ATU, në rrugët kombëtare, si dhe rrjet të operatorëve: Abcom, Abissnet, Primo etj. Rrjet kabllor koaksial, mbulim me rrjet celular 3G etj. Jo të gjitha komunitet mbulohen me sinjal dhe kanë internet broadband.

Qarku Kukës:

Në qark ka prani të fibrës optike të Albtelecom dhe ATU, në rrugët kombëtare, që lidhen edhe me Kosovën. Operatorët kosovarë kanë filluar ofrimin e shërbimeve në bashkëpunim me operatorët e regjistruar në Shqipëri. Jo të gjitha komunat mbulohen me sinjal dhe kanë internet broadband.

Komuna Kelmend:

Ofrimi i Internetit për komunën me lidhje satelitore, kompania Starsat; cilësia e dobët; lidhje satelitore nga kompania ASC përmes PAP2. Në këtë komunë nuk ofrohet lidhje me ADSL (linja kablllore e dëmtuar, vjedhur); mbulimi me rrjetin celular jo i mirë pjesë të rrugës pa mbulim ose me mbulim të dobët. 150 familje me lidhje internet wireless të mundësuar nga kompani lokale.

Komuna Kastrat:

Shërbimi i internetit është i shtrirë kudo në lokalitetet e komunës së Kastratit. Mbulimi nga operatorët mobile është i plotë. Komuna Kastrat, ka tre qendra shëndetësore të pajisuara me internet, nga projekti i PAP 2. Ofrimi i internetit në Bajzë qendër bëhet nga dy tre operator shpërndarës, dhe interneti është i përhapur. Zonat që vuajnë më shumë lidhjen e internetit në komunën Kastrat janë fshatrat: Gradec, Rrapsh, Bratosh.

Komuna Qënder Koplik:

Kompanitë që veprojnë në zonë janë: I.B.C. shpk; Albtelecom; ABCOM. Ofrimi i Internetit nga këto kompani me radio (antena) dhe kabllor.

Komuna Shkrel-Dedaj:

Interneti vetem nga kompanitë celulare dhe sinjali i mirë.

Komuna Margegaj:

Ka një lidhje satelitore në komunë, në kuadër të PAP 2, por që funksionon shumë ngadalë. Përgjate luginës së Valbonës, më së shumti ka valë celulari të operatorëve Vodafone dhe AMC. Mbulimi nuk është 3G. Kompania Tring ishte prezent me një lidhje të dedikuar interneti në Kompleksin Turistik si dhe në Lokalin “Krojet e Rroganit” tek “Fusha e Gjësë”, kostoja mujore 110 euro.

Komuna Lekbibaj:

Komuna ka një lidhje me internet në kuadër të PAP 2.

Komuna Tropojë e Vjetër:

Interneti ofrohet nga operatorë kosovarë. Ka një lidhje me PAP 2, por nuk ka funksionuar mirë. Albtelekomi ofron shërbime me shumë mangësi. Ka valë celulare të disa operatorëve. Mungon interneti broadband në zonat turistike të Padesh, Kërnajë, Myrian Kucana, Bucaj, Gegaj që përbëjnë zona bjeshkësh.

Komuna Bujan:

Interneti ofrohet nga kompani lokale IH-NET Work dhe DIAM-NET. Nuk ka një rrjet me fibër optike. Lloji i teknologjisë që përdoret për këtë shërbim është nëpërmjet telefonisë celulare.

Në Bujan ka një internet kafe, por që funksionon me lidhje nga transmetues të Kosovës. IPKO e Kosovës ka sjellë kabllin e fibrës optike deri në doganën e qafës së Morinës dhe mendohet që këtë verë ta sjellë në Bajram Curri duke e shtrirë kabllin përgjatë rrugës. Me antenë në Gash, sillet sinjali i IPKO që furnizon Bujan, Lugaj, Finjë, Bajram Curri etj. Qendra shëndetësore e komunës ka pasur një lidhje internet në kuadër të projektit PAP 2, por që aktualisht nuk funksionon.

Komuna e Shalës:

Në zonën e Thethit, Bogës dhe Razmës, mbulimi me internet mobile 3G nga kompanitë celulare, është i plotë. Nuk ka fibër optike, pavarësisht se rruga për në Theth, po ndërtohet e re.

Sigurimi i konektivitetit në zonën ndërkufitare me Malin e Zi


Projekti *“Promoting Connectivity of Internet Broadband in the Accursed Mountain Border Area”*, synon nxitjen e lidhjeve të Internet Broadbandit në zonën ndërkufitare me Malin e Zi. Zhvillimi i rrjeteve kombëtare të integruara dhe të interkonektuara me rrjetin global të komunikimit është kërkesë thelbësor në fushën e komunikimit. Sigurimi i konektivitetit me kapacitete të mjaftueshme për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut dhe prespektivës është mjaft e rëndësishme.

Si vende fqinjë Mali i Zi dhe Shqipëria kanë vendosur prej vitesh rrugë të komunikimit në fushën e telekomunikacionit. Lidhjet e transmetimit me Malin e Zi kanë qenë me lidhje mikrovalore, radio rele dhe së fundmi me rrjet kabllor me fibër optike. Marrëdhëniet aktuale janë midis operatorëve vendas dhe telekomit të Malit të Zi.

Për realizimin e konektivitetit ndërkombëtar Shqipëria ka lidhje direkte me të gjitha vendet fqinjë si Italinë, Greqinë, Malin e Zi, Kosovën, Maqedoninë.

Një paraqitje e rrjetit të transmetimit me fibër optike dhe lidhjet në zonën kufitare me Malin e Zi jepen në figurën e mëposhtme³.

³ Burimi: Plani Kombëtar për Zhvillimin e Broadbandit, VKM Nr. 468 date 30.5.2013



Në zonën ndërkufitare me Malin e Zi konektiviteti realizohet me rrjetin me fibër optike, dhe me lidhje mikrovalore.

Në hartë jepen dy pika të realizimit të konektivitetit me Malin e Zi.

Prezenca në zonë e operatorëve kosovare

Nga vizitat në terren të grupit të projektit IPB rezulton se në disa komuna ofrohen shërbime nga operatorët kosovare si IPKO. Kjo lidhet me mungesën e prezencës të operatorëve vendas, mungesa e rrjetit kabllor si dhe mundësia të shtrirjes së rrjetit kabllor dhe distancës së shkurter etj. IPKO e Kosovës ka sjellë kabllin e fibrës optike deri në doganën e qafës së Morinës dhe mendohet që të shtrihet në Bajram Curri duke e shtrirë kabllin përgjatë rrugës. Me antenë në Gash, silltet sinjali i IPKO që furnizon Bujan, Lugaj, Finjë, Bajram Curri etj. Në kuadrin e projektit IBB duhet nxitur rritja e kooperimit midis dy vendeve.

VLERËSIMI I KUADRIT LIGJOR DHE DOKUMENTAT POLITIKE

Kuadri ligjor që mbulon shërbimet e internetit dhe broadbandit në vecanti përbehet nga ligji bazë për komunikimet elektronike, Ligji Nr. 9918 date 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, që rregullon veprimtarinë e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike si dhe një sërë aktesh nënligjore që lidhen me zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve broadband sikurse VKM Nr. 468 date 30.5.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Broadbandit”, VKM Nr. 466 date 27.2.2014 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” etj. Me zhvillimin e rrjeteve broadband lidhen dhe një sërë rregulloresh të miratuara nga AKEP.

Me ndikim në rrjetet e komunikimeve elektronike është dhe legjislacioni për planifikimin e territorit që rregullon lejet e infrastrukturës si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, rregullat që kanë miratuar e zbatojnë Njësitë e Pushtetit Vendor për lejet e infrastrukturës etj.

Një listë të plotë me dokumentet politike në nivel kombëtar, si dhe e legjislacionit përkatës për zhvillimin e broadbandit jepet në Aneksin 3, në fund të këtij studimi.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin (SKZHI) përfaqëson dokumentin strategjik themelor të vendit që harmonizon për herë të parë në një dokument të vetëm strategjik perspektivën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social, integrimin në Bashkimin Evropian dhe strukturat e NATO-s si dhe arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit. SKZHI 2007-2013 u miratua nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 342 datë 12.03.2008.

Objekti kryesor i SKZHI-së në lidhje me TIK ishte përgatitja e një politike, strategjie dhe plan zbatimi në mënyrë që të shfrytëzohen dhe zhvillohen më tej potencialet e TIK, me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektivitetit dhe transparencës në administratën publike.

Aktualisht është në përfundim strategjia e re 2014-2020 e cila e vendos TIK dhe programin dixhital si një nga prioritetet madhore të zhvillimit të vendit.

Strategjia për shoqërinë e informacionit 2008-2013

Strategjia për Shoqërinë e Informacionit u miratua nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 59 datë 21.1.2009. Vizioni i përcaktuar në të ishte të arrihet:

“Progresi i Shqipërisë drejt një ekonomie të bazuar në njohuritë, përmes një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit që do të çojë në një shoqëri ku të gjithë qytetarët përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektivitetit dhe të transparencës në administratën publike.”

Në objektivat kryesore të kësaj strategjie ishin:

- Zhvillimi dhe Përmirësimi i Infrastrukturës së Shoqërisë së Informacionit
- Plotësimi dhe përmirësimi i legjislacionit përkatës për Shoqërinë e Informacionit;
- Nxitja dhe mbështetja për zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit;
- Nxitja dhe mbështetja për zhvillimin e sektorit privat të TIK;
- Rritja e nivelit të njohurive dhe informacionit në lidhje me Shoqërinë e Informacionit dhe koordinimi i veprimeve të përbashkëta ndërmjet shtetit dhe qytetarëve.

Në zbatim të këtij dokumenti rezulton se sot ka një kuadër ligjor e institucional të plotësuar për shoqërinë e informacionit, ka disa zhvillime në fushën e e-qeverisjes, kryesisht në nivel qendror, kemi licensimin e rrjeteve mobile broadband bazuar në 3G, miratimin i një plani kombëtar të broadbandit etj.

Lidhjet fikse broadband pavarësisht rritjes vit pas viti, mbeten në nivel shumë të ulët krahasuar me vendet e tjera në rajon dhe në BE. Prezantimi i internetit broadband bazuar në celular ka rritur vitin e fundit numrin e përdoruesve të mobile broadband, por ende ka zona ku shërbimi 3G nuk ofrohet. Kjo rezulton dhe nga situata faktike e ofrimit të shërbimit në komunat e zonës së mbuluar nga projekti IBB.

Investimet në rrjetet broadband vijnë pothuajse të tëra nga sektori privat, nuk ka praktika të partneritetit publik privat dhe nuk ka skema të financimit nga shteti për rrjetet broadband në zonat rurale.

Nga Posta Shqiptare është mundësuar ofrimi i shërbimit internet në disa pika aksesit në zonat rurale. Nga situata faktike në zonë rezulton se jo në të gjitha rastet PAP2 janë funksionale.

Dokumenti i politikave për zhvillimin e broadbandit

Me VKM nr. 468 dt. 30.5.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Broadbandit”, është miratuar plani kombëtar për zhvillimin e broadbandit. Zhvillimi i broadbandit është një nga kolonat kryesore në Axhendën Dixhitale të Bashkimit Evropian, pjesë e nismave globale të mbështetura nga UN, ITU, UNESCO e shprehur dhe me krijimin e Komisionit Botëror të Broadbandit në vitin 2010. Dokumenti i miratuar me VKM nr. 468 dt. 30.5.2013, është hartuar me konsulentë të ITU-së, me konsultim me USAID dhe UNDP.

Nga analiza e këtij dokumenti shohim se zhvillimi i broadband-it është parë në disa drejtime si:

- zhvillimi i infrastrukturës: përmes nxitjes së investimeve private, krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për investime, zhvillimi i politikave spektrale për liberalizimin e spektrit (si heqja e kufizimeve teknologjike, procesi i refarming), lirimi i dixhital dividetit etj; zhvillimit të kuadrit të përshtatshëm ligjor e rregullator për broadband aksesin etj. zhvillimi i skemave të përshtatshme të financimit etj

- zhvillimi i kërkesës për broadband si një instrument nxitës për investime përmes:
 - o zhvillimeve në e-government dhe e-services
 - o zhvillimet në e-edukimin
 - o zhvillimet në e-shëndetësia etj
- bashkëpunimi publik privat, bashkëpunimi në nivelin e qeverisjes qendrore dhe asaj lokale është parë si mjaft i rëndësishëm për të lehtësuar procedurat e zhvillimit të infrastrukturës etj.

Dokumenti shoqërohet me një plan veprimi afatmesëm që ndërthur një numër të madh aktorësh dhe aktivitete. Gjithashtu dokumenti ka përcaktuar si vizion për zhvillimin e Broadband në periudhën 2013-2020:

Zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve broadband në të gjithë vendin për të përfutur akses në shërbimet elektronike në fusha të ndryshme si shëndetësi (e-health), edukim (e-education), tregti (e-commerce), shërbimet qeveritare (e-government) si dhe për të arritur përfitime të mëdha ekonomike dhe sociale për vendin tonë.

Objektivat e përgjithshëm të këtij dokumenti:

- Përmirësimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës Broadband në të gjithë vendin;
- Rritja e Penetrimin të Internetit;
- Ofrimi i Internetit me shpejtësi dhe siguri të lartë në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, përfshirë zonat rurale dhe zonat e thella.
- Rritja e konkurrencës dhe ulja e çmimeve,
- Rritja e cilësisë së shërbimit,
- Zgjerimi i numrit të shërbimeve elektronike (e-service) në dispozicion të qytetarëve shqiptar dhe dixhitalizimi i të gjitha shërbimeve publike.
- Rritja e ndërgjegjësimit të të gjitha shtresave të shoqërisë, përfshirë dhe personat me nevoja të veçanta, lidhur me përfitimet që vijnë nga përdorimi i shërbimeve Broadband.

Përputhen plotësisht me synimin e projektit IBB që synon zhvillimin e broadbandit në një zonë të thellë të vendit.

Synimet e vendosura për në fund të periudhës 2013-2020 për:

- ✓ Dyfishimin e numrit të familjeve dhe kompanive të cilat do të kenë akses në lidhjet Broadband jo më vonë se në fund të vitit 2017;
- ✓ 100% e shkollave me të paktën një lidhje internet Broadband në çdo klasë;

- ✓ 100% e universiteteve me lidhje internet Broadband me shpejtësi të lartë;
- ✓ 100% e zyrave postare të ofrojnë të paktën një lidhje internet Broadband për qytetarët. 100% e qendrave shëndetësore dhe spitaleve me të paktën një lidhje interneti Broadband.
- ✓ Mundësimin e aksesit me shpejtësi të lartë transmetimi, të paktën 100 Mbps deri në 50% e familjeve dhe të paktën 30 Mbps për të gjithë shqiptarët.

Të cilat janë të ngjashme me ato të parashikuara në Axhendën dixhitale të BE-së, dhe ambicioze. Praktika e BE-së tregon se janë miratuar programe dhe fonde të veçanta për zhvillimin e broadbandit. Aktualisht në Shqipëri nuk ka ndonjë fond të posacëm të buxhetit të shtetit të dedikuar për zhvillimin e broadbandit dhe mbështetjen e projekteve që lidhen me zhvillimin e broadbandit.

Eshtë e nevojshme që parashikimet në dokumentin e planit kombëtar për zhvillimin e broadbandit për zhvillimin e skemave të ndryshme të financimit dhe mbështetjen e projekteve për zhvillimin e broadbandit të miratohen nga qeveria.

Në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës dokumenti për planin e broadbandit parashikon:

Shtrirja dhe zgjerimi i infrastrukturës dhe shërbimeve broadband kërkon kontributin e rëndësishëm të sektorit privat, ku përfshihen një sërë operatorësh të shërbimit fiks, shërbimit të lëvizshëm si dhe ofrues të shërbimit të internetit të cilët janë aktivë në tregun shqiptar që kanë kontribuar në ndërtimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe ofrimin e shërbimeve. Zbatimi i këtij plani dhe arritja e synimeve, objektivave specifike për sigurimin e aksesit broadband me shpejtësi të lartë në të gjithë vendin përfshirë dhe zonat e largëta, kërkon më shumë investime nga sektori privat. Roli i qeverisë do të jetë kryesisht në krijimin e klimës së përshtatshme për investime, në rritjen e kërkesës, rritjen e ndërgjegjësimit për shërbimet broadband, nxitje të kooperimit dhe sinergjive midis aktorëve si dhe zhvillimin e modeleve të partneritetit publik e privat, pa dëmtuar konkurrencën e ndershme në treg.

Për secilin objektiv dokumenti ka parashikuar dhe aktivitetet që do ndërmerren si në aspektet ligjore, rregullatore dhe veprimet konkrete. Në veçanti për pjesën e infrastrukturës është dhënë orientimi për dhënien në përdorim të frekuencave me parimin e teknologji-neutraliteti, lirimi i brezit të dixhital dividentit, kryerja e procesit të refarming të frekuencave etj. Zbatimi i këtyre aktiviteteve ndërthur disa aktorë.

Eshtë e nevojshme ndërmarrja e nismave dhe aktiviteteve për përsheptimin e zbatimit të këtij plani në mënyrë të koordinuar dhe harmonizuar me të gjithë aktorët. Rritja e ndërgjegjësimit dhe kuptimit të nivelit vendimarrës në pushtetin vendor për rëndësinë e infrastrukturës broadband, rritja e ndërgjegjësimit në agjenci të ngarkuara për zbatimin e projekteve të zhvillimit rajonal dhe vendor është imediate.

Rishikimi i planit të veprimit, kooperimi publik privat, analiza e kostimit dhe krijimi i skemave të financimit për zhvillim rajonal, lokal e kombëtar duhen parë me prioritet.

Politika për zhvillimin e komunikimeve elektronike

Dokumenti i politikave të komunikimeve elektronike është miratuar me VKM Nr. 322 datë 5.5.2010. Ky dokument politikash përcakton strategjinë afatmesme të Qeverisë për zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

Vizioni i kësaj politike është që brenda shtatë viteve, komunikimet elektronike të ofrohen nga një mori operatorësh në një mjedis me konkurrencë efektive duke përdorur një gamë të gjerë teknologjish të cilat janë të lira të bartin të gjitha llojet e përmbajtjeve. Kjo politikë gjithashtu ka objektiv që aksesin në Broadband, me shpejtësi të lartë, të jetë i disponueshëm për një pjesë të madhe të familjeve që dëshirojnë ta kenë atë.

Nga analiza e planit të veprimit afatshkurtër – afatmesëm që shoqëron këtë dokument politikash mund të thuhet që pjesa më e madhe e tyre është realizuar. Plani i veprimit ka qenë për një periudhë 2010-2011. Nuk rezulton të ketë një plan veprimi të rishikuar për këtë dokument politikash.

Miratimi i këtij dokumenti politikash është pasuar me ndryshime në ligjin bazë për komunikimet elektronike me qëllim transpozimin e direktivave të 2009. Në lidhje me zhvillimin e broadbandit objektivat dhe përcaktimet e detajuara jepen në dokumentin e miratuar me VKM 468 dt. 30.5.2013.

Strategjia për transmetimet numerike

Strategjia e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetime Numerike (transmetime radio-televizive) është miratuar me VKM Nr. 292 datë 2.05.2012. Në këtë dokument parashikohet lirimi i dixhital dividetit dhe mundësimi i tij për mobile broadband.

Plani Kombëtar për Frekuencat

Plani Kombëtar i Frekuencave është dokument që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe përbën një dokument të rëndësishëm për politikën spektrale. Plani duhet të jetë në përputhje me Radio Rregulloret e ITU-se si dhe me Planin Europian të Alokimeve, ECA. Plani rishikohet periodikisht zhvillimit të Konferencës Botërore të Radiokomunikacionit, WRC.

Plani aktual është miratuar me VKM nr. 466 datë 27.2.2013, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.

Me miratimin e këtij plani përcaktimet për përdorimin e brezave të frekuencave si ato të GSM (900/1800 MHz) dhe ato për 3G, u zgjeruan edhe për teknologjitë më të fundit nën përcaktimin e gjerë IMT, u bënë përcaktime për vijimin e përdorimit të brezit të dixhital dividetit etj. Keto janë ndryshime të rëndësishme për t’i hapur rrugë zhvillimit të rrjeteve të gjeneratës tjetër.

Në këtë plan për brezin 790-862 MHz është përcaktuar: “Ky brez do të jetë në përdorim nga AMA dhe AKEP deri në përfundimin e procesit të kalimit nga transmetime analoge në transmetime dixhitale. Pas përfundimit të këtij procesi ky brez kalon në administrimin e AKEP.”

Në nivel global dhe rajonal sot është në diskutim kalimi i frekuencave të dixhital dividend 2 për mobile broadband. Për këto pritet të diskutohet dhe të ketë vendimmarrje në konferencën botërore të radiokomunikacionit në vitin 2015. Këto zhvillime duhen mbajtur parasysht në zhvillimet në vend.

Kuadri ligjor për komunikimet elektronike

Ligji “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” është gjerësisht i bazuar në paketën e direktivave të BE-së të miratuara në vitin 2002 dhe është perputhur me acquis communautaire më të fundit dhe përmirësimin e kuadrit rregullator ekzistues për komunikimet elektronike.

Paketa e direktivave të Bashkimit Evropian për komunikimet elektronike e miratuar në vitin 2002, përfshin një direktivë kuadër dhe katër direktiva të veçanta:

- Direktiva 2002/21/EC, Direktiva Kuadër
- Direktiva 2002/19/EC, Direktiva e Aksesit
- Direktiva 2002/20/EC, Direktiva e Autorizimit
- Direktiva 2002/22/EC, Direktiva e Shërbimit Universal, dhe
- Direktiva 2002/58/EC, Direktiva për Privatësinë në Komunikimet Elektronike.

Miratimi i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” shënoi një hap të rëndësishëm në drejtim të përafrimit të kuadrit ligjor dhe rregullator për komunikimet elektronike me acquis communautaire, duke realizuar liberalizimin e plotë të tregut të telekomunikacioneve dhe një reformë në regjimin e licensimit. Në veçanti miratimi i këtij ligji eliminoi pengesat që ekzistonin për hyrjen në tregun shqiptar për sipërmarrësit në fushën e komunikimeve elektronike dhe mundësoi:

- Të drejtën e çdo sipërmarrësi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike, duke përmbushur vetëm kërkesat e autorizimit të përgjithshëm, si edhe të autorizimit individual të nevojshëm vetëm në rastin e përdorimit të burimeve të fundme (frekuencave dhe numrave);
- Një mjedis rregullator të përshtatshëm, i cili respekton gjithashtu parimin e neutralitetit teknologjik;

- Hyrja në treg e lojtarëve të rinj që nuk kërkojnë përdorimin e burimeve të kufizuara, bëhet përmes procedurave të thjeshta dhe të shpejta, pa kërkuar ndonjë vendim individual paraprak të veçantë;
- Dhënien e të drejtave të përdorimit të burimeve të kufizuara përmes procedurave objektive, transparente, jo-diskriminuese dhe proporcionale.

Në vitin 2009, Bashkimi Evropian miratoi dy direktiva të reja, Direktivën 2009/136/EC dhe Direktivën 2009/140/EC, të cilat amenduan paketën e direktivave të vitit 2002, duke sjellë një sërë ndryshimesh në to. Shumë prej këtyre ndryshimeve, janë vetëm saktësime të rregullave të përcaktuara me Direktivat e vitit 2002.

Direktiva 2009/136/EC, amendoi Direktivën e Shërbimit Universal dhe Direktivën për Privatësinë në komunikimet elektronike, ndërsa Direktiva 2009/140/EC, amendoi Direktivën Kuadër, Direktivën e Aksesit dhe Direktivën e Autorizimit.

Ligji i komunikimeve elektronike parashikon plotësimin me akte nënligjor për shërbimin universal, por rezulton ende e paplotësuar.

Shqipëria, në përputhje me angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), miratuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare” duhet të bëjë përafrimin e plotë të legjislacionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik me acquis të Komunitetit.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, në nenin 104 të saj: “Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik” përcakton se:

“Bashkëpunimi do të përqëndrohet së pari në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në këtë fushë. Palët do të forcojnë, në veçanti bashkëpunimin në fushat e rrjeteve të komunikimit elektronik e shërbimeve të lidhura me to, me objektivin përfundimtar të miratimit nga Shqipëria të acquis të Komunitetit në këto sektorë një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje”.

Ndryshimet e acquis communautaire me direktivat e vitit 2009, përmes parimit “më pak rregullim por më efektiv”, synojnë një mbrojtje më të mirë të konsumatorit, zgjerojnë detyrimet për operatorët me fuqi të ndjeshme në treg duke përfshirë edhe detyrime për akses në infrastrukturën me fibër optike, ose atë të pashfrytëzuar, parashikojnë parimin e neutralitetit të shërbimeve dhe rrjeteve në administrimin e spektrit të frekuencave etj.

Amendimi i ligjit nr.9918 dt.19.5.2008, në përputhje me direktivat e vitit 2009, është bere me ligjin nr. 102/2012. Amendimet kane sjelle në tërësi:

- plotësime dhe pasurim të rregullimeve ekzistuese të përcaktuara në Ligjin nr.9918 dt.19.5.2008, bazuar në direktivat e vitit 2009
- saktësime dhe përmirësime në disa dispozita të ligjit 9918, në përputhje me kërkesat e direktivave të vitit 2002
- propozime për transpozimin e plotë të direktivës 2006/24/EC për ruajtjen e të dhënave

Në veçanti, këto amendime përfshijnë:

- afate kohore më të shkurtra për autorizimin e përgjithshëm (ndryshimet në nenin 14) dhe caktimin e afatit maksimal për miratimin e aplikimeve për numra (ndryshimet në nenin 82);
- rregulla më të qarta për pagesat administrative që kryhen në AKEP, të cilat duhet të bazohen në shpenzimet e AKEP (nenet 117 dhe 119);
- saktësimin se vendimet e AKEP duhet të jenë proporcionale (nenet 16 dhe 34);
- rregulla më të qarta për procedurat për dhënien e frekuencave nëpërmjet konkurrimit publik (nenet 68 dhe 69), me afate kohore për çdo hap të procedurës dhe shpërndarje më të qartë të përgjegjësisë të AKEP dhe Ministrisë, dhe
- forcimin e rolit të AKEP-it lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve duke futur një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe sipërmarrësve jashtë gjykatave (neni i ri 120/1).

Amendimet janë veçanërisht të rëndësishme në këto çështje:

- Çështja thelbësore e kuadrit rregullator të BE-së të vitit 2009, është bashkëpunimi i rritur në nivel të BE-së. Shqipëria ende nuk mund të marrë pjesë plotësisht në këtë bashkëpunim, por ndryshimet në nenin 7 pika 1 e ligjit kërkon që AKEP-i të marrë parasysh rekomandimet përkatëse dhe vendimet e Komisionit Evropian si dhe Organin e sapo ngritur të Rregullatorëve Evropianë për Komunikimet Elektronike, BEREC.
- Amendimet në nenin 62, do të garantojnë që administrimi i radio frekuencave të bëhet mbi bazën e parimit të asnjëanësisë ndaj teknologjisë dhe shërbimit. Paanshmëria e shërbimit do të thotë se përdoruesit e radio frekuencave mund të përdorin frekuencat e caktuara për çdo lloj shërbimi (për shembull telefoni zanore, aksesin në internet me brez të gjerë ose shpërndarjen e përmbajtjes multimediale). Paanshmëria teknologjike do të thotë se përdoruesit e radio frekuencave mund të përdorin çdo teknologji të mundshme (për shembull GSM, UMTS ose LTE). Dispozitat e reja gjithashtu përfshijnë përjashtimet e mundshme nga këto dy parime.
- Dispozitat për portabilitetin e numrit janë zgjeruar në parim për të gjithë numrat e Planit

Kombëtar të Numeracionit. Si rregull, numrat do të mbarten brenda një dite pune nga nënshkrimi i kontratës. Kjo kërkesë e përcaktuar në Direktivën e amenduar të Shërbimit Universal ka si qëllim mbrojtjen e konsumatorit, për të garantuar vazhdimësinë e marrjes së shërbimit.

- Kuadri rregullator i BE-së i vitit 2009, paraqet disa dispozita për të forcuar të drejtat e konsumatorëve dhe të drejtat e përdoruesve me aftësi të kufizuara. Për shembull, periudha fillestare e detyruar me kontratë nuk duhet të jetë më shumë se 24 muaj dhe gjithashtu, operatorët duhet të ofrojnë kontrata me një kohëzgjatje maksimale prej 12 muajsh (neni 99 pika 3). Në rastet e shkeljes së sigurisë së të dhënave personale, operatorët duhet të informojnë AKEP-in dhe pajtimtarët e prekur (neni 122). Në lidhje me personat me aftësi të kufizuar ka disa plotësime dhe kërkesa shtesë në harmoni me kërkesat e Konventës së UN për sigurimin e aksesit për këta persona;
- Paraqiten plotësime në kërkesat e autorizimit të përgjithshëm në përputhje me kërkesat e direktivës së autorizimit.
- Në kapitullin e shërbimit universal është krijuar hapësira për përfshirjen në skemën e shërbimeve universale, të shërbimeve të Internetit me shpejtësi të lartë në varësi të zhvillimeve teknologjike. Njëkohësisht ndryshimet në këtë kapitull, parashikojnë krijimin e fleksibilitetit në zbatimin e shërbimit universal në përputhje me rrethanat dhe kushtet e zhvillimit të tregut për disponueshmërinë e shërbimeve.
- Ka disa kërkesa më të detajuara ndaj operatorëve për rritjen e transparencës në informacionin e ofruar për përdoruesit e tyre me propozimin për ndryshim të nenit 98.

Sikurse vlerësohet dhe më sipër Ligji Nr. 9918 date 19.5.2008 i ndryshuar është në përputhje me acquis të BE-se. Në veçanti ndryshimet e miratura në lidhje me net-neutrality si dhe ato në kapitullin e shërbimit universal janë të rëndësishme për projektin IBB dhe broadbandin:

- Shfrytëzimi maksimal i spektrit të frekuencave mbi bazën e net-neutrality
- Krijimi i hapësirës për mbulimin nga shërbimi universal dhe i broadbandit.

Në lidhje me këtë të fundit duhet konsideruar që ligji parashikon zhvillimin e aktit nënligjor për procedurën e caktimit të ofruesit të shërbimit universal. Aktualisht kjo nuk është e miratuar.

Në skemën e financimit të shërbimit universal është parë si mundësi vetëm kontributi nga tregu. Bazuar në eksperiencat e vendeve të tjera mund të konsiderohet zgjerimi i kësaj skeme me ndihmën shtetërore dhe financim nga buxheti.

Draft strategjia për SKZHI 2014-2020

SKZHI 2007-2013, pritet të zëvendësohet nga strategjia e re SKZHI 2014-2020. Aktualisht është në përfundim strategjia e re 2014-2020 e cila e vendos TIK dhe programin dixhital si një nga prioritetet madhore të zhvillimit të vendit.

SKZHI 2014-2020 do zërthejë programin e qeverisë e cila në lidhje me TIK ka përcaktuar si një nga drejtimit kryesore zhvillimin e infrastrukturës TIK.

Draft Strategjia Dixhital Axhenda 2014-2020

Strategjia e re për Axhendën Dixhitale 2014-2020 është në fazën e draftimit. Është ngritur një grup ndërinstytucional pune dhe drafti i përgatitur është në proces konsultimi.

Është e rëndësishme që në këtë dokument strategjie të adresohen probleme që lidhen me zhvillimin e broadbandit dhe të përcaktohen objektiva të qarta.

Strategjia e re mbi Axhendën dixhitale duhet të përfshijë dhe parashikojë aktivitete për zhvillimin e TIK në zonat rurale e ato turistike.

Programi i qeveris= 2013-2017

Programi i qeverise 2013-2017 ka përcaktuar tri prioritete ne lidhje me TIK që përfshijnë shtimin e shërbimeve dixhitale dhe elektronike për qytetarët, futjen masive të TIK-ut në arsim, dhe konsolidimin e infrastrukturës dixhitale në të gjithë Shqipërinë.⁴

Konsolidimi i infrastructures dixhitale ne gjithe Shqiperine lidhet me objektivin e ketij projekti per zhvillimin e broadbandit ne zonen e Bjeshkeve te Namuna.

Është e rëndësishme që ky prioritet të zërthehet me aktivitete dhe plane konkrete për menyrën e realizimit.

Strategjia e Zhvillimit te Qarkut Shkodër dhe Kukës

Për realizimin e projektit IBB është e nevojshme analiza e dokumentave strategjik të zhvillimit në dy qarqet Shkodër dhe Kukës.

Aktualisht zhvillimi në këto zona ka qenë orientuar nga:

⁴ http://dldp.al/dldp/index.php?option=com_content&view=article&id=370:kompanite-e-teknologjise-se-informacionit-inkurajohen-te-ofrojne-shërbime-per-te-permiresuar-funksionimin-e-qeverisjes-vendore&catid=79:comment&Itemid=833&lang=sq

- Plani i Zhvillimit Rajonal Shkodër-Lezhë, i realizuar nga grupi internacional Eptisa, me klient Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në vitin 2006
- Koncepti Strategjik i Zhvillimit Rajonal, realizuar nga GTZ/GIS, në vitin 2010
- Plani Strategjik për Turizmin e qëndrueshëm, realizuar nga Programi Art Gold 2 i PNUD në vitin 2011

Vërehet se në dokumentat aktual të zhvillimit rajonal, sektori TIK dhe zhvillimi i broadband nuk del qartazi. Strategjia e Zhvillimit Rajonal si në qarkun e Shkodrës dhe në atë të Kukësit është në proces rishikimi. Në këto dokumenta po punohet për të krijuar konceptin e “zonave funksionale” dhe atyre me “potencial zhvillimi”.

Në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës TIK duket që ajo i lihet në tërësi sektorit privat. Ndërkohë pushteti vendor, NJQV-të janë kontribuese të rëndësishme në zhvillimin e infrastrukturës shoqëruese për komunikimet elektronike sikurse: shtrimi i tubacioneve për rrjetet kabllore si dhe në procesin e miratimit të lejeve të infrastrukturës për komunikimet elektronike sikurse parashikohet në ligjin për planifikimin e territorit Ligji nr. 10119/2009 dhe në ligjin e ri për planifikimin e territorit, Ligji me Nr. 107/2014.

Në këtë drejtim është e nevojshme të shihen dhe zhvillohen format e kooperimit publik privat për mundësimin e zhvillimit të shpejtë të rrjeteve broadband.

Gjithashtu kooperimi midis pushtetit qendror dhe atij vendor në çështjet e planifikimit të territorit është i nevojshëm. Në vecanti në rastin e lejeve të infrastrukturës kërkohet bashkëpunim midis ministrit të linjës MIAP, organit rregullator AKEP-it, AKPT dhe Ministrisë për Zhvillimin Urban dhe Turizmin.

Sigurimi i sinergjisë mes projekteve që zbatohen në zonë është i domosdoshëm.

Legjislacion tjetër i lidhur me zhvillimin e broadbandit:

Ligji për planifikimin e territorit

Për zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve broadband kanë ndikim dhe një numër ligjesh dhe aktesh të tjera nënligjore.

Ndër to më nga më të rëndësishmet është ligji për planifikimin e territorit i cili rregullon të drejten e miratimit të një leje zhvillimi, ndërtimi apo infrastrukture.

Ligji për komunikimet elektronike sikurse prezantohet me lart, ka adoptuar regjimin e autorizimit të përgjithshëm për hyrësit e rinj në tregun e komunikimeve elektronike. Ky ligj parashikon aplikimin e

autorizimit individual në rastin e një rrjeti që kërkon përdorimin e burimeve të kufizuara sikurse janë frekuencat.

Ndërsa për ndërtimi e rrjetit kërkohet zbatimi i rregullave sipas ligjit të planifikimit të territorit dhe ndërtimit. Njëkohësisht njoftimi dhe ndjekja e procedurave të përcaktuara nga autoritetet përkatëse.

Ligji nr. 10119 I vitit 2009 I ndryshuar ne vitin 2013 krijonte paqartësi dhe konfuzion për lejet e infrastrukturës që lidheshin me komunikimet elektronike dhe broadband.

Ligji i ri i planifikimit të territorit miratuar në 30 korrik 2014 pritet të hyjë në fuqi në muajin tetor 2014. Në këtë ligj ka një dispozitë që përcakton si leje të vecantë të infrastrukturës lejen e infrastrukturës për komunikimet elektronike.

Mbi bazën e këtij ligji pritet adoptimi i akteve nënligjore që do bëjnë dhe detajimin e rregullave. Është e nevojshme që adoptimi i këtyre rregullave me akte nënligjore, me Vendim të Këshillit të Ministrave të jetë në përputhje me acquis të BE-së për komunikimet elektronike.

Neni 11 i direktivës kuadër (2002/21/EC) ka përcaktuar kërkesat që duhen përmbushur në trajtimin e lejeve për rrjetet e komunikimeve elektronike dhe facilitetet shoqeruese. Në mënyre të vecantë kjo direktive kërkon:

- Qartësimin e autoritetit për trajtimin e kërkesave për leje
- Adoptimin e kërkesave objektive, transparente dhe jo diskriminuese për lejet e infrastrukturës
- Ndarjen e qartë të detyrave midis autoritetit miratues dhe pronarit (psh të rrugëve, objektit publik).

Pika e parë e nenit 11 të direktivës frameëork, është e adresuar nga ligji nr. 107/2014. Në këtë ligj përcaktohen si autoritete për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve NJQV-të brenda fushës së tyre territoriale ndërsa trajtimi i kërkesave për leje zhvillimore komplekse do të bëhet nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

Nga takimet në terren me përfaqësues të Qarkut si në Shkodër dhe në Kukës është prezantuar që për momentin për sa kohë planet urbanistike lokale nuk janë zhvilluar e miratuar, Këshilli i Qarkut është në pamundësi (**është pezulluar**) për të dhënë leje ndërtimi apo vendosje antenash (miratimin e lejes për infrastrukturë të komunikimeve elektronike).

Kjo situatë është penguese për zhvillimet e infrastrukturës broadband dhe duhet zgjidhur.

Adoptimi i rregullave të qarta dhe objektive që shmangin praktikat abuzive është i nevojshëm për të hequr barrierat dhe promovuar zhvillimin. Njëkohësisht adoptimi i rregullave të harmonizuara është i nevojshëm.

Legjislacioni për taksat si në nivel kombëtar dhe ai vendor

Taksat e larta shpesh janë frenuese në nxitjen e investimeve. Aktualisht zhvillimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike mbulohen nga ligji për taksat kombëtare në rastin e pagesave për tarifën e radiokomunikacionit kur përdorin frekuenca, nga ligji i taksave vendore për rastin e taksës për ndikimin në infrastrukturë, mjedis etj.

Aktet nënligjore të rregullatorit

Një ndikim të ndjeshëm në zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve kanë dhe aktet rregullatore të miratuara nga AKEP.

Ka një numër rregulloresh të miratuara nga AKEP⁵ që rregullojnë veprimtarinë e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve broadband si: Rregullorja e autorizimit të përgjithshëm, rregullorja e autorizimit individual, rregullat për përdorimin e frekuencave etj.

Analizat periodike të tregjeve përkatës përbejnë studime të rëndësishme për situatën e tregut të komunikimeve elektronike dhe njëkohësisht janë instrumenta të rëndësishëm për nxitjen e zhvillimit të tregut përmes vendosjes së detyrimeve ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg. Në rastin tonë rregullimi i tregut të linjave me qera apo i tregut të broadbandit është i rëndësishëm për t'u dhënë mundësinë sipërmarrësve të vegjël, hyrësve të rinj për t'u zhvilluar.

Legjislacioni për partnertetin publik privat

Partnerteti publik privat është aktualisht i mbuluar me ligjin për koncesionet i cili është rishikuar në vitin 2013.

Në këtë ligj është e përfshirë dhe fusha e telekomunikacionit dhe TIK në tërësi. Pushteti vendor duhet të shikojë mundësitë për bashkëpunime ppp me qëllim zhvillimin e rrjeteve broadband në zonat e tyre si një mundësi për zhvillimin ekonomik dhe social dhe rritje të punësimit në zonë.

Legjislacioni për ndihmën shtetërore

Ligji për ndihmën shtetërore ka disa hapësira për ndihmesën e sipërmarrjeve të reja, sipërmarrjeve në veshitësi, për lehtësimin nga taksat, dhënien e granteve, kompensimeve etj.

⁵ www.akep.al

Këto hapësira ligjore duhen shfrytëzuar për të ndihmuar zhvillimin e sipërmarrjes në zonën e Bjeshkëve të Namuna.

Aplikimi i ndihmes shtetërore duhet parë i kombinuar në rastin e turizmit dhe me TIK, zhvillimin e aplikimeve online që përbën dhe pjesën e dytë të *shtresës* së “supply side” në ekosistemin e broadband-it.

Ligji për FSHZH

Financimi i projekteve të zhvillimit është një aspekt i *rëndësishëm* për të bërë të mundur zbatimin e politikave.

Aktualisht NJQV-të kanë buxhetin e tyre sipas ligjit për buxhetin. Nga analiza e situatës në njësitë e qeverisjes vendore, vërehet se në Qarkun e Shkodrës dhe Kukësit mundësitë e të ardhurave të veta nga NJQV-të janë të limituara. Investimet janë në zëra kryesore për shërbime publike, po nuk mbulojnë infrastrukturën TIK. Në aneksin 5 jepet një tabelë treguesve për investimet për banorë në NJQV-të e qarkut Kukës sipas Raportit të Analizës në Njësitë e Qeverisjes Vendore të kryer me mbështetjen e UNDP në kuadër të reformës territoriale.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, një agjenci e specializuar për projektimin dhe zbatimin e projekteve për zhvillimin e zonave rurale financohet nga buxheti i shtetit ashtu dhe nga donatorët. Sikurse analizohet me poshtë FSHZH ka zbatuar një numër të konsiderueshëm projektesh në zonën e Bjeshkeve të Namuna.

Eshte e rëndësishme që në ligjin për FSHZH-ne të parashikohet qartesisht që në objektivat që mbulon FSHZH dhe në projektet që financon FSHZH të përfshihet infrastruktura TIK dhe broadband si një infrastrukturë jetike për zhvillimin ekonomik dhe social në të ardhmen.

Për këtë mund të jetë e nevojshme amendimi i ligjit për FSHZH në mënyrë që të gjitha projektet e infrastrukturës rrugore të përfshijnë infrastrukturën mbështetëse për TIK.

PROJEKTE TË REALIZUARA NË QARQET SHKODËR DHE KUKËS

Nga hulumtimi i bërë në kuadër të këtij studimi rezulton se pjesa më e madhe e projekteve të financuara në vite në këtë zonë lidhet me zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe në atë të ujësjellesave.

Programi i rrugëve dytësore dhe lokale është një program kombëtar që synon t'i japë një zhvillim të vrullshëm zhvillimit ekonomik dhe social në vend nëpërmjet rehabilitimit dhe vënies në shfrytëzim të një rrjeti kombëtar të rrugëve rajonale dhe lokale.

Projekti "Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale", bashkë-financuar nga Banka Botërore dhe donatorë të tjerë në vlerën 368 milion USD, synon të rrisë përpjekjet konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në vend si edhe për rritjen e aksesit ndaj shërbimeve bazë dhe tregjeve, veëanërisht në zonat rurale nëpërmjet rehabilitimit të rrjetit rrugor dytësor dhe lokal. Projekti u bë efektiv në Shtator 2008 dhe parashikohet të përfundojë në fund të vitit 2016.

Ky program ka nisur ne vitin 2008 dhe inventarizuar rreth 3800 km rruge rurale; ka siguruar nje fond total prej 368 milione USD nga 9 donatore te ndryshem, qe pritet te shkoje ne 420 milion USD.

Ngritja e infrastrukturës së projektit që u mbështet fillimisht nga Banka Botërore dhe në vazhdim nga grantet e BE –së, krijoi terrenin për afrimin dhe bashkëpunimin e donatorëve të tjerë si: BERZH, BEI, CEB, IDB, ëË, OFID, duke e shndërruar programin e rrugëve dytësore në një nga programet më me peshe jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon.

Nëpërmjet këtij programi kanë përfituar dhe zona e projektit. FSHZH ka bërë të mundur investimin në mjaft akse të rëndësishme rrugore për zhvillimin e zonës së Alpeve. Këto investime përfshijnë rrugen Hani i Hotit-Tamarë-Vermosh, fillimin e rrugës Bogë-Qafë Thore për në Theth, rrugën e Dukagjinit, rrugën e Lekbibajt, ndërtimin e Qendrës për Zhvillimin e Turizmit në Valbonë, si dhe furnizimin me ujë të rreth 20 fshatrave në Kelmend, Theth, Valbonë etj.

Në kuadër të programit të investimit të FSHZH-së është punuar për të rehabilituar rrjetin e ujësjellësve në tre qarqe të Veriut, nëpërmjet një programi të financuar nga Banka Gjermane, KfV. Nëpërmjet këtij programi, janë ndërtuar 25 skema ujësjellësish që furnizojnë 28 fshatra me mbi 50 mijë banorë të qarqeve Dibër, Kukës dhe Shkodër.

Tabela 14

Rajoni	Shkodër
Popullsia:	246 000 banorë
Sipërfaqja:	3561 km ²
Dendësia:	69 banorë/km ²
Zona:	Shqipëria veriore
Degët kryesore të ekonomisë:	Industria energjitike, bujqësia, turizmi
1993-2010:	166 projekte të realizuara nga FSHZH
Vlera e financimit:	2.2 miliardë leke

Nga këto: 57% kanë shkuar për ndërtimin e rrugëve, 16% Ujësjellës kanalizime, 7% për shkolla dhe kopshte, dhe pjesa tjetër për projekte të ndryshme si qendra shëndetësore, qendra komunitare, ndërtesa publike, ujitje, tregje etj.

Të dhënat për projektet e realizuara nga FSHZH në rajonin e Kukësit jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 15

Rajoni	Kukës
Popullsia:	8 000 banorë
Sipërfaqja:	2373 km ²
Dendësia:	34 banorë/km ²
Zona:	Shqipëria veriore
Degët kryesore të ekonomisë:	Industria energjitike, blektoria, turizmi
1993-2010:	201 projekte të realizuara nga FSHZH
Vlera e financimit:	1.79 miliardë leke

Nga këto 49% kanë shkuar për ndërtimin e rrugëve, 16% Ujësjellës kanalizime, 14% ujitje, 6% shkolla dhe kopshte, dhe pjesa tjetër për projekte të ndryshme si qendra shëndetësore, qendra komunitare, ndërtesa publike, tregje etj.

Lista e plotë e projekteve të realizuara në qarkun Shkodrës dhe Kukësit në periudhën 2005-2013 jepen ne Aneksin 3.

Ndër projektet e rëndësishme për zhvillim në këto zona është dhe investimi në sistemin e ujësjellës kanalizimeve. Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale është një program i bashkëfinancuar nga Qeveria Shqiptare, Banka Gjermane për Zhvillim, KfW, dhe Bashkimi European. Në tabelën e mëposhtme jepen investimet në proces dhe ato të planifikuara ku bëjnë pjesë dhe qarqet Shkodër dhe Kukës.

Tabela 16

Programi	Kohë zgjatja	Financimi Euro (milion)	Qarqet ku implementohet	Popullsia që shërbehet me ujë (banorë)	Nr. i fshatrave
RËSP I & II	2008-2014	11.66	Kukës, Dibër, Shkodër	40,000	53
SIF IV	2010-2016	5.8	Kukës, Dibër, Shkodër	20,000	23
RËSP III	2014-2018	35.2	Qarqe në gjithë Shqipërinë	120,000	Për t'u përcaktuar

Keto projekte nuk kane lidhje direkte me projektin e IBB po jane te rendesishme per zhvillimin ekonomik te zones dhe promovimin e turizmit.


Programi "Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale", financuar nga KfW, ka mundësuar ndërtimin e 29 skemave të ujësjellësave rurale në 54 fshatra në Qarqet Dibër, Shkodër dhe Kukës, duke kontribuar në përmirësimin e jetesës së rreth 40.000 banorëve. Programi ka pasur një kohëzgjatje 6 vjeçare dhe përfundon në fund të vitit 2014.

Me fondin rezervë të programit, janë hartuar fizibilitetet për ndërtimin e ujësjellësave të 5 fshatrave në komunat Postribë dhe Tropojë e Vjetër, në Qarqet Shkodër dhe Kukës. Punimet kanë përfunduar edhe për këto skema ujësjellësash.


Në kuadër të programit SIF IV, financuar nga KfW në vlerën 5 milionë Euro dhe 0.8 milionë Euro të tjera që janë kontribut lokal nga NJQV-të përfituese synohet ndërtimi i 15 skemave të ujësjellësave në Qarqet, Kukës, Shkodër dhe Dibër çka do të sigurojë furnizim të pjesshëm me ujë higjienikisht të pastër rreth 20,000 banorë në zonat rurale. Këto projekte janë në proces.

“Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”. Financues të këtij programi do të jenë KfW me 25.4 milionë Euro dhe Bashkimi Europian perms IPA 2013, me 9.8 milionë Euro. Projekti është parashikuar të zgjasë nga 2014 deri në 2019. Pjesa e financimit për ndërtimin e rrugëve do të përfundojë në vitin 2016 kurse pjesa e ndërhyrjes në ndërtimin e ujësjellësave ruralë do të vazhdojë deri në 2019.

Me interes për këtë studim dhe zhvillimin e TIK dhe broadbandit në zonën e Bjeshkëve të Namuna janë investimet në proces dhe të planifikuara për infrastrukturen rrugore. Në foton e mëposhtme jepen rrugët e përfunduara, ato në zbatim dhe ato të planifikuara:



Sikurse duket në këtë foto të marrë nga faqja zyrtare e FSHZH, janë dy segmente rrugore në zonën e projektit në zbatim dhe një segment rruge në proces.





- Rrugë të përfunduara
- Rrugë në zbatim
- Rrugë në proces

Në zbatim segmentet: Bogë- Qafë Thore, Theth,

Ne proces: Tamarë – Vermosh,

Malësi e Madhe



Investimet e kryera përfshijnë rrugët Hani i Hotit –Tamarë dhe ato në proces segmentin Tamarë-Vermosh, rrugën Bogë-Qafë Thore që të çon në Theth, Segmentin Prekal-Kir, rrugën e Lekbibaj, etj, qe krijojnë një rrjet të rrugëve hyrëse në Alpe.

Për këto segmente rrugore është e rëndësishme të koordinohen zhvillimet në mënyrë që të përfshihet në këtë investim dhe infrastruktura mbështetëse për TIK si tubacionet për shtrimin e fibrës optike apo kablove koaksiale mbështetës për shërbimet e komunikimit dhe transmetimet televizive.

PROJEKTE NE PROCES

Bazuar në të dhënat e publikuara nga FSHZH⁶, rezulton se për zonën e projektit IBB janë në proces disa projekte infrastrukturore.

Njoftimi i muajit prill 2014 i FSHZH-se mbi kontratën CËC/ICB/2014/ËL-Rec 46-1 për rindërtimin e rrugës Tamarë – Vermosh, Lot 1, Rajoni i Shkodrës. Segmenti prej 14.7 km dhe periudha e ndërtimit ne 23 muaj. Financimi nga IPA 2009 përmes "KfW - Kreditanstalt für Wiederaufbau", Republika Federale e Gjermanise dhe FSHZH.

Njoftimi shkurt 2014, program mbi Fondin e Investimeve Sociale IV për kontratën: SIF IV-ËC/ICB/2013/CË 1. Ndërtimi i 15 skemave të ujësjesve në rajonet Shkodër, Kukës dhe Diber. Investitori "KfW - Kreditanstalt für Wiederaufbau", Republika Federale e Gjermanise dhe FSHZH.

Kontrata CËC/ICB/2013/WL-Rec 54-1, rindërtimi i rrugës KUKËS - Shishtavec, Lot 2, Rajoni KUKËS-it dhe CËC/ICB/2013/WL-Rec 54-2, i rrugës Kukës - Shishtavec, Lot 2, Rajoni Kukësit. Investitori "KfW - Kreditanstalt für Wiederaufbau", Republika Federale e Gjermanisë dhe FSHZH.

Pojektet në zhvillim

PROJEKTI MONTEAL

Investim në zhvillim të qëndrueshëm njerëzor dhe lokal përmes menaxhimit pjesëmarrës e ndërkufitar në zonën e Kelmendit, Shkrelit, Andrijevicës, Beranës dhe Plavës.

Kohëzgjatja: Shkurt 2014 - maj 2015

Qëllimi Projekti do të lehtësojë zhvillimin në zonën ndërkufitare të Kelmendit, Shkrelit, Andrijevicës, Beranës dhe Plavës.

Objektivat e aktivitetit të projektit

- Konsolidimi, prezantimi dhe aprovimi i planit ndërkufitar të zhvillimit
- Zhvillimi i një baze dokumentare për burimet kulturore, historike dhe natyrore të zonës ndërkufitare të targetuar
- Zhvillimi i një produkti turistik lokal që mund të pasqyrojë dhe krijojë një audiencë për vlerat dhe aktivitetet turistike të zonës

⁶http://www.albaniandf.org/shqip/Prokurime/Pages/punime_civile_2014_04_10.html

ndërkufitare

- Të promovojë një ofertë të përbashkët turistike që krijon ura lidhëse në aktivitetin turistik në komunitetet e targetuara si dhe për rrjetet e biznesit në të dy anët e kufirit
- ***Përmirësimi i infrastrukturës turistike ndihmëse në zonën e targetuar***
- Rritja e kapacitetit të banorëve për t'u angazhuar në aktivitet turistik

Burimi Financiar:	Komuniteti European, nëpërmjet Programit IPA Cross-Border Cooperation
Zbatues	Projekti do të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Organizata Rajonale e Turizmit Bjelasica & Komovi.
Partnerët Lokale:	Për të siguruar zbatimin e suksesshëm të projektit partnerët zbatues do të bashkëpunojnë me Komunën Kelmend, VIS Albania si dhe Komunën Shkrel.
Përfitues	Përfituesit e veprimtarisë janë gjithë banorët e zonës së targetuar prej projektit. Numri i përgjithshëm i përfituesve vlerësohet të jetë rreth 70,000 banorë. Në të ardhmen numri i përfituesve pritet të rritet për shkak të përsëritjes së këtij modeli që propozohet nga aksioni.

Projekti ka nisur punën për vlerësimin e situatës aktuale dhe zhvillimin e një kornize strategjike për zhvillimin e turizmit dhe përcaktimin e ndërhyrjeve për përmirësim infrastrukturor; ndërsa janë ndërmarrë hapa edhe për organizimin e punës për krijimin e një bordi partneriteti ndërkufitar dhe hartimin e një plani zhvillimi ndërkufitar për zonën e Kelmendit, Shkrelit, Andrijevicës, Beranës dhe Palvës.

Koordinimi i këtyre aktiviteteve është me shumë vlere. Promovimi i turizmit dhe sigurimi i shërbimeve të duhura kërkojnë sigurimin e komunikimeve broadband. Përmirësimi i infrastrukturës turistike ndihmëse është nje nga objektivat e projektit.

PROJEKTI HERA

Menaxhimi i turizmit të qëndrueshëm të trashëgimisë së Adriatikut, projekt i financuar nga programi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA Adriatic

Kohëzgjatja:	Nëntor 2013- Mars 2015
Qëllimi	Krijimi i një platformë të përbashkët ndërkufitare në zonën e Adriatikut për

	menaxhimin dhe promovimin e një turizmi të qëndrueshëm, bazuar në trashëgiminë kulturore të përbashkët.
Objektivat e projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Reduktimi i sezonalitetit të turizmit • Fuqizimi i turizmit miqësor me mjedisin • Zhvillimi i bashkëpunimit institucional midis organizatave të interesuara të vendeve të rajonit të Adriatikut për zhvillimin e turizmit
Aktivitetet e projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Projekti përfshin 6 paketa ku: • Paketa e gjashtë (PP6), përfshin projektin pilot të përzgjedhur në Shqipëri, krijimi i qendrave të vizitorëve - Aktivitetet kryesore të kësaj pakete konsistojnë në: përcaktimin e zgjidhjeve multimediale individuale; përmirësimin infrastrukturor të qendrave të vizitorëve; prezantimin virtual të trashëgimisë kulturore dhe krijimin e rrjeteve të qendrave të vizitorëve.
Burimi Financiar:	Komuniteti Europian, nëpërmjet Programit IPA Cross-Border Cooperation
Aktore kyc ne projekt:	<ul style="list-style-type: none"> • Ministria e Kulturës • Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit • Fondi Shqiptar i Zhvillimit • Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore • Instituti i Monumenteve të Kulturës • Fototeka Marubi • UNDP • Teuleda • Bashkia Shkodër
Projekti pilot i Përzgjedhur në Shqipëri	Fototeka Marubi Shkodër
	Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës është përzgjedhur Fototeka Marubi si pjesë e këtij projekti. Synimi i ndërhyrjes në këtë objekt është përmirësimi dhe modernizimi i fototekës Marubi dhe futja e saj në një rrjet të përbashkët me trashëgimi të tjera kulturore të rajonit të Adriatikut.
Partnerët Lokale:	
Përfitues	8 vende pjesëmarrëse (Shqipëri, Bosnjë, Kroaci, Greqi, Itali, Mali i Zi, Serbi, Slloveni). 19 organizata përfituese.

Projekti për “Restaurimin dhe Muzealizimin e Fototekës Kombëtare Marubi” ka filluar në muajin shkurt 2014 me ngritjen e grupit të përbashkët të punës përbërë nga Ministri e Kulturës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Atelier Albania. Punimet për rikonstruksionin e godinës së Fototekës “Marubi” pritet të përfundojnë në fund të vitit 2014.

Zhvillimi i këtij projekti është indirekt i lidhur me projektin e IPB i shërben rritjes së interesit dhe promovimit të turizmit të zonës. Mbështetja me infrastrukturën TIK dhe zhvillimin e broadbandit i rëndësishëm për këtë projekt. Projekti IBB ka në objektivat e vet dhe dixhitalizimin e Muzeut Etnografik të Shkodrës. Duhet parë ndërthurja, koordinimi me projektin HERA për rritjen e sinergjive dhe përfitimit reciprok.

PROJEKTI: ZHVILLIMI I ALPEVE SHQIPTARE

Gjatë vitit 2014 FSHZH ka nisur një projekt të ri për zhvillimin e zonës së Alpeve Shqiptare. Projekti do financohet nga një grant i ËBIF (Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor). Dhe do përfshijë përgatitjen e masterplanit dhe Studimeve të Fizibilitetit për Projekte Infrastrukturore në Zonën e Alpeve. Këto studime pritet t'i paraprijnë investimeve që do të realizohen në këtë zonë.

FSHZH ka financuar në zonën e Alpeve, 22 nënprojekte të infrastrukturës dhe zhvillimit të turizmit. Peshën kryesore të investimeve e zënë rrugët (rreth 130 km). Janë ndërtuar 6 skema ujësjellësash komunalë dhe 1 qendër për zhvillimin e turizmit në Valbonë.

Në një intervistë të dhënë në prill 2014, Drejtori Ekzekutiv i FSHZH shprehet se: *Në proces është një projekt i kombinuar për zhvillimin e turizmit, në komunat e Kelmendit dhe Shkrelit në Shkodër, financuar nga BE në kuadër të programit IPA Adriatik, dhe qubet "Monteal". Ky projekt synon krijimin e një oferte të përbashkët turistike me Komunitetet kufitare të Malit të Zi.*

Në faqen zyrtare të FSHZH jepet që për projektin e zhvillimit të Alpeve janë hartuar Termat e Referencës për përgatitjen e Masterplanit dhe studimeve të Fizibilitetit për projekte infrastrukturore në zonën e Alpeve. Ky proces është kryer me konsultim me gjithë aktorët relevantë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Në tremujorin e fundit të 2014 pritet të lidhet kontrata me kompaninë fituese ndërkombëtare e cila do të hartojë Masterplanin dhe realizojë studimet e fizibilitetit për projektet prioritare të infrastrukturës lokale në këtë zonë.

Përshkrimi i Projektit

Qëllimi kryesor i projektit të studimit të Alpeve është të ofrojë një plan zhvillimi social ekonomik të qëndrueshëm për komunitetet e Alpeve Shqiptare. Ky plan do të tregojë rreth mundësive të ndryshme të financimit për shërbimet dhe infrastrukturën publike bazë në komunitete, fizibilitetin e secilit opsion si dhe vështirësitë dhe supozimet që shoqërojnë secilin prej tyre. Pjesë e synimeve të projektit është edhe propozimi i një plani marketingu për zhvillimin e një aktiviteti konkurrues turistik në zonë.

Shtrirja gjeografike e projektit përfshin zonën e Alpeve shqiptare që ndodhet mes kufijve të Malit të Zi dhe Kosovës. Popullsia që jeton në zonën e mbuluar nga projekti arrin rreth 35,000 banorë. Aktiviteti kryesor i ekonomisë lokale është bujqësia dhe blegtoaria. Kushtet e këqija të infrastrukturës

apo mungesa e saj përbën edhe pengesën kryesore të zhvillimit të rajonit si dhe ka ndikuar drejtëpërdrejtë në largimin e popullsisë lokale drejt zonave urbane.

Projekti për zhvillimin e Alpeve është shumë i lidhur me projektin e IPB për zhvillimin e infrastrukturës TIK dhe broadband ne zonen e projektit. Koordinimi i aktiviteteve me FSHZH dhe kompanie hartuese të master planit dhe studimin e fizibilitetit është mëse i domosdoshëm.

Projekte të tjera të rëndësishme në zonë:

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes dldp, e ka zgjeruar gradualisht zonën e veprimit të projektit nga faza 1 në Shkodër, duke shtuar Qarkun e Lezhës (2010) për fazën e dytë dhe qarqet e Dibrës, Durrësit dhe Kukësit për fazën 3 (janar 2014-dhjetor 2017).

Aktualisht projekti i dldp-se7 mbulon 5 qarqe nga të cilat dy janë ato të mbuluara dhe nga projekti IBB. Fushat e aktivitetit të mbuluara nga projekti i dldp-së janë përfshirja e NJQV-ve të reja dhe shpërndarja/përshkallëzimi i praktikave më të mira në mënyrë horizontale në fushat e menaxhimit financiar, menaxhimit të mbetjeve, qeverisjes elektronike dhe aksesit në fonde.

Qeverisja elektronike është e lidhur me përmirësimin e infrastrukturës TIK dhe broadband. Koordinimi dhe bashkëpunimi me këtë projekt është i nevojshëm në kuadër të projektit IPB pasi lidhet me aplikacionet dhe shërbimet elektronike (pjesa e shtresës “supply side” në ekosistemin e broadbandit).

Sipas informacionit të publikuar nga dldp, mbështetja gjatë dldp 3 do të konsistojë në:

Zyra me Një Ndalesë (Z1N)

Shpërndarja dhe promovimi i modeleve ekzistuese të Z1N-ve (NJQV të madhësisë së vogël, të mesme dhe të madhe) Replikimi i mëtejshëm i modelit në NJQV të përzgjedhura me bazë konkurruese (nëpërmjet fondit grant)

Ekspozimi i NJQV-ve përtej zonës së programit dldp 2 ndaj modelit të Z1N-së me kërkesë mobilizimi. Do kërkojnë përmirësime të softëare për qëllime qeverisjeje dhe mbështetje për partneritetin publik-privat (Z1N)

Në lidhje me e-qeverisjen

Shpërndarja, promovimi dhe financimi i udhëzuesve për web-presencën për NJQV. Përmirësimi i kapaciteteve dhe pilotimi i standardeve në nivel lokal (krijimi i parakushteve

⁷ http://ëëë.dldp.al/dldp/index.php?option=com_content&view=article&id=276&Itemid=826&lang=sq

për web-prezencën në NJQV mbetet objektiv në vetvete, nevojat dhe fizibiliteti duhet të qartësohen në nivel rajonal – organizimi që i përshtatet më mirë) Përputhje me strategjitë kombëtare për novacion dhe teknologji dhe do nxitet shpërndarja në nivel lokal dhe rajonal Ekspozim ndaj praktikave të mira të NJQV-ve të reja dhe programeve të tjera

Ne lidhje me mjetet elektronike

Lidhja e prezencës në web së NJQV-ve me platformën KM për të mundësuar akses më të mirë dhe qeverisje me pjesëmarrje për politikë-bërje. Ndërtimi i kapaciteteve të NJQV-ve për të përdorur programet elektronike të krijuara gjatë dldp 2 të tilla si PPF, modeli i kostos e tarifës etj.

Projekti për zhvillimin e ofertës së turizmit të natyrës dhe turizmit rural, i realizuar me mbështetjen e GTZ - së në vitin 2007, për përfshirjen e komunitetit të fshatit Theth, ndihmoi në ngritjen e një rrjeti bujtinash (shtëpi të pritjes së turistëve). Nisma mbështeti gjithashtu disa veprimtari marketingu dhe shënjimin e shtigjeve të hecjeve në këmbë. Si rezultat numri i turistëve në këtë zonë është rritur nga 300 turistë në 2006 në 12.000 (80-85% turistë të huaj) në vitin 2011.

Në kuadër të këtyre projekteve ka pasur një numër të konsideruar turesh të organizuar të natyrës, veçanërisht në zonat kodrinore dhe malore të Shqipërisë, si për shembull në Theth, Vermosh Lepushë, Valbonë dhe Tropojë, në Alpet Veriore, gjë që ka ndikuar në rritjen e atraksionit turistik në keto zona⁸.

Nëpërmjet një projekti të financuar nga GTZ, (GIS) është ndërtuar një adresë web-site www.albanian-mountains.com në të cilën gjendet informacion turistik për shumicën e zonave malore të Shqipërisë, përfshi edhe informacion për guesthousët e Kelmendit, por mungon një informacion i detajuar i dedikuar për këtë komunë, ku të përfshihen të gjitha pasuritë turistike të zonës, informacion i detajuar për aktivitetet e komunës, si dhe informacion i vlefshëm, si për banorët e komunës ashtu dhe për turistët vendas e të huaj, që do ta gjejnë me interes vizitën në këtë komunë.

Per zhvillimin e “Lugines së Valbonës” është nënshkruar në 24 prill 2014 marrëveshja për zhvillimin e turizmit me WWF Mesdhe. Projekti IBB duhet të shikojë koordinimin dhe në këtë kuadër.

Më poshtë jepet situata e mbështetjes me projekte të komunave të ndryshme në zonë mbi bazën e takimeve të zhvilluara nga stafi i projektit.

⁸ www.turizmi.gov.al/draftstrategjia per turizmin 2014-2020

Këshilli i qarkut Shkodër:

Projekti “Picks of Balkans”, realizuar me mbështetjen e SDC, (Swiss Development Cooperation)

Projektin ndërkufitar ne bashkëpunim me komunën Shkrel, (KSH si partner, komuna si leader)

Projektin e realizuar nga shoqata VIS. Është krijuar një eksperiencë e vlefshme në bashkëpunimin me palën malazeze.

Këshilli i Qarkut Kukës:

Këshilli i Qarkut Kukës ka një rol mjaft aktiv në aplikimet e projekteve nga donatorët, veçanërisht për programet cross-border me Kosovën e Malin e Zi.

Iniciativa më e fundit është krijimi i Agjensisë Rajonale të Zhvillimit që do të ketë prioritet zhvillimin e projekteve me donatorët.

Komuna Kelmend:

Komuna ka përfituar nga projekte të disa shoqatave, si VIS, (Volontariato Internazionale per lo Sviluppo), një shoqatë italiane, që kishte realizuar disa projekte, ndër të cilët projekti për “Qendrën e Informacionit Turistik” me interes për projektin IBB. Nëpërmjet një projekti të financuar nga GTZ, (GIS) është ndërtuar një adresë web siti www.albanian-mountains.com në të cilën gjendet informacion turistik për shumicën e zonave malore të Shqipërisë, përfshi edhe informacion për guesthousët e Kelmendit. Është mbështetur nga projekte të ndryshme të FSHZH-së.

Komuna Kastrat:

Komuna është e përfshirë në një sërë projektesh të financuar nga donatorë të ndryshëm. Midis tyre ngritja e shkollës mjedisore buze liqenit të Shkodrës nga ndihma e zhvillimit austriake, projekti RDP ka në proces ngritjen e dy qendrave informuese për turizmin njëra në Doganën e Hanit të Hotit dhe tjetra në Tamarë. Keto dy pika do të shërbejnë edhe si info për turistët dhe do shesin produkte artizanati të zonës.

Komuna Qënder Koplik:

Komuna ka marrë pjesë në zbatimin e disa projekteve në bashkëpunim me: Zyrën e Bashkëpunimit Zviceran, Zyrën e Bashkëpunimit Italian, SNV, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, OXFAM Italia, Komisioni Evropian, GIZ etj.

Komuna Shkrel-Dedaj:

Komuna ka marrë pjesë në zbatimin e disa projekteve në bashkëpunim me: Zyrën e Bashkëpunimit Zviceran, Zyrën e Bashkëpunimit Italian, SNV, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, OXFAM Italia, Komisioni Evropian, GIZ etj.

Komuna Margegaj:

Ndodhet në Alpet e Shqipërisë dhe shtrihet në veriperëndim të rrethit të Tropojës. Në veri kufizohet me Republikën e Malit të Zi. Në territorin e kësaj zone kalon lumi i Valbonës. Valbona është e famshme për resurset natyrore të veçanta të cilat janë pasuri të eko-turizmit dhe turizmit malor. Kjo zonë është përfshirë në disa projekte zhvillimi me donatorë të ndryshëm. Zhvillimi i alpeve është një projekt i inicuar në vitin 2014 që po ndiqet nga FSHZH.

Komuna Lekbibaj

Ka përfituar nga projektet e FSHZH për infrastrukturën. Janë në përpjekje për të kërkuar financim nga GIZ për një projekt i cili synon të mbështesë disa guest-house.

Komuna Tropojë e Vjetër:

Ka përfituar nga projektet e FSHZH për infrastrukturën. Pritet së shpejti të fillojë shtimi i rrugës Bucaj- Pradesh nga FSHZH.

Komuna Bujan

Janë zhvilluar dy projekte të financuara nga donatorët si: Shoqata “Partner për Fëmijë” për krijimin e këndit të lojrave për fëmijë në shkollën 9-vjecare rehabilitimi i një sipërfaqe prej 110 ha me gështenjë me financim të Shoqatës ECNC(Qendra Europiane për Ruajtjen e Natyrës).

Komuna e Shalës:

Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës në segmentin nga Ducaj në Qafëthore, është bërë me fonde të financuara nga KfV dhe të zbatuara nga FSHZH. Në proces përmirësimi i rrugës për segmentin Qafëthore-Theth.

PROJEKTET E PARASHIKUARA NË STRATEGJINË E TURIZMIT

Me interes për projektin IBB dhe zhvillimin e zonës së Bjeshkëve të Namuna është kooperimi me MZHUT, AKT, dhe përfshirja në aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit të draft Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit 2014-2020. Në zonën e Bjeshkëve të Namuna ka destinacione turistike me interes në rritje që qartësisht janë pjesë dhe e analizës dhe prespektivës së zhvillimit të kësaj strategjie.

Rritja e ndërgjegjësimit, përfshirja e projektit IBB në aktivitetet për përmirësimin e infrastrukturës turistike, krijimi i Pikave të informimit TIK, krijimin e produktit turistik etj janë aktivitete që do nxisin zhvillimin, kërkesën për keto zona, si rrjedhim dhe investimet për broadband dhe shërbime elektronike.

Studime të lidhura me zonën dhe TIK

Studime të mirëfillta të fokusuara në sektorin TIK dhe zhvillimin e broadbandit për zonen e projektit duket që nuk kemi. Nga GTZ/GIZ janë kryer disa studime të lidhura me zhvillimin e turizmit ku pjesë e tyre janë dhe vlerësimi i përdorimit të TIK për turizmin:

- GIZ –EDEP Tetor 2012, Studim Analiza e sektorit të turizmit privat
- Konsulentët GTZ- GOPA, 2010. Vlerësimi i nevojave të teknologjisë së informacionit në Sektorin e Turizmit
- GIZ, dhjetor 2012. Studim: Cilësia dhe Menaxhimi Mjedisor i Hoteleve shqiptare – Perceptimet e operatorëve turistikë gjermanisht -folës mbi Shqipërinë
- GIZ –EDEP tetor 2012. Studimi: Analizë e sektorit privat të turizmit
- GTZ-GOPA, 2010. Vlerësimi i nevojave të teknologjisë së informacionit në Sektorin e Turizmit
- GIZ –EDEP Tetor 2012. Studimi: Analizë e sektorit të turizmit privat

Një studim tjetër jo i lidhur drejtpërdrejtë është ai i Bankes Botërore, në 2009 “Krijimi i konkurrencës në Shqipëri Volumi II. Studimi i Rastit Sektorial: Turizmi”

Ka disa vrojtime periodike të kryera nga AKSHI në lidhje me e-qeverisjen në Bashki e Komuna (NJQV-te). Fokusi i këtyre vrojtimeve është kryesisht prezenca në web e Bashki dhe Komunave dhe jo infrastruktura broadband. Megjithatë prezenca e infrastrukturës TIK, lidhja e internetit janë të lidhura me zhvillimin e e-qeverisjes.

Ka disa studime, analiza periodike të bëra nga AKEP që analizojnë sektorin TIK dhe zhvillimin e broadband-it në nivel kombëtar si:

- Analiza e tregut të telefonisë fikse
- Analiza e tregut të telefonisë së lëvizshme
- Analiza e tregut për linjave me qera
- Analiza e tregut për broadbandin

Eshte për të nënvizuar se analizat e tregut përkatës të kryer nga AKEP janë të fokusuara nga tregun e aksesit apo të ofrimit të shërbimeve nga ana e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike dhe në

nivelin e përdorimit bazuar në të dhënat e sipërmarrësve për numrin e pajtimtarëve. Zakonisht grupimi i pajtimtarëve mund të gjendet në kategorinë pajtimtare biznes dhe familjare.

Studime të tjera që lidhen me sektorin TIK janë ato të mbështetura nga dldp në kuadër të projektit për zhvillimin e NJQV-ve në qarkun Shkodër – Lezhë. Këto studime dhe vlerësime lidhen me prezencën e e-qeverisjes në NJQV-te në këte zonë dhe rrjedhimisht kjo e lidhur me aksesin e Internetit dhe broadbandit.

Anketa dhe vrojtimet e kryera nga AKSHI në periudhën dhjetor 2012 - janar 2013, për 100 NJQV (65 Bashki dhe 35 Komuna te Qarkut SHKODËR Lezhe) tregojnë se NJQV-te mungesa e lidhin arsyen e mungesës së e-qeverisjes dhe prezencës në web me:

- Mungesa e fondeve
- Mungesa e personelit IT
- Arsye teknike
- Kosto e lartë e mirëmbajtjes
- Mungesa e lidhjes së Internetit
- Cilësia e dobët e lidhjes së Internetit
- etj.

Një analizë të detajuar të situatës së turizmit si dhe të përdorimit TIK për qëllim të turizmit paraqet dhe dokumenti i Strategjisë për Turizmin për 2014-2020 i publikuar në www.turizmi.gov.al. Edhe pse analiza që ky dokument paraqet është në nivel kombëtar, në të analizohet situata dhe në zonat turistike që ndodhen në zonën e mbuluar nga projekti IBB si Thethi, Valbona etj. Dokumenti në tërësi e identifikon TIK si një nga drejtimet që duhet të përmirësohet për mbështetjen dhe promovimin e turizmit në ve+anti për zhvillimin e shërbimeve elektronike të rezervimit, në hoteleri etj.

Studimi i GIZ i vitit 2012, mbi veprimtarinë e hoteleve në destinacionet bregdetare ka nxjerrë në pah si më poshtë:

Megjithëse janë bërë përmirësime të mëdha në infrastrukturën e përgjithshme në destinacione, hotelet përballen me probleme të tilla si ndërprerje te furnizimit me ujë, mungesë të sistemit të kanalizimit të ujrave të zeza, të telefonisë, të energjisë elektrike, të vendeve të parkimit, të sipërfaqeve me rrugë të asfaltuar, ndriçimit, sistemit të kullimit, zbulurimit të hapësirave publike.

Vëzhgime të ndryshme (studimi GIZ i vitit 2012, studimi GTZ –GOPA i kryer në bashkëpunim të ngushtë me ATA, studimi i Bankës Botërore), të realizuar me sektorin e akomodimit në Shqipëri, kanë treguar se sektori i akomodimit nuk ka njohuri mbi TIK.

Ka një përdorim të ulet të sistemeve ndërkombëtare të rezervimit, si dhe mungojnë njohuritë mbi marketingun online.

Draft strategjia për turizmin nënvizon se: *vonesa e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për marketimin e Shqipërisë si destinacion turistik sjell ndërlëkime të rëndësishme në konkurrueshmërinë e sektorit të udhëtimit për të konkurruar në tregjet e huaj origjine me konkurrentë më mire të pajisur nga vendet e rajonit.*

Nënvizimet e studimeve të kryera tregojnë që projekti IBB dhe njëkohësisht vendimmarrësit për zhvillimin e broadbandit në zonën e Bjeshkëve të Namuna dhe në tërësi duhet të konsiderojnë krahas zhvillimit të infrastrukturës dhe shërbimeve dhe rritjen e aftësive për TIK, gadishmërinë e përdoruesit (autoritetet publike, qytetaret, biznesi) për të përfituar realisht nga TIK.

Rekomandime për zhvillim të koordinuar dhe sinergji:

Një nga qëllimet e këtij studimi është dhe *evidentimi i mundësive të integritit të këtij projekti si dhe të projekteve të tjera të broadbandit që do pasojnë atë, duke i bërë ato pjesë integrale të strategjive rajonale të zhvillimit të këshillave të qarqeve të Shkodrës dhe Kukësit, nëpërmjet nxjerrjes në pah të rolit të broadband-it në zhvillimin social ekonomik të këtyre qarqeve.*

Sikurse prezantojmë në fillim të studimit, zhvillimi i broadbandit ndërthur:

- Ofrimin e aksesit që nënkupton zhvillimin e infrastrukturës broadband me zhvillimin e aplikacioneve, shërbimeve dhe përmbajtjes online
- Kuadrin ligjor e rregullator mbështetës për zhvillim
- Gadishmërinë e përdoruesve për marrjen dhe përfitimin e shërbimeve.

Në analizën e mësipërme u identifikuan një numër projektesh kryesisht të zhvillimit të infrastrukturës rrugore që lidhen ngushtë me prespektivën e zhvillimit broadband në zonën e Bjeshkëve të Namuna:

- Me interes për këtë studim dhe zhvillimin e TIK dhe broadbandit në zonën e Bjeshkëve të Namuna janë investimet në proces dhe të planifikuara për infrastrukturën rrugore segmenti Tamarë-Vermosh, rrugën Bogë-Qafë Thore që të çon në Theth, Segmenti Prekal-Kir, rrugën e Lekbibajt, etj, që krijojnë një rrjet të rrugëve hyrëse në Alpe.
- Për këto segmente rrugore është e rëndësishme të koordinohen zhvillimet në mënyrë që të përfshihet në këtë investim dhe infrastruktura mbështetëse për TIK si tubacionet për shtrimin e fibrës optike apo kablove koaksiale mbështetëse për shërbimet e komunikimit dhe transmetimet televizive.

Kontratat e reja te FSHZH per infrastrukturen rrugore ne qarkun e KUKËSIT:

- Njoftimi i muajit prill 2014 i FSHZH-se mbi kontratën CËC/ICB/2014/ËL-Rec 46-1 për rindërtimin e rrugës Tamarë – Vermosh, Lot 1, Rajoni i Shkodrës. Segmenti prej 14.7 km dhe periudha e ndërtimit ne 23 muaj. Financimi nga IPA 2009 përmes "KfW - Kreditanstalt für Eiederaufbau", Republika Federale e Gjermanise dhe FSHZH.
- Njoftimi shkurt 2014, program mbi Fondin e Investimeve Sociale IV për kontratën: SIF IV-ËC/ICB/2013/CË 1. Ndërtimi i 15 skemave të ujësjesve në rajonet Shkodër, Kukës dhe Diber. Investitori "KfW - Kreditanstalt für Eiederaufbau", Republika Federale e Gjermanise dhe FSHZH.
- Kontrata CËC/ICB/2013/ËL-Rec 54-1, rindërtimi i rrugës KUKËS - Shishtavec, Lot 2, Rajoni KUKËSIT dhe CËC/ICB/2013/ËL-Rec 54-2, i rrugës Kukës - Shishtavec, Lot 2, Rajoni Kukësit. Investitori "KfW - Kreditanstalt für Eiederaufbau", Republika Federale e Gjermanisë dhe FSHZH.

Në komunën Shalë, ka disa zhvillime si zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës në segmentin nga Ducaj në Qafëthore, me fonde të financuara nga KfV dhe të zbatuara nga FSHZH. Pritet të fillojë përmirësimi i rrugës edhe për segmentin Qafëthore-Theth. Është e nevojshme koordinimi për mundësimin e infrastrukturës mbështetëse në këtë rrugë për fibrën optike.

Në komunën Tropojë e Vjetër pritet së shpejti të fillojë shtrimi i rrugës Bucaj- Pradesh nga FSHZH. Në këtë kuadër projekti IBB duhet të shikojë mundësinë e bashkëpunimit për sigurimin e infrastrukturës mbështetëse në këtë rrugë për fibrën optike.

Në lidhje me zhvillimin e aplikacioneve, shërbimeve online ka gjithashtu një numër projektesh në zhvillim apo të planifikuara ku duhet të shikohet integrimi me IBB:

- Projekti Montea: Investim në zhvillim të qëndrueshëm njerëzor dhe lokal përmes menaxhimit pjesëmarrës e ndërkufitar në zonën e Kelmendit, Shkrelit, Andrijevicës, Beranës dhe Plavës.
- Projekti Hera Menaxhimi i turizmit të qëndrueshëm të trashëgimisë së Adriatikut, projekt i financuar nga programi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA Adriatic
- Projekti për zhvillimin e Alpeve është shumë i lidhur me projektin e IPB për zhvillimin e infrastrukturës TIK dhe broadband ne zonen e projektit. Koordinimi i aktiviteteve me FSHZH dhe kompanie hartuese të master planit dhe studimin e fizibilitetit është mëse i domosdoshëm.
- Projekti dldp 3 per qeverisjen elektronike është e lidhur me përmirësimin e infrastrukturës TIK dhe broadband. Koordinimi dhe bashkëpunimi me këtë projekt është i nevojshëm në kuadër te projektit IPB pasi lidhet me, krijimin e qendrave te informimit etj.

Në lidhje me përshtatjen e politikave, risjellim në këtë pjesë të studimit:

- aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit të draft Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit 2014-2020 të koordinohen me aktivitetet e parashikuara në projektin IBB
- hartimi i strategjise Dixhital Axxhenda 2014-2020 duhet të harmonizohet me strategjinë dhe aktivitetet e planifikuara ne Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit
- hartimi i politikave të zhvillimit rajonal në qarqet Shkodër dhe KUKËS të përfshijnë zhvillimet TIK dhe broadband
- rishikimi i planit të veprimit në dokumentin e politikave për komunikimin elektronik
- analiza dhe zhvillimi i skemave të financimit për broadband sipas planit të zhvillimit të broadbandit etj.

Në lidhje me legjislacionin:

- hartimi i akteve nënligjore për planifikimin e territorit të jetë në përputhje me kërkesat e direktivës kuadër për të drejtën e kalimit;
- adoptimi i rregullave objektive transparente dhe jodiskriminuese nga NJQV-të për lejet e infrastrukturës në komunikimet elektronike
- bashkëpunimi MIAP, MZHUT, AKPT, dhe NJQV-të
- të shikohet mundësia e përfshirjes së infrastrukturës TIK dhe shërbimeve elektronike ne legjislacionin e FSHZH-se
- adoptimi i politikave spektrale për prespektivën e zhvillimeve broadband në të ardhmen sipas praktikës së BE-së.
- adoptimi i akteve nënligjore per Shërbimin universal perfshire broadbandin

Në mbështetjen e investimeve për broadband në zone NJQV-te duhet:

- të shfrytëzojnë hapësirat ligjore për projekte PPP
- të shfrytëzojnë hapësirat ligjore per ndihme shtetërore për sipërmarrësit
- të nxiten për mbështjetjen e projekteve të broadband si mundësi rritje ekonomike për zonën etj.

Bashkëpunimi dhe sinergia midis projekteve të zhvilluara nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (MZHUT) si autoriteti përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Turizmin, kuadrin e përgjithshëm ligjor për zhvillimin e turizmit, procesin përkatës për planifikimin dhe zhvillimin, mbështetjen për administratën rajonale dhe organizimin eturizmit në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, si dhe përgjegjëse për planifikimin urban.

Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT) është autoriteti përgjegjës për marketingut e vendit si një destinacion turistik jashtë shtetit. Ky autoritet është shtrirë në rajone me gjithsej 11 zyra me prezencë dhe në qarqe. Duhet të rritet bashkëpunimi me NJQV-të e zonës në Bjeshkët e Namuna.

Mbështetur në diskutimet dhe takimet e zhvilluara në terren nga stafi i projektit me përfaqësuesit e NJQV-ve në zhvillimet e aktiviteteve në kuadër të projektit IBB për zhvillimin e broadband-it në Bjeshkët e Namuna duhet të mbahen parasysht kërkesat/sugjerimet për:

- standartizimi i web site-ve ekzistuese të cilat promovojnë turizmin e zonës në mënyrë që të bëhet i mundur sistemimi i të gjithë informacioneve ekzistuese të cilat janë të vlefshme.
- Sigurimi i sinergjisë mes projekteve që zbatohen në zonë me qëllim rritjen e përfitimit nga të gjitha NJQV-te e zones
- NJQV-të duhet të jenë pjesë e rëndësishme në hartimin dhe zbatimin e Strategjisë së Turizmit për zonat që mbulojnë
- Projekti duhet të konsiderojë reformën territoriale duhet mbajtur parasysh në kuadër të zbatimit të këtij projekti, pasi një numër i komunave do reduktohen.
- Projekti të mundësojë krijimin e web site ne NJQV-te për të komunikuar më mirë me KQ për mbledhjen e të dhënave si dhe për koordinim të projekteve, aktiviteteve dhe veprimtarive të tjera.
- Duhet bashkëpunuar me projektin për “Qendrën e Informacionit Turistik” me qëllim pasurimin e përmbatjes dhe ofrimin e saj në më shumë se një gjuhë si një mundësi e mire për rritjen e kërkesës dhe turizmit.
- Rritja e kapaciteteve të komunës Kelmend nëpërmjet rritjes së aksesit në internet broadband, si dhe krijimi i web-site të komunës ngrihet si nevojë nga drejtuesit e saj. Koordinimi i projektit IBB, me atë të projektit për krijimin e “Qendres së Informacionit Turistik”, mund të shërbejë në këtë drejtim dhe sinergji midis këtyre dy projekteve.
- Koordinimi me projektin PAP2 të Postës Shqiptare është gjithashtu një mundësi për t’u konsideruar nga projekti IBB në veçanti në komunat ku aktualisht ky projekt ofron pika aksesit.
- Kooperimi me AKEP për realizimin e mbulimit të plotë me rrjet celular në rrugën që shkon përmes komunës së Kelmendit deri në Vermosh, komunën Margegaj etj.
- Bashkëpunimi me MAS dhe Posta Shqiptare për sigurimin e lidhjes së internetit të qëndrueshëm për shkollën e bashkuar në Tamarë.
- Krijimi i një web site-i cilësor, për zonën e Bjeshkëve të Namuna mund të mbështetet nga projekti IBB në kooperim me projektin e dldp-se, MZHUT, AKT etj.
- Sigurimi i lidhjes broadband në qendrën shëndetësore të Kelmendit, kooperimi me Ministrinë e Shëndetësisë për t’u lidhur me rrjetin telematik shëndetësor.

- Sigurimi i internetit në fshatrat Gradec, Rrapsh, Bratosh që nuk kanë lidhje internet. Projekti IBB mund të shërbejë në nxitjen e investimeve në këtë zonë.
- Gjithashtu projekti IBB duhet të shikojë sinergjinë me projektin RDP që do ngrejë dy qendra informimi turistike njëra në Doganën e Hanit të Hotit dhe tjetra në Tamarë.
- Sigurimi i internetit broadband në komunën Bujan për komunën, qendrën shëndetësore dhe për komunitetin etj.

Nxitja e investimeve ne infrastrukturen TIK dhe broadband mbetet e domosdoshme. Koordinimi dhe sinergjia me projektet në zbatim apo të planifikuara nga FSHZH dhe projekte të tjera të prezantuara në këtë studim janë mëse të nevojshëm

Fund Kapitulli II

KAPITULLI III

“Shërbimet Internet Broadband në zonën “Bjeshkët e Namuna”

Hyrje

Interneti hapi një epokë të re në fushën e komunikimeve dhe ndryshoi në menyrë rrënjësore jetën e përditëshme të njerëzve duke rritur efikasitetin e krijimit dhe këmbimit të informacionit. Telekomunikacionet dhe shërbimet broadband janë një element kryesor i infrastrukturës në zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi pasi ato mbështesin fuqimisht të gjitha llojet e veprimtarive të një shoqërie, që nga prodhimi i të mirave materiale dhe shërbimeve, në arsim, shëndetësi, miqëverisje deri tek argëtimi, problemet sociale dhe mbrojtja dhe zhvillimi i mjedisit. Shërbimet Internet me bazë të gjerë krijojnë jo vetëm mundësi të përmirësimit dhe zhvillimit të komunikimeve por duke suportuar kapacitete të larta të transmetimit të dhënash krijojnë mundësi për zhvillimin e aplikacioneve online dhe atyre të avancuara.

Shërbimet elektronike janë një faktor shumë i rëndësishëm për kalimin e barrierave ekonomike dhe gjeografike pasi ato sigurojnë komunikim virtual për të gjithë dhe gjatë gjithë kohës, kështu në arsim shërbimet elektronike të mbështetura mbi shërbimet e Internetit me bazë të gjerë ndihmojnë në edukimin në distancë, e-learning, e-shkollë etj. ndërsa në shëndetësi ndihmojnë në shërbimet e shëndetësisë, diagnostikimet dhe monitorimet e shëndetit në distancë etj. Në fushën e turizmit shërbimet elektronike dhe ato të Internetit me bazë të gjere ndikojnë në promovimin e burimeve turistike, informimin e turistëve, pozicionimin dhe udhërrëfimin etj. Po kështu në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme shërbimet elektronike dhe ato të Internetit janë të nevojshme për ndërmjetësimin dhe komunikimin me qeverisjen lokale dhe qendrore (prokurimi elektronik, deklarimi tatimor, pagesa e taksave etj.), reklamimin e biznesit dhe produkteve me anë të metodave interaktive si faqeve web, aplikacioneve për mobile ose PC, rrjeteve sociale etj. si dhe kryerja e veprimeve financiare online nëpërmjet shërbimeve e-banking.

Në kohët e sotme gjithashtu, edhe shërbimet klasike të telefonisë dhe televizionit po kalojnë nga teknologjitë klasike në ato të reja duke gjeneruar aplikacione të pafundme për sisteme fikse dhe mobile. Këtu mund të përmendim shërbimet e ngritura mbi Internet Protokollin që janë VoIP, FoIP, IPTV, gjenerata e katërt e telefonisë së lëvizshme etj.

Por përdorimi i shërbimeve me bazë të gjerë nuk kërkon vetëm ekzistencën e rrjetit por gjithashtu edhe të përmbajtjes, aplikacioneve të avancuara, pajisjet dhe njohuritë për përdorimim, pra nuk kemi të bëjmë thjesht me një teknologji të re komunikimi por kemi të bëjmë me një komponent të rëndësishm dhe qendror të një sistemi të ri i cili fut në ndërveprim elementë kryesorë dhe ndihmës te zhvillimit ekonomik-social duke u kthyer në një qendër dinamike që përfishin gjithë ekonominë dhe shoqërinë në një rreth vicioz bazuar në principet e ndryshimit të shpejtë, efektiv dhe tepër bashkëpunues.

Qëllimi

Qëllimi i këtij studimi është që të bëhet një pasqyrim dhe vlerësim i saktë i teknologjive që ofrojnë Internet broadband-in në zonën e “Bjeshkëve të Namuna”, duke dhënë një informacion të plotë të infrastruktures së zgjidhjeve teknologjike, si shtrirjet e fibres optike, shtrirjen e DSL, vendvendosjen e antenave për Shërbimin mobile, lidhjet Point to Point, Pikat e Aksesit Publik me Internet, antenat dhe transmetuesit e radio/TV dhe antenat për shërbimin broadband Satelitor, si dhe të dhëna mbi konektivitetin ndërkombëtar. Gjithashtu duhet që nëpërmjet këtij studimi të evidentohen barrierat dhe sfidat që pengojnë aksesin në Internet dhe të sugjerohen apo rekomandohen rrugët për uljen/eliminimin e tyre.

Në përputhje me objektivat kombëtare për Internet broadband dhe ICT të bëhen rekomandimet për mundësitë e përfshirjes së skemave të shërbimit universal për Shërbimin e Internetit, për investimet publike apo dhe iniciativat financiare në promovimin e broadbandit në zonën e projektit.

Përshkrimi i teknologjive broadband

Teknologjitë broadband në përgjithësi mund t'i ndajme në dy grupime të mëdha në bazë të ambientit fizik mbi të cilin shpërndahen:

1. Teknologji e bazuar mbi rrjet fikse.
2. Teknologji e bazuar mbi rrjet valor ose mikrovale.

Teknologjia e bazuar mbi rrjetin “Fiks” krijon mundësinë e lidhjes së ofruesit të shërbimit dhe përfituesit të tij mbi rrjet “fizik” dhe shembulli më i mirë për këtë është shërbimi i vjetër telefonik ose Internet me lidhje Dial-Up ku lidhja realizohej nëpërmjet një çifti telash bakri nga operatori i ofrimit të shërbimit deri tek përdoruesi. Teknologjia e bazuar mbi rrjetin valor krijon mundësinë e lidhjes së ofruesit të shërbimit me përfituesin me anë të një komunikimi radio valor ose sic njihet më mirë me mikrovalë radio dhe shembulli më i mirë në këtë rast është shërbimi i telefonisë mobile ose lidhjet Wi-Fi.

Broadband mbi rrjet “Fiks”

Teknologjia e rrjetit Internet me bazë të gjerë e mbështetur mbi rrjet “Fiks” nënkupton lidhjen e klientit fundor që mund të jetë një biznes apo familjar me anë të linjave fizike fikse. Shumë teknologji broadband janë konceptuar që të shfytëzojnë rrjetat ekzistuese ku mund të përmendim xDSL që operon mbi linjat ekzistuese telefonike, PLC që operon mbi rrjetin ekzistues të tensionit të ulët 220V AC, Kabëll-modem e cila operon mbi rrjetin ekzistues CAT-TV. Teknologjia më e fundit për Internet Broadband është ajo FTTX e cila mundëson lidhjen e klientit fundor me anë të fibrës optike dhe siguron kapacitete shumë të larta komunikimi. Duke u nisur nga mënyra e përfutimit të lidhjes, përfundim kemi këto teknologji të rrjetit Internet me baze të gjerë:

- Hybrid Fiber Coax HFC : Kabëll TV dhe Kabëll Modem
- Digital Subscriber Line : xDSL
- Broadband Power Line : BPL
- FTTx

Lidhjet Kabëll TV dhe Kabëll Modem mbi HFC

Në ditët e sotme rrjetet HFC ose siç njihen rrjetat Dixhitale Kablore kanë mundësinë e ofrimit të komunikimit të dyanshëm përveçse ofrimit të shërbimit standart të Dixhital TV që njihet me standartin DVB-C . Kjo krijon mundësinë që nëpërmjet këtij rrjeti të kryhet një lidhje fizike midis

Modemit Kabllor që vendoset në pikën fundore dhe pajisjes transmetuese në qendër që njihet me emrin CMTS të cilat komunikojnë ndërmjet tyre me një protokoll të quajtur DOCSIS version aktual i të cilit është DOCSIS 3.0 por që në fazën eksperimentale është DOCSIS 3.1. Duhet theksuar që në vendet Europiane ky protokoll komunikimi njihet me termin EuroDOCSIS. Kapacitetet e komunikimit në një rrjet kabllor i cili punon mbi EuroDOCSIS 3.0 arrijnë një mesatare 200Mbps DownStream dhe 50Mbps UpStream por me standartin EuroDOCSIS 3.1 do të arrihen kapacitete komunikimi në rrjet me një mesatare 1 Gbps DownStream dhe 250 Mbps UpStream. E mira e këtij rrjeti është që ky rrjet mund të bëhet upgrade vetëm duke ndërruar terminalët (CMTS dhe Modemin Kabllor) si dhe është multifunksional pasi në të njëjtin rrjet kalon edhe sinjali televiziv. Modemat e sotëm kabllor shërbejnë gjithashtu edhe për ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse pra nëpërmjet një modemi kabllor përfitohet shërbimi Internet broadband si dhe telefonia fikse. Një skemë e organizimit dhe funksionimit të këtij rrjeti jepet më poshtë.




Figura nr.9 - Topologjia e rrjetit HFC

Lidhjet xDSL - Digital Subscriber Line

Teknologjia xDSL përdor infrastrukturën ekzistuese telefonike e cila përbëhet nga përcjellës bakri për transmetimin e të dhënave dhe në këtë mënyrë në të njëjtin kanal komunikimi kalon edhe sinjali telefonik dhe po ashtu të dhënat ose trafiku Internet. Ekzistojnë disa tipe të lidhjeve xDSL ku mund të përmendim SDSL, VDSL por më i përdorshëm për Internet Broadband në këtë teknologji është ai ADSL i cili siguron një transmetim josimetrik ku kapaciteti në transmetim është shumë më i madh se ai në marrje për vetë natyrën e rrjetit broadband. Në kohët e sotme kjo teknologji përfaqësohet nga ADSL2 dhe ADSL2+ ku kapacitetet e transmetimit janë në nivelet 28Mbps në marrje dhe 3.5Mbps në dhënie por e meta e kësaj teknologjie është që shpejtësia e transmetimit ulet me rritjen e distancës dhe shpejtësitë maksimale arrihen për një distancë prej 1 km. Për të evituar këtë hendek shumë operatorë e përdorin këtë teknologji vetëm për lidhjet “Last mile” dhe pjesa tjetër e rrjetit është e ndërtuar mbi fibra optike. Më poshtë jepet një skemë e operimit të këtij rrjeti si dhe një tabelë e varësisë së shpejtësisë së lidhjes nga distanca. Një standart tjetër xDSL i përdorshëm në ditët tona është edhe VDSL shpejtësia maksimum e të cilit arrin në 100Mbps por e kufizuar shumë nga distanca dhe lidhje të tilla përdoren vetëm në rastet kur operatori ofron shërbime Triple-Play ose me shumë.




Fig. nr. 10 – Topologjia e rrjetit Hibrid Fibër optike - ADSL

Tabela nr.17 – Shpejtësitë e lidhjes broadband sipas teknologjisë xDSL

Emërtimi i Standartit ADSL	Emërtimi i Lidhjes ADSL	Shpejtësia Maksimum në Marrje	Shpejtësia maksimum ne dhënie
ITU G.992.1	ADSL (G.DMT)	8 Mbit/s	1.0 Mbit/s
ITU G.992.2	ADSL Lite (G.Lite)	1.5 Mbit/s	0.5 Mbit/s
ITU G.992.3/4	ADSL2	12 Mbit/s	1.0 Mbit/s
ITU G.992.3/4 Annex J	ADSL2	12 Mbit/s	3.5 Mbit/s
ITU G.992.3/4 Annex L	RE-ADSL2	5 Mbit/s	0.8 Mbit/s
ITU G.992.5	ADSL2+	24 Mbit/s	1.0 Mbit/s
ITU G.992.5 Annex L	RE-ADSL2+	24 Mbit/s	1.0 Mbit/s
ITU G.992.5 Annex M	ADSL2+	28 Mbit/s	3.5 Mbit/s

Lidhjet BPL - Broadband Power Line

Broadband Power Line është një teknologji e cila mundëson transmetimin e të dhënave (trafikun IP) nëpërmjet rrjetit elektrik të tensionit të ulët 220V AC. Edhe kjo teknologji lindi si nevojë e kërkesës për rrjete broadband por me kosto të optimizuara pasi në këtë rast shfrytëzohet një rrjet ekzistues. Transmetimi i trafikut Internet nëpërmjet linjave të tensionit kryhet duke shfrytëzuar komponentet e frekuencës së rrymës alternative. Kapaciteti i lidhjes së një modemi BPL ose PLC shkon deri në 200Mbps. Duhet theksuar se në këtë teknologji bazohen sot rrjetat e “mençura” ose sic quhen “smart grid” të cilat po kryejnë një revolucion të vërtetë në përmirësimin dhe kontrollin e shërbimeve publike si energjia elektrike, uji, gazi etj. Me anë të kësaj teknologjie arrihet të komunikohet me matësat elektrike inteligjentë, matësat e ujit inteligjentë dhe matësat e gazit

inteligjentë të cilët komunikojnë me qendrën e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të operatoreve publike që ofrojnë këto shërbime. Gjithsesi edhe kjo teknologji ka të metat e veta pasi kufizohet shumë nga distanca si dhe nga ndarjet pasive të cilat shërbejnë për uljen e tensionit (transformatorët elektrikë) nga tensioni i lartë në atë të mesëm dhe në atë të ulët. Gjithashtu ka akoma diskutime nga bordet e FCC dhe CE përse i përket gjenerimit të radiofrekuencave nga kjo teknologji të cilat interferojnë me rrjete ekzistuese radiofrekuencash.

Teknologjia FTTx (FTTH,FTTB,FTTC)

Teknologjia FTTx nënkupton lidhjen e elementit fundor i cili mund të jetë shtëpi, biznes apo kabinet direkt me fibër optike. Deri në 4-5 vjet më parë kjo teknologji shërbente për lidhjen e nodeve të rrjetave CAT-TV dhe xDSL. Rrjetat e para me teknologji të lidhjes me fibër optike ishin ato pikë më pikë ku çdo fundor lidhej direkt me pajisjet transmetuese por kjo menyrë lidhje ka kosto të lartë për tu përdorur për lidhje broadband dhe për këtë arsye sot përdoret vetëm në lidhjet e nyjeve të rrjetit backbone. Për shkak të kostove të larta që kishte kjo teknologji u gjetën zgjidhjet PON (Passive Optical Network) dhe rrjetat e reja broadband po bazohen gjithmone e më shumë në këtë teknologji. Zbulimi i teknologjise PON çoi në diversifikimin e kësaj familje ku mund të përmendim: APON, BPON, GPON, EPON, GEAPON, CPON dhe WPON. Avantazhi që ofron kjo lloj teknologjie është se i gjithë rrjeti midis operatorit ose node deri tek klienti fundor është pasiv duke u bazuar mbi teorinë e splitimit të komunikimit mbi fibër optike ku çdo pajisje fundore komunikon me pajisjen qendrore në një gjatësi të caktuar valore drite duke krijuar kanale virtuale komunikimi të dedikuara. Kështu, është e mundur që në një fije Fibre optike e cila degëzohet të lidhen deri në 256 pajisje fundore ku secili ka një shpejtësi lidhjeje lokale 1Gbps në rastin e GPON dhe GEAPON. Teknologjite PON më të përdorshme për momentin janë ato EPON, GPON dhe GEAPON. Përveçse kapacitetit ultra të lartë i cili mundëson ofrimin e shume shërbimeve që nga Interneti me kapacitete shumë të larta, IPTV me kanale Full HD dhe 3D, VOD, Videofoni etj, kjo lloj teknologjie ofron edhe shërbim për distanca të largëta ku pajisja transmetuese OLT lidhet me pajisjen fundore ONU deri në distancë prej 20 km. Gjithashtu avantazh tjetër i përdorimit të teknologjisë GePON është edhe garancia e shërbimit (QoS) pasi kjo teknologji nuk ndikohet nga faktorët e jashtëm si dhe norma e ulët e amortizimit ose jetëgjatësia e rrjetit. Kjo teknologji po zbatohet gjërësisht sot në vendet të cilat investojnë për herë të parë në teknologji broadband për arsyet e mësipërme por nga ana tjetër kërkon si kusht edhe një dendësi të caktuar të përdoruesve fundorë për të qënë një investim rentabël. Pajisjet fundore ose fibër modem kanë të njëjtat karakteristika funksionaliteti ashtu si dhe ata ADSL duke ofruar shërbim Interneti, telefonie por në këtë rast sigurojnë më mirë edhe funksionimin e pajisjeve Setup Box IPTV me anë të të cilave mundesohen shërbimet televizive. Gjithashtu në shumë vende të tjera të cilat kanë ambicje të larta në fushën e përhapjes së broadband

po kryhet zëvendësimi i rrjeteve ekzistues ADSL ose CAT-TV me rrjetet e reja GePON. Një skemë e funksionimit të këtij rrjeti jepet në figurën më poshtë.




Fig.nr. 11 - Topologjia e rrjetit FTTx

Teknologjia Wireless ose mikrovalore

Në përgjithësi Ëireless broadband i referohet teknologjive që përdorin lidhje mikrovalore pikë më pikë ose Pikë me shumë pika duke filluar nga frekuenca 25kHz deri në 60GHz e më sipër të cilat lidhin nyje të rrjetit ose klientë fundorë . Duke u nisur nga brezi i frekuncave ku këto teknologji punojnë, brezat e frekuncave të punës ndahen në breza të licensuar dhe në breza të palicensuar. Përdorimi i brezave të lartë ose të ulët të frekuncave ka të mirat dhe të këqijat e veta pasi nëse për brezin e lartë mbi 10GHz kemi kapacitete të larta transmetimi si dhe lehtësi instalimi pasi antenat që përdoren janë të përmasave të vogla por e keqja e këtij brezi është degjenerimi i sinjalit me rritjen e distancave si dhe ndikimi nga faktorët atmosferike.

Gjithashtu teknologjitë wireless mund t'i klasifikojme gjithashtu në ato të cilat kërkojnë pamje direkte midis dy pikave marrëse-dhënëse (LOS) ose në ato të cilat nuk kërkojnë pamje direkte (NLOS) . Në teknologjitë wireless që kërkojnë LOS mund të përmendim : Lidhjet PtP ose pikë më pikë, LMDS (Local Multipoint Delivery System) , FSO (Free Space Optics) , Broadband satelitor etj, ndërsa në teknologjitë wireless NLOS mund të përmendim : GSM, CDMA, 3G, 4G, WiFi, Wi-Max, MMDS etj dhe duke u nisur nga një logjikë e thjeshtë teknologjitë me NLOS janë më të avantazuara dhe më të përdorshme se ato me LOS.

Rrjetet Wireless broadband mund t'i kategorizojmë si më poshtë :

- Microwave Links (Lidhje mikrovalore në radiofrekunce Pikë më pikë)
- MMDS (Multichannel Multipoint Distribution Service)
- FSO (Free Space Optics)
- Wi-Fi (Wireless Fidelity)
- Wi-Max (Worldwide Interoperability for Microwave Access)
- Satelitore
- 3G
- LTE

Lidhjet Mikrovalore në radiofrekunce pikë më pikë – Microëave Links

Kjo lloj teknologjie ashtu si u theksua më lart kërkon pamje direkte midis dy pikave marrëse dhe dhënëse dhe përdoret kryesisht për të lidhur dy nyje backbone të rrjetit por mund të përdoret edhe për lidhje akses të klientit fundor. Në përgjithësi kjo mënyrë lidhje përdoret kur nuk ka mënyra të tjera lidhjeje që të justifikojnë raportin kosto për Mbps trafik pra, nëse kërkesa për kapacitetet vjen dhe rritet atëherë kalohet në teknologji të tjera të cilat e justifikojnë këtë kosto. Këto lloj lidhjes janë më të përdorshme në brezat 6, 7, 8, 10, 13, 15, 18, 23 MHz dhe kapacitetet e lidhjeve variojnë nga 10 Mbps deri në 2 Gbps duke përdorur modulime nga QPSK deri në 4096QAM. Transmetimet në këto breza në Republikën e Shqipërisë rregullohen sipas Planit të Përdorimit të Frekuncave (<http://www.akep.al/index.php/sq/ppf>) dhe licensohen nga AKEP sipas procedurave perkatëse që gjenden në <https://www.aplikimeonline.al/> . Kjo teknologji për momentin përdoret nga operatorët e telefonisë Mobile , ISP-të, Televizionet Dixhitale etj.

Lidhjet MMDS (Multichannel Multipoint Distribution Service)

Rrjetet wireless MMDS ishin të parat që zëvendësuan teknologjinë pikë më pikë duke përdorur në një qendrorë një antenë sektoriale 90°- 120° e cila lidhet me terminalin me lidhje pikë-shume pika (Point to Multipoint). Duke shtuar zonën e mbulimit kjo teknologji ofron kosto më të ulët se ajo PtP për lidhje si dhe është e aftë që të transmetojë në të njëjtin kanal komunikimi shërbim TV,

Telefoni dhe Internet. Kjo teknologji u krijua si një nevojë alternative për rrjetet CAT-TV për zonat me dendësi të ulët popullore dhe distance të largëta si dhe të kushtëzuara nga terreni. Kjo teknologji përdor brezin 2.1GHz-2.7GHz dhe për terrene të hapura distancë e komunikimit mund të shkojë deri në 100Km si dhe kapacitet e lidhjes duke përdorur sistemin DOCSIS arrijnë në 50Mbps për një kanal pune 8Mhz. Një skemë e ndërtimit dhe funksionimit të këtij rrjeti jepet si më poshtë:




Fig. nr. 12 – Topologjia e rrjetit MMDS

Lidhjet LMDS (Local Multipoint Distribution Service)

Rrjetat Wireless LMDS ashtu si rrjetet MMDS përdorin lidhje Point to Multi-Point (Pikë shumë Pika) duke përdoruar edhe këta një antenë sektoriale ose omni ne varësi të zonës së mbulimit por në këtë rast përdoret si frekuencë pune brezi nga 27.5GHz-31GHz që shkakton limitim në distancë të sinjalit deri në 8Km. Kjo kushtëzon që për mbulimin e një zone me sipërfaqe të madhe të përdoren shume transmetues të cilët lidhen me një kryesore ose Head-End me Lidhje Mikrovalore Pikë më pikë ose me Fibër optike. Frekuenca e lartë e punës siguron në anën tjetër kapacitete të larta komunikimi të cilat shkojnë deri ne 1Gbps për stacion transmetimi.

Lidhjet Wi-Fi

Rrjetat mikrovalore Wi-Fi janë pasardhëse të atyre MMDS dhe punojne ne brezin 2.4 GHz të brezit UHF dhe 5.8GHz të brezit SHF në një topologji rrjeti Point to Multi-Point. Qëllimi kryesor i këtyre rrjeteve është që të sigurojë konektivitet brenda një zone të caktuar e cila mund të jetë një shtëpi, zyre apo ambjent i hapur dmth një alternative e rrjetave LAN prandaj pajisjet që përdoren në këtë lloj teknologjie quhen ndryshe SOHO (Small Office – Home Office) ndërsa rrjeti WLAN dhe distancat që mbulon kjo lloj teknologjie arrijne deri në 50 m në ambiente zyresh ose shtëpie dhe deri në 150m në ambiente të hapura. Kjo teknologji është bazuar në standartin IEEE 802.11x që ka evoluar me kalimin e kohës duke kaluar nga standarti 802.11b në 802.11g, 802.11n, 802.11a, 802.11ac, 802.11ad dhe 802.11ah dhe ne shpejtësi lidhjeje nga 2Mbps që ishin në fillimet e këtij standarti deri në 800Mbps në standartet e fundit. Me këtë teknologji janë të pajisura të gjitha pajisjet që përdoren sot në rrjetet wireless dhe mobile duke filluar nga Labtopet, tabletat, smartfon-ët, projektorët, televizorët e gjeneratës së fundit e madje edhe pajisjet elektroshtëpiake si frigoriferët dhe lavatricet. Duhet theksuar që komunikimi në këtë brez kryhet i lirë pa licensim por kundrejt parametrave të caktuar për fuqinë e transmetimit. Teknologjia Wi-Fi është më e përdorura për momentin dhe krijon mundësi të ofrimit të shërbimit të Internet edhe në ndihmë të teknologjive të tjera duke qenë se ka avantazhin e lidhjes mobile, kështu modemmat ADSL, modem kabllorë, Pajisjet ONT, modemmat MMDS dhe LMDS të gjithë kanë brenda familjes së tyre pajisje që kanë të inkuorporuar trasmetimin wi-Fi për të mundësuar lidhjen e pajisjeve mobile brenda shtëpisë ose branda zyrës pa tela. Gjithashtu në aeroporte, porte, shkolla, stadiume dhe pika publike me anë të Shërbimit HotSpot mbi Wi-Fi u ofrohet shërbimi Internet publikut të gjerë.

Lidhjet WiMAX (Worldwide Interoperability for Microwave Access)

Teknologjia wireless WiMAX bazohet në standartin 802.16x dhe ofron në veçanti nga Wi-Fi lidhje broadband për distancë më të largëta duke arritur deri ne 30 Km. Rrjetet wiMAX ndahen në dy kategori, në ato që kërkojnë LOS dhe në ato që nuk kërkojnë LOS ose ndryshe NLOS. Teknologjia WiMAX që kërkon LOS përdoret zakonisht për lidhje pikë më pikë për të lidhur dy pika të rrjetit

backbone ose siç njihen ne gjuhën teknike “Wireless backhaul” ndërsa teknologjia WiMAX NLOS përdoret në rrjetet NLOS në topologjinë Pont to MultiPoint. Standarti 802.16a funksionon në brezin e frekuencave 2-11GHz dhe përdoret për wireless broadband duke ofruar lidhje për klientët rezidencialë me kapacitete deri në 75Mbps per klient si dhe është në gjendje të ofrojë konektivitet si për pajisjet fikse, për ato të lëvizshme dhe ato nomadike duke ofruar për klientët shërbimet Internet, Televizion, Telefoni, Videofoni etj. Funksionaliteti i rrjetit WiMAX realizohet nëpërmjet pajisjeve bazë dhe pajisjeve “klient” ku një pajisje “bazë” komunikon njekohëshisht me të gjithë pajisjet klient.Me kalimin e kohës teknologjia WiMAX është përmirësuar në funksion të kërkesave të tregut duke kaluar në standartet e reja 802.16d, 802.16e etj por gjithashtu edhe duke zgjeruar brezin e punës deri ne 66 GHz.

Lidhjet DBS (Direct Broadcast Satellite)

Vite më parë sitemet tradicionale të marrjes së sinjalit televiziv nëpërmjet një lidhje satelitore quheshin Direct-to-Home TV dhe karakterizoheshin nga lidhje njëdrejtimëshe nga sateliti drejt klienteve. Ne kohët e sotme këto transmetime janë zëvendëuar me standartet DVB-S dhe DVB-S2 por gjithashtu shërbimet e reja Direct Broadcast Satellite ofrojnë lidhje të dyanëshme satelitore duke krijuar mundësinë për shërbime Internet Broadcast me kapacitete të larta. Sistemet DBS përdorin satelite geostacionare te cilët ndodhen ne një distancë 22.000 – 24.000Km nga toka dhe operojne në bandën Ku të frekuncave ne 12 GHz frekuencë marje dhe 14GHz frekuencë transmetimi. Lidhja e satelitit me stacionin qëndror kryhet nëpërmjet nje lidhjeje wireless backhaul ndersa Sateliti lidhet njëkohësisht me të gjitha antenat parabolike të klienteve. Problematika kryesore e ketyre rrjeteve është koha e larte e replikimit të paketave rreth 500ms e cila krijon vonesë në komunikim e cila për disa aplikacione mund të jetë e demshme dhe ketu fusim thujse të gjitha aplikacionet interactive ne kohe reale ku futen komunikimi nepërmjet videos, perdorimi i VoIP, lojërat online etj. Përdorimi i një rrjeti i cili do të ketë distancë më të vogël nga toka,të paktën 1000km do ta përmirësontë komunikimin dhe do ta ulte kohë vonesën ne 50ms e mjaftueshme për ekzekutimin e aplikacioneve në realtime. Një projekt i tille ka nisur nga Google ne qeshor të vitit 2013 dhe synon hedhjen ne Stratosferë te balonave te cilët do të lundrojnë në lartësinë e stratosferës dhe do të ofrojnë konektivitet Interneti për të gjithë globin. Testet e para të ketij projekti janë kryer me sukses në Zelanden e Re dhe Google Loon pritet që të bëjë një revolucion në teknologjinë e wireless internet broadband. Më poshtë jepet skema e funksionimit të teknologjisë DBS.




Fig. nr. 13– Topologjia e lidhjes Internet Broadband satelitore

Rjetat e telefonisë së lëvizshme 2G , 3G dhe 4G

Sot shërbimi broadband në pajisjet e lëvizshme ka marrë një përdorim shumë të madh dhe është kthyer në një faktor për zhvillimin e software dhe aplikacioneve për pajisjet mobile ku me të përhapur janë sistemet Android, Windows Mobile dhe IOS. Por që të arrihej deri në këtë pikë u desh që të kaloheshin shumë hapa nga telefonia mobile e brezit 1G deri aktualisht ku përdoret në masë teknologjia 3G dhe ajo 3.5G por e branduar si 4G. Gjeneratat e telefonisë së lëvizshme krijuan mundësinë e kalimit nga komunikimi me aparate fikse në ato të lëvizshme dhe sot ato inteligjente. Brezi i parë ose gjenerata 1G ishte tërësisht e bazuar mbi sinjal analog dhe ofronte vetëm shërbime “zëri” duke u bazuar mbi standartet AMPC, TAC dhe ETACS. Përmirësimi i dukshëm u arrit me gjeneratën e dytë ose sic njihet 2G e cila bazohej jo më në sinjalin analog por në atë dixhital dhe u bazua mbi standartet GSM, CDMA, TDMA dhe EDGE. Në rrjetin GSM i cili ofronte vetëm shërbime të zërit dhe mesazheve u fut protokollin GPRS i cili bënte të mundur transferimin e të dhënave duke përdorur të njëjtin rrjet. Ky protokoll i bazuar mbi parimet e protokollit IP krijoi mundësinë për rrjetet e para Internet Broadband të lëvizshme ku kapaciteti i transmetimit arrin deri në 170Kbps. Më vonë me rritjen e kërkesës për kapacitet u kalua në komunikimet data mbi protokollin EDGE (Enhanced Data for Global Evolution) i cili shërben si ndërmjetës në kalimin në gjeneratën e tretë 3G. Kapacitetet që ofron GSM-EDGE shkojnë deri në 384Kbps dhe sigurojnë një komunikim më të shpejtë për përdoruesit mobile por përsëri kërkesa e konsumatorit ndryshoi në

rritje dhe kjo kërkesë çoi në implemetimin e rrjeteve të lëvizshme 3G duke u bazuar në standartet e reja të komunikimit UMTS, WCDMA dhe HSPDA . Fillimisht rrjetet 3G ofronin kapacitete duke filluar nga 2Mbps por sot rrjetet 3.5G dhe 3.75G ofrojnë kapacitete shumë të larta deri në 72Mbps. Këto kapacitete bëjnë të mundur që me anë të këtyre rrjeteve të ofrohen shërbime të tjera të avancuara si Internet broadband me shpejtësi të lartë, videofoni me kualitet të lartë figure, mobile TV etj. Përhapja dhe përdorimi i madh i telefonave “të zgjuar” smartphone, ofrimi i shërbimeve interaktive gradualisht kërkojnë kapacitete të larta dhe për këtë aktualisht në mbarë botën është duke u implementuar telefonia e levizshme e gjeneratës së katërt ose 4G. Termi 4G është “branduar” nga operatorët por sipas statarteve të ITU që një rrjet të quhet 4G ai duhet të suportojë një kapacitet min1Gbps doëload për një pajisje jo në lëvizje dhe një kapacitet 100Mbps për një pajisje që është në lëvizje. Rrjetet 4G në bazë ndryshojnë nga ato 3G jo vetëm për shkak të shpejtësisë së transferimit të të dhënave më të lartë por edhe se rrjetat 4G bazohen mbi protokollin TCP/IP me pak fjalëçdo lloj shërbimi që nga “zeri” deri tek shërbimet e avancuara bazohen totalisht në teknologjinë packet switching.

Shërbimet Broadband në Shqipëri

Shërbimet Internet broadband në Shqipëri kanë filluar të marrin këtë emër vetëm pas vitit 200 sepse përpara këtij viti nuk behej fjalë për të tilla shërbime. Theksojmë që një shërbim quhet Internet Broadband kur kapaciteti i lidhjes në rrjet është me i madh se 200Kbps ndërsa lidhjet përpara vitit 2000 kryheshin vetëm nëpërmjet dial-up që mund të arrinte deri në 56kbps dhe më rrallë nëpërmjet linjave ISDN ku kapaciteti i lidhjes arrinte në 128Kbps. Në vitet 1999-2000 ishin hapat e parë të rrjeteve broadband me lindjen e ISP-ve të para private si Abissnet, ADANet, ICC (sot ABCOM), Albania Online që u pasuan me pas nga ASC dhe ISP të tjera lokale pasi deri në këto vite operatori i vetem ne treg ishte Albtelekom i cili ofronte lidhje Internet mbi linjat ISDN. ISP-të e para ndërtuan rrjetet e para ADSL dhe Wi-Fi duke siguruar kështu lidhjet e para Internet Broadband. Përhapja e këtyre rrjeteve ishte shumë e vogël për shkak të kostos së lartë të implementimit të infrastrukturës deri tek klienti , cmimit të lartë të blerjes së kapaciteteve Internet nga operatorët Backbone si dhe fuqisë së ulët blerëse të tregut. Me kalimin e kohës tregu i shërbimeve broadband u zgjerua me operatorë të tjerë ku për herë të parë filluan të ofroheshin nga operatorët mobile Vodafone dhe AMC shërbimet Internet me anë të protokollit GPRS. Me zhvillimin e teknologjisë ISP-te dhe operatorët mobile përmirësuan teknologjinë e shërbimeve broadband duke ju përshtatur kërkesave të tregut dhe sot kemi një ofertë për lidhje broadband të shumëllojshme por është e kufizuar vetëm në zonat urbane dhe për këtë shkak penetrimi i shërbimeve Internet broadband është ende i ulët ne krahasim me mesataren europiane por duhet theksuar që në dy vitet e fundit numri i përdoruesve Internet është rritur në mënyrë të vullshme duke kaluar rritjen e shumë vendeve Europiane. Interneti broadband ne Shqipëri funksionon nëpërmjet rrjetit fiks dhe atij mobile por në ve+anti nga pjesa tjetër e Europës përhapja nëpërmjet rrjetit fiks është shumë poshtë mesatares Europiane me rreth 11% ndërsa përhapja nëpërmjet rrjetit mobile është nga më të lartat në kontinent shifër kjo që

ka ndikuar direkt në përmirësimin e statistikave. Kjo ka ndodhur për shak të mungesës së kapaciteteve në rrjetin fiks në krahasim me kërkesën për shërbime Internet broadband në treg, kërkesë që u plotësua nga rrjetet mobile. Me poshte jepet nje table e statistikave të përhapjes së përdoruesve të Internet Broadband ne vite.

Tabela nr. 18 – Numri i përdoruesve të internetit sipas viteve dhe popullsisë

Viti	Përdorues	Popullsia	% Pop.	Burimi i informacionit
2000	2,500	3,083,300	0.1 %	ITU
2002	30,000	3,084,586	1.0 %	ITU
2006	75,000	3,087,159	2.4 %	ITU
2007	471,200	3,087,159	15.3 %	ITU
2008	580,000	3,619,778	16.0 %	GfK
2009	750,000	3,639,453	20.6 %	ITU
2010	1,300,000	2,986,952	43.5 %	ITU
2012	1,441,928	3,011,405	48.1 %	ITU
2013	1,815,145	3,020,209	60.1 %	ITU

Tabela Nr. 19 – Statistikat e përdorimit të Internetit për vendet e Europës

Shteti	Popullsia	Përdoruesit Internet, 31-Dhjet-2013	Penetrimi (% Popullsie)	Përdorues % në Europe
Shqipëria	3,020,209	1,815,146	60.1 %	0.3 %
Andorra	85,458	80,331	94.0 %	0.0 %
Austria	8,223,062	6,629,433	80.6 %	1.2 %
Bjellorusia	9,608,058	5,204,685	54.2 %	0.9 %
Belgjika	10,449,361	8,586,240	82.2 %	1.5 %
Bosnia-Herzegovina	3,871,643	2,628,846	67.9 %	0.5 %
Bullgaria	6,924,716	3,674,254	53.1 %	0.6 %
Kroacia	4,470,534	3,167,838	70.9 %	0.6 %



<u>Qipro</u>	1,172,458	767,374	65.5%	0.1 %
<u>Czech Republic</u>	10,627,448	7,876,002	74.1 %	1.4 %
<u>Danimarka</u>	5,569,077	5,270,018	94.6 %	0.9 %
<u>Estonia</u>	1,257,921	1,006,337	80.0 %	0.2 %
<u>Ishujt Faroe</u>	49,947	44,952	90.0 %	0.0 %
<u>Finlanda</u>	5,268,799	4,821,478	91.5 %	0.9 %
<u>Franca</u>	66,259,012	55,221,000	83.3 %	9.8 %
<u>Gjermania</u>	80,996,685	69,779,160	86.2 %	12.3 %
<u>Greqia</u>	10,775,557	6,451,326	59.9 %	1.1 %
<u>Hungaria</u>	9,919,128	7,205,255	72.6 %	1.3 %
<u>Icelanda</u>	317,351	306,402	96.5 %	0.1 %
<u>Irelanda</u>	4,832,765	3,781,639	78.3 %	0.7 %
<u>Italia</u>	61,680,122	36,058,199	58.5 %	6.4 %
<u>Kosova</u>	1,859,203	1,424,149	76.6 %	0.3 %
<u>Latvia</u>	2,165,165	1,628,854	75.2 %	0.3 %
<u>Liechtenstein</u>	37,313	35,000	93.8 %	0.0 %
<u>Lituania</u>	3,505,738	2,399,678	68.5 %	0.4 %
<u>Luxembourg</u>	520,672	488,286	93.8 %	0.1 %
<u>Maqedonia</u>	2,091,719	1,280,132	61.2 %	0.2 %
<u>Malta</u>	412,655	284,361	68.9 %	0.1 %
<u>Moldovia</u>	3,583,288	1,748,645	48.8 %	0.3 %
<u>Monako</u>	30,508	27,671	90.7 %	0.0 %
<u>Mali I Zi</u>	650,036	369,220	56.8 %	0.1 %
<u>Hollanda</u>	16,877,351	15,857,959	94.0 %	2.8 %
<u>Norvegjia</u>	5,147,792	4,892,976	95.0 %	0.9 %
<u>Polonia</u>	38,346,279	24,940,902	65.0 %	4.4 %
<u>Portugalia</u>	10,813,834	6,715,390	62.1 %	1.2 %
<u>Rumania</u>	21,729,871	10,812,784	49.8 %	1.9 %

Rusia	142,470,272	87,476,747	61.4 %	15.4 %
San Marino	32,742	17,000	51.9 %	0.0 %
Serbia	7,209,764	4,107,000	57.0 %	0.7 %
Slovakia	5,492,677	4,337,868	79.0 %	0.8 %
Slllovenia	1,988,292	1,445,091	72.7 %	0.3 %
Spanja	47,737,941	35,705,960	74.8 %	6.3 %
Suedia	9,723,809	9,216,226	94.8 %	1.6 %
Zvicra	8,061,516	6,989,334	86.7 %	1.2 %
Turqia	81,619,392	37,748,969	46.3 %	6.7 %
Ukraina	44,291,413	18,513,810	41.8 %	3.3 %
Anglia	63,742,977	57,266,690	89.8 %	10.1 %
Vatican City State	842	480	57.0 %	0.0 %
TOTAL EUROPE	825,802,657	566,261,317	68.6 %	100.0 %

Burimi: <http://www.internetworldstats.com>

Nëse do të shohim në tabelën Nr.3 do të shohim se Shqipëria ka bërë hapa përpara në shërbimet broadband duke lënë pas vende të cilat kanë shumë më tepër kohë që investojnë në këto teknologji si Bullgaria, Italia, Rumania, Serbia etj. Përdorimi masiv i Internetit në Shqipëri lidhet me përdorimin e rrjeteve sociale Facebook, Twitter, LinkedIn, Google+, Instagram etj si dhe me shtimin e kontetit dixhital në këtë rrjet pasi vetem vitet e fundit janë futur një numër i konsiderueshëm shërbimesh elektronike online ku Biznesi dhe qytetarët mund të plotesojnë online formularë, mund të aplikojnë për vende pune, mund të dërgojnë dhe të marrin të dhëna financiare, mund të marrin pjesë në prokurimet online etj. Gjithashtu në dyvjetorin e fundit ka patur një zhvillim shumë të madh të shërbimeve E-Banking si dhe të aplikacioneve për mobile duke filluar nga media (gazeta, revista televizive), aplikacione për turizmin e deri tek ato që bëjnë të mundur transaksione financiare.

Përsa i përket teknologjive broadband të përdorura vendin kryesor e zënë ato mobile për shak të masivizimit të smartfone dhe tabletave por edhe për mënyrën më të lehtë të ngritjes dhe vënies në eficence të këtyrë rrjeteve. Broadband Fix përbëhet kryesisht nga shërbimet ADSL dhe VDSL që u ofron Altelecom , Abissnet, Primo Communication, Tring Communications, Nisatel etj. Shërbimet Kabëll Modem ofrohen nga kompania ABCom si dhe nga operatorët kabllorë të së thuajse të gjithë qyteteve të cilët dy vitet e fundit kanë kryer upgrade të rrjetave ekzistuese CAT-TV duke ofruar edhe

shërbime Internet. Shërbimet Internet Broadband ofrohen me anë të teknologjisë GePON nga Albtelekom, ABCom, Abissnet, Nisatel etj . Teknologji e përdorur në masë është edhe ajo Wi-Fi e cila përdoret nga operatorët Albtelekom, Abissnet, ABCom, Tring Communication etj duke krijuar pika transmetimi HotSpot Wi-Fi në zonat me dendësi të lartë popullore. Shërbimi Internet Broadband satelitor është shumë pak i përhapur, pasi ky shërbim instalohet vetëm në zonat e thella malore, aty ku nuk ka mbulim të asnjë prej rrjeteve tokësore.

Gjendja e shërbimeve Internet Broadband në “Bjeshkët e Namuna”

Zona e veriut të Shqipërisë për shkak të kushteve të zhvillimit ekonomik por edhe për shak të kushteve të terrenit, është një nga zonat më të pambuluara me shërbime Internet broadband. Pothuajse të gjithë operatorët e kanë të vështirë ofrimin e shërbimit në këto zona dhe shërbimet e tyre shkojnë deri në qendrat e mëdha të banuara. Kukësi, Kruma, Tropoja janë qytete ku ofrohen shërbime broadband kryesisht nga Albtelekom dhe operatorë alternative lokale. Përsa i përket zonave të thella si komunat Kelmend, Komuna Shkrel-Dedaj, Komuna Shalë, Komuna Margegaj, Komuna Lekbibaj – Nikal Mërtur, Komuna Tropojë e Vjetër dhe Komuna Bujan penetrimi i shërbimeve Internet broadband është në nivele shumë të ulta dhe përbehet vetem nga lidhje sporadike satelitore. Më ndryshe paraqitet gjendja për komunat Qendër Kopluk dhe Kastrat.

Në rastin e komunave të cilat ndodhen në zonën e alpeve vështirësia e furnizimit me Internet qendron në largësinë e këtyre komunave nga qendrat urbane, dendësia shumë e ulët e popullsisë në këto komuna si dhe vështirësitë teknike të instalimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së shërbimeve psh në rastin e shërbimeve satelitore që është i vetmi që mundëson lidhjen në Internet në këto zona, mirëmbajtja e shërbimit bëhet e vështirë pasi erërat e forta lëvizin parabolën satelitore, gjithashtu bora që bie gjatë dimrit prish përmasat dhe sipërfaqen e pasqyimit të antenës satelitore. Po ashtu funksionimi i shërbimit bëhet i vështirë gjatë periudhës së dimrit pasi lidhjet satelitore duke punuar në frekuenca të larta janë shumë të ndjeshme ndaj faktoreve atmosferike si mjegulla, shiu apo bora. Paraprakisht duhet të ekzistojë një lidhje broadband e qendrueshme në mënyre që të funksionojnë edhe aplikacionet që ngrihen mbi Internet që nga shërbimit Wi-Fi HotSpot për turistet, publikimi dhe update i faqeve Internet të hoteleve, Bizneseve dhe institucioneve të zonës. Edhe Shërbimet broadband mobile janë vështirë për të penetruar në këto zona për shkak të largësisë së kullave me antenat transmetuese GPRS apo 3G por edhe relievi shumë i thyer pengon përhapjen e valëve të kompanive mobile.

Propozimi i zgjidhjes teknike

Zgjidhja teknike momentale për të siguruar një shërbim të vazhdueshëm dhe të sigurtë lidhet me bashkësinë e institucioneve në një hapësirë me sipërfaqe sa më të vogël, që do të thotë se nëse në qendrën e komunes janë të vendosura Këshilli i komunës, shkolla 9-vjeçare apo e mesme, qendra shëndetësore, zyra e informacionit turistik, gjendja civile apo edhe ndonjë zyrë tjetër shtetërore atëherë zgjidhja teknike që propozohet është një zgjidhje globale për të gjithë këta përdorues.


Marrja e shërbimit Internet në këto zona mund të kryhet nëpërmjet shërbimeve 3G ose nëpërmjet shërbimit satelitor. Shërbimet 3G kërkojnë ngritjen dhe instalimin e kullave të transmetimit për të mbuluar këto zona. Trafiku i ulët telefonik momental nuk e justifikon mos investimin pasi këtu duhet të llogaritet edhe vlera e trafikut roaming që gjenerojnë turistët dhe që për momentin nuk mund të gjenerohet pasi sinjali 3G është shumë i dobët me përjashtim të zonës së Thethit dhe disa pjesëve të luginës së Valbonës.

Ajo që dotë përbëntë një risi në rastin propozimet e këtij studimi do të ishte ndertimi i një aplikacioni për mobile i cili të punojë offline dmth që të mos këtë nevojë të lidhet në Internet, dhe të ketë një databazë të të gjithë burimeve turistike të komunave të marra në studim. Me anë të këtij aplikacioni të gjendet vendodhja me anë të sinjalit GPS dhe më pas të tregohen në hartë hotelet dhe guest house sipas distancës, pikat e shërbimeve SOS, pika furnizimi me karburant si dhe vende me atraksione. Në rastin e hoteleve dhe të guest hause aplikacioni të japë edhe detaje mbi vendin duke e shoqëruar me foto dhe me informacionin e kontaktit, kalendarin e eventeve të zonës etj. Gjithashtu ky aplikacion duhet të shërbejë edhe si guidë për mbërritjen në destinacion. Në këtë menyrë turistët sapa të lokalizojnë vendodhjen e tyre të kënë opsionet e përmendura me sipër. Ky aplikacion mund të jete nje aplikacion stand alone apo një shtesë apo modul i ndonjë aplikacioni ekzistues.

Propozime për komunën Kelmend

Komuna është komuna me veriore e republikës së Shqipërisë me një bukuri natyrore të rrallë dhe atraksion për turizmin vendas dhe të huaj. Komunikimi është baza e zhvillimit në ditët tona kështu që kërkesa për shërbime Internet broadband edhe në këtë komunë është prezente pasi do të ndihmojë në promovimin e burimeve turistike të kesaj komune por edhe në mbarëvajtjen e funksioneve të përditshme duke ndihmuar nxënësit e shkollës për të marrë informacion por edhe për tu integruar me mënyrat e reja të mesimnxënies dhe edukimit në distancë, duke ndihmuar qendrën shëndetësore për mbarëvajtjen e rrjetit telematik etj. Aktualisht ekzistojnë dy lidhje të financuara nga qeveria Shqiptare për këtë komunë që përfshin shkollat e fshatit Tamarë dhe Lepushë. Të dyja këto lidhje janë lidhje satelitore me kapacitet 6Mbps doënload dhe 2 Mbps Upload.

Ajo që rekomandohet për Komunën Kelmend në fshatin Tamarë për momentin është ndërtimi i një rrjeti të vogël WLAN i cili të lidhë të gjithë aktorët shtetërorë me njëri-tjetrin në mënyrë që shërbimi që në këtë komunë mund të merret për momentin vetëm me satelitë të jetë një lidhje me kapacitet të lartë 20Mbps. Për lidhjen satelitore duhet të merret në konsiderat që parabola të jetë me ngrohës të reflektorit për shkak të mbulimit me akull dhe borë gjatë stinës së dimrit të cilat prishin kualitetin e shërbimit. Për ndërtimin e këtij rrjeti Wireless outdoor duhet të përdoren pajisje outdoor në frekuencë 5GHz në mënyrë që të mos interferojnë me pajisjet Wi-Fi të cilat do të përdoren për akses wireless indoor. Më poshtë jepet skema logjike e funksionimit të lidhjeve për fshatin Tamarë.




Skema e ofrimit te shërbimit HotSpot

Fig.nr. 14 – Skema e lidhjes së pajisjeve në një pikë aksesi Internet Satelitor

Në Info-point në fshatin Tamarë rekomandohet të vendoset një shërbim Wi-Fi HotSpot që do të bëjë të mundur lidhjen e të gjithë turistëve por edhe të popullsisë vendase në Internet me anë të pajisjeve mobile të cilët mund të jenë Labtop, Smartphone, Tableta etj.

Përsa i përket fshatit Vermosh rekomandohet që këtu të japë impaktin e vet implementimi i këtij projekti pasi lugina e Vermoshit të lejon ngritjen e nje rrjeti Wireless përgjatë luginës duke krijuar pika aksesit në distanca të caktuara. Këtu ekziston gjithashtu mundësia e bashkëpunimit me palën malazeze për të implementuar një rrjet të tërë Wireless nga Vermoshi deri në Guci por gjithësesi furnizimi me Internet i rrjetit mund të bëhet duke u furnizuar nga qyteza Guci pasi kjo është pika më e afërt e cila siguron një lidhje tokësore duke përmirësuar kualitetin e shërbimit. Për këtë qëllim rekomandohet që lidhja e Vermoshit me Gucin të bëhet nëpërmjet dy lidhjeve pikë më pikë me pikë mes fshatit Bashkim. Linku i parë duhet të jetë në drejtimin Guci-Bashkim ndërsa link-u i dytë në drejtimin Bashkim-Vermosh. Këto linke mund të përdoren në frekuencat e lira të brezit 5GHz ose në frekuencat e licensuara të brezit 13GHz por në këtë rast kostoja do të ishte shumë e lartë prandaj rekomandohet përdorimi i zgjidhjes së parë dhe me rritjen e kërkesës për kapacitet atëherë të kalohet në lidhjet pikë më pikë në frekuencë të licensuar. Kapaciteti i të dy linkeve duhet të jetë minimumi 30Mbps në download dhe 10Mbps në upload. Gjithashtu standarti i pajisjeve që do të përdoren duhet të jetë i lartë pasi bëhet fjalë që këto pajisje do të punojnë në kushte ekstreme të motit. Në pikën Bashkim rekomandohet vendosja e një transmetuesi AP Outdoor në frekuencën 2.4GHz dhe me një antenë të drejtuar për nga lugina e Vermoshit në mënyrë që të lidhen pajisjet kliente Wi-Fi përgjatë luginës së Vermoshit. Në fshatin Vermosh gjithashtu duhet që link-u të mbarojë në një pajisje Switch ku duhet të lidhen dy pajisje AP outdoor me drejtime të kundërta të cilat të mbulojnë me shërbim luginën e Vermoshit. Më poshtë jepet një hartë që tregon shtrirjen dhe relievin e komunës Kelmend.

Pajisjet kliente të cilat do të instalohen në Guest House , Hotele apo biznese të vogla do të jenë përsëri pajisje me cilësi të lartë pasi siç u theksua do të punojnë në kushte ekstreme të motit. Këto pajisje do të lidhen me një SOHO Wireless router/AP për lidhjen e përdoruesve me Wi-Fi ose kabëll. Edhe në pikën e ndërmjetme në fshatin Bashkim të dy linket do të lidhen në një pajisje Switch ku do të lidhet një SOHO/Router. Autentifikimi i përdoruesve mund të lihet i lirë pasi nuk ka probleme me abuzimin me Internetin por mund të aktivizohet edhe autentifikimi nëpërmjet sigurisë së vetë AP por edhe duke aktivizuar një sistem HotSpot. Përsa i përket marrjes së shërbimit do të rekomandohej që çdo pajisje klient SOHO të konfigurohet me IP reale dhe kjo pajisje të kryente dhe NAT. Për manaxhimin e rrjetit Radio Valë do të duhej që të kryhej nëpërmjet një klase IP private të caktuara dhe të rrugëzuara nga provideri ku do të merret Internet në mënyrë që të kryhet remote kontrolli dhe konfigurimi i tyre. Me poshtë jepet një skemë logjike e funksionimit të rrjetit përgjatë luginës së Vermoshit.



Skema e ofrimit te sherbimit ne luginen e Vermoshit

Fig.nr. 15 – Skema logjike e rrjetit Wireless në luginën e Vermoshit nëpërmjet Gucie

Në rastin e mos sigurimit të një lidhjeje Internet nga provider me linjë tokësore nga Gucie atëherë skema do të shkurtrohet me segmentin Gucie-Bashkim dhe në fshatin Vermosh do të duhet që shërbimi i Internet të merret me lidhje satelitore por kapaciteti duhet të jetë në rangun e 20Mbps i cili më pas të shpërndahet me anë të rrjetit Wireless në luginën e Vermoshit sipas skemës se fig. nr. 16. Reflektori i antenës satelitore në këtë rast do të duhet jo në diameter 90-110 cm sa janë parabolat klasike por do të duhej me diametër 1.8 m për të patur marrje-dhënie të mire të sinjalit edhe në ditët problematike të vjeshtës dhe dimrit. Reflektori duhet të jetë i pajisur gjithashtu me ngrohësin për shkrirjen e bores dhe akullit.




Fig. Nr. 16 – Skema logjike e lidhjes satelitore të rrjetit në luginën e Vermoshit

Për mirëfunktionimin e këtij rrjeti shpërndarës duhet që pajisjet e nyjave kryesore të jenë funksionale 24/7/365 kështu që për të siguruar këto funksionë duhen edhe burime të sigurisë së ushqimit dhe në rastin tonë këshillohet përdorimi i sistemit Inverter dhe jo UPS ku tensioni i baterise te jetë 12 V DC ndersa kapaciteti jo më i vogel se 100 Ah. Përdorimi i sistemeve të burimeve të energjisë duke u bazuar ne panele diellore do të ishte i padobishëm për shkak të numrit të pakët të ditëve me diell si dhe të mbulimit me borë gjatë stinës së gjatë të dimrit.

Propozime për komunën Kastrat

Komuna Kastrat hyn tek komunat që kanë përdorimi të lartë të shërbimeve Internet nga komunat e marra në studim për faktin që një sipërfaqe e konsiderueshme e kësaj komune mbulohe me shërbim 3G nga operatorët mobile si dhe nga operatorë alternativeë të shërbimit telefonik dhe atij Internet. Në mënyrë që të kemi balancim në marrjen e shërbimit që është edhe një nga qëllimet e këtij studimi do të ishte e favorshme që të ofrohej Shërbimi Internet në shkollën Vukpalaj me lidhje tokësore nga operatorët alternativeë ose Albbelekom si dhe të krijohet mundësia e shpërndarjes së Internet në laboratorin kompjuterik të shkollës. Gjithashtu instalimi i shërbimit të internetit do të krijojë

mundësinë e instalimit edhe të pajisjeve AP të cilat do të shërbejnë për lidhjen e përdoruesve mobile nëpërmjet Wi-Fi. Skema e përdorur në këtë rast duhet të jetë ajo e Fig. nr. 14 për lidhjen satelitore.

Gjithashtu një lidhje internet Satelitore me skemë shpërndarje të njëjtë rekomandohet edhe në fshatin Rrapshë pasi në këtë mënyrë do të krijohet një vijueshmeri e lidhjeve Internet gjatë rrugës Shkodër – Vermosh .

Propozime për komunën Qendër Koplík

Nga verifikimet e gjendjes në terren del se komuna Koplík është komuna me përhapjen më masive të Internet broadband dhe aplikacioneve të TIK në komunat e marra në studim. Operatorët Mobile dhe Fiks si dhe ata alternativë janë të pranishëm masivisht në këtë komunë prandaj synimi është balancimi i përdorimit të burimeve TIK në të gjitha komunat e veriut të Shqipërisë dhe sidomos për Zonën e “Bjeshkeve të Namuna” ku edhe është përqëndruar ky Studim fizibiliteti.

Propozime për komunën Shkrel-Dedaj

Komuna Shkrel-Dedaj ndodhet gjithashtu në një prej zonave më malore të vendit ku aksesimi në Internet dhe rrjedhimisht në facilitetet që të ofron ky rrjet është i mangët. Shërbimet broadband në këtë zonë aksesohen vetëm nëpërmjet lidhjeve satelitore pasi relievi i thyer dhe largësia e objekteve pengon në shtrirjen e një rrjeti funksional. Për këtë zonë rekomandohet që të kryhet një upgrade i lidhjes ekzistuese lidhje Internet satelitore që ndodhet në zyrën e informacionit turistik dhe këtu të implementohet një rrjet hybrid Wireless dhe kabëll Ethernet duke lidhur Qendrën shëndetësore për të ndikuar që nëpërmjet kësaj lidhje të aksesohet rrjeti telematik shëndetësor, zyrat e komunës etj.

Skema e lidhjes së pajisjeve në komunën Shkrel-Dedaj duhet të realizohet sipas Fig. nr. 14 por edhe këtu duhet të kihet parasysh kualiteti i pajisjeve satelitore dhe atyre Wireless AP. Përsa i përket Internet Broadband në Zonën e Razmës dhe të Bogës në hotelet që ndodhen në këto zona turistike, kjo është zgjidhur privatisht nga vetë investitorët e këtyre hoteleve.

Propozime për komunat Markgegaj, Lekbibaj, Bujan dhe Tropojë e Vjetër.

Në komunën Markgegaj ndodhet dhe parku kombëtar i Valbonës i cili kohët e fundit është shndërruar në një nga destinacionet turistike më të frekuentuara nga turistët vendas dhe ata të huaj. Relievi i kësaj komune është tepër i thyer dhe për pasojë përhapja e shërbimeve broadband është tej mase i vështirë. Edhe shërbimet 3G të cilat mund të rrisin probabilitetin e penetrimit të shërbimeve broadband janë të limituara ose nuk ekzistojnë. Në këto kushte për momentin e vetmja zgjidhje që mund të ofrohet është me lidhje Broadband satelitore. Duke qënë se Projekti PAP2 ka ndërprerë lidhjen satelitore për komunën, rekomandohet që të mundësohet lidhja e qendrës së komunës me këtë tip lidhje por duke patur një provider tjetër nga ai ekzistues për shkak të problematikës me

lidhjen ekzistuese. Rekomandohet një lidhje satelitore me skemë sipas fig nr.7 edhe për qendrën e informacionit turistik të Parkut të luginës së Valbonës si dhe ofrimi i Shërbimit HotSpot Wi-Fi në ambjentet e kësaj qendre.

Komunat Lekbibaj-Nikaj Mërtur dhe ajo Bujan për momentin nuk rezultojnë në destinacionet turistike por që kanë potencial të madh për tu përfshirë në këto guida. Edhe në këto komuna për shkak të terrenit tepër të thyer shërbimet Internet Broadband janë të kufizuara duke u mbështetur vetëm në lidhjet satelitore si dhe në ndonjë lidhje ilegale të realizuar nëpërmjet operatorit kosovar IPKO pasi ky operator nuk zotëron autorizim nga AKEP për ofrim shërbimi ne ndonjë pjesë të territorit të republikës së Shqipërisë. Ndihma që do të mund të jepej në këto dy komuna për përhapjen e shërbimeve broadmand është lidhja e qendrës së komunës Lekbibaj si dhe Qendrës shëndetësore në komunën Bujan.

Ndërkohë Komuna Tropojë e vjetër është një prej komunave me numrin më të madh të banorëve por me shpërdarje të madhe demografike. Zonat turistike në këtë komunë ndodhen në pjesën e alpeve dhe për pasojë mbulimi me shërbim Internet Broadband është i dobët si dhe duke qenë që akoma në këtë komunë nuk është zhvilluar turizmi malor është e papërshtatshme për momentin gjetja e një zgjidhje teknike për të mbuluar me shërbim Internet broadband këto zona. Në rastin më të mirë të hapjes së ndonje hoteli apo guest hause zgjidhja më e përshtatshme do të ishte një lidhje satelitore. Gjithsesi rekomandohet që për këtë komunë të instalohet përsëri një lidhje Internet Satelitore e cila të jetë një lidhje e përbashkët me të cilën të funizohen edhe zyrat e komunës por edhe Qendra Shëndetësore duke ndihmuar që kjo qendër të bëhet pjesë e rrjetit telematik shëndetësor. Skema e lidhjes së pajisjeve dhe në këtë rast duhet të realizohet sipas fig .nr.7.

Rekomandime Strategjike për të ardhmen

Në rekomandimet strategjike për të ardhmen bën pjesë një grup masash të cilat mund të ndërmerren nga pushteti qendror, pushteti lokal, operatorët OFTN, entet dhe agjensitë të cilat merren me administrimin dhe rregullimin e tregut të telekomunikacioneve.

Shërbimet Internet Broadband të cilat janë më të lehta për tu implementuar në një hark kohor të shkurtër, janë ato Internet broadband mobile 3G dhe LTE ose e branduar si 4G. Implementimi i rrjeteve “Fikse” në këto zona gjithmonë do të ishte një investim pa leverdi. Në këtë moment kur operatorët mobile Vodafone, AMC dhe EAGLE të cilët ofrojnë shërbime Internet Broadband 3G dhe së shpejti edhe operatori Plus duhet të informohen nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit nëpërmjet MIAP për shifrat e numrit të turistëve të cilët vizitojnë këto zona dhe sidomos të huajt të cilët do të përdorin shërbimet roaming në këto zona. Kjo do t'i “joshte” këta operatorë të kryenin investime në infrastrukturë duke vendosur antena dhe transmetues për mbulimin e këtyre zonave me sinjal 3G. Kjo duhet të shërbeje si hap i parë por në rast të leverdisë së ulët të

investimeve për mbulimin e disa prej këtyre zonave që u morën në studim AKEP duhet të ndërhyjë për zbatimin e DSHU (Detyrimit të shërbimit Universal) e cila aktualisht është në proces konsultimi por nëse transpozohet dhe zbatohet direktiva e KE nr 2002/21/EC atëherë ky shërbim është një detyrim për të gjithë operatorët OFTN.

Zgjidhje tjetër por e cila do të kërkojë të paktën edhe 2-3 vjet kohë është ofrimi i shërbimeve 4G nga operatorët aktualë. E veçanta e shërbimeve 4G është që duke operuar në frekuencë më të ulët se ajo 3G do të kënë mundësi penetrimi shumë më të madhe në terrenet malore dhe të thyera se ato 3G. Ritheksojmë se shërbimet 3G operojnë në brezin 2.1GHz ndërsa shërbimet 4G do të jenë operuese në brezin 800MHz. Duke u nisur nga ky interes por edhe në faktin së 2/3 e sipërfaqes së Republikës së Shqipërisë janë terren kodrinor dhe malor atëherë mund të themi se kalimi nga gjenerata e tretë e telefonisë Mobile në gjeneratën e katërt do të rriste gjurmën e mbulimit me shërbime broadband në të gjithë territorin dhe për pasojë do të rritej numri i përdoruesve të shërbimeve broadband. Prandaj del si detyrë e institucioneve të Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike dhe AKEP që të planifikojnë shpejt dhënien e licencave 4G. Rritja e penetrimit të shërbimeve broadband gjithmonë është e shoqëruar me rritjen e përmbajtjes së shërbimeve dhe zhvillon ekosistemin e TIK në të gjithë vendin dhe për pasojë ka ndikim direkt në prodhimin e përgjithshëm kombëtar.

Fund Kapitulli III

KAPITULLI IV

“Financimi i Internet Broadband në Bjeshkët e Namuna”

Hyrje

Përdorimi i internetit ka pësuar një rritje të jashtëzakonëshme gjatë viteve të fundit në Shqipëri, duke e kthyer atë në një mjet të pazëvendësueshëm për marrjen e informacionit, komunikimin dhe përdorimin e teknologjisë. Falë ritmeve të shpejta të rritjes së tregut vendas, që për segmente të caktuara ka arritur nivelet europiane, interneti ka ndihmuar njëkohësisht në zhvillimin e biznesit vendas, si nëpërmjet zhvillimit të tregut përmes një numri të konsiderueshëm operatorësh, ashtu dhe më tepër, nëpërmjet mundësive të pafundme që interneti u ofron bizneseve vendase për të kërkuar tregje, ndërtuar bashkëpunime me botën dhe zhvilluar tregtinë.

Për shkak të kushteve specifike natyrore të vendit, ky zhvillim nuk është i njëtrajtshëm në të gjithë Shqipërinë. Terreni i vështirë e malor në një pjesë të mirë të vendit, shoqëruar me një dendësi më të ulët të popullsisë dhe nivel të pabarabartë të zhvillimit ekonomik dhe social në këto zona, kanë ndikuar së tepërmi në përqendrimin e aktivitetit të shërbimit internet broadband kryesisht në zonat e mëdha urbane të vendit, duke i lënë praktikisht të izoluar nga ky shërbim mjaft zona të thella.

Zona e ‘Bjeshkëve të Namuna’ që është objekt i këtij studimi, përfshihet në këtë kategori gjerësisht të privuar nga përdorimi i internetit broadband. Ndonëse zona ofron bukuri natyrore të pamasa, që kanë ndihmuar në zhvillimin gjatë viteve të fundit të një turizmi të vecantë dhe në rritje, interneti ende nuk është fuqimisht në shërbim të këtij sektori dhe tregohet si një ndër problemet që turistët hasin në këtë zonë.

Qëllimi i studimit “Financimi i Internet Broadband në Bjeshkët e Namuna” i kryer në kuadër të projektit “Promovimi i Lidhjes Broadband në Bjeshkët e Namuna” financuar nga BE, Programi IPA CBC Shqipëri Mal i Zi, është të kryejë një analizë të faktorëve specifike që ndikojnë në këtë gjendje dhe të atyre që mund të ndihmojnë drejt zgjidhjes së qëndrueshme të tij, duke trajtuar të gjithë elementët përkatës të tregut. Kështu, studimi trajton në mënyrë sintetike karakteristikat specifike të kërkesës për shërbim që ekziston në zonë, burimet e pranishme në të, rolin e shtetit, zhvillimin e industrive përkatëse, dhe elemente të kostos dhe cmimit të shërbimit të internetit broadband.

Po kështu, studimi pa hyrë në aspektet teknike të zgjidhjeve që kanë qenë objekt i punës së studimeve të mëparëshme, parashtron format e mundshme të promovimit të këtij shërbimi, duke

vlerësuar rolin e shtetit në të gjitha dimensionet që mund të rezultojnë të dobishme në këtë drejtim, në bashkëpunim me faktorët e tjerë të rëndësishëm të zhvillimit, përfshirë bizneset vendase operatorë në tregun e internetit, donatorët e huaj apo vendet fqinje.

Studimi përfshin rekomandime që synojnë të ndihmojnë në zgjidhjen e problemit të ofrimit të internetit broadband në zonën e ‘Bjeshkëve të Namuna’, duke patur parasysh qëndrueshmërinë e zgjidhjeve në kohë, maksimizimin e sinergjive pozitive të bashkëpunimit dhe shmangien e efekteve negative të mundshme në tregun e këtij shërbimi në vend.

1. Analizë e tregut të shërbimit internet broadband në zonën “Bjeshkët e Namuna”

Studimi "Financimi i Internet Broadband në Bjeshkët e Namuna" realizuar në kuadër të projektit "*Promovimi i Lidhjes me Internet Broadband në Bjeshkët e Namuna*" identifikon në mënyrë të hollësishme gjendjen ekzistuese të ofrimit të shërbimit të internetit broadband në zonën nën studim. Referuar gjatjeve të studimit, rezulton se përgjithësisht e tërë zona karakterizohet prej mungesës së pranisë së shërbimit cilësor të internetit broadband, vlerësuar në një masë të krahasueshme me ofrimin e shërbimit në zonat e tjera të Shqipërisë, të tillë që do të mundësonte një përdorim të përshtatshëm të të gjithë shërbimeve bazë të internetit nga përdoruesit që jetojnë ose vizitojnë zonën e studimit.

1.1 Sfondi për konkurrencën dhe strategjitë e biznesit në zonën “Bjeshkët e Namuna”

Shqipëria paraqet një treg me zhvillim të shpejtë të shërbimit internet broadband dhe të shërbimeve të tjera të lidhura me të. Sipas të dhënave nga qendra studimore ndërkombëtare, penetrimi i internetit në Shqipëri në fund të vitit 2013 ka arritur në 60.1%, shifër kjo paksa më ulët se mesatarja Europiane që për të njëjtën kohë ishte 68.6% (<http://www.internetworldstats.com>), por duke qenë si tregues më i lartë se shumë vende të rajonit, e madje dhe të atyre anëtare të Bashkimit Europian.

Përdorimi i internetit në Shqipëri është shoqëruar me rritjen e aktivitetit dhe numrit të kompanive që operojnë në tregun e ofrimit të këtij shërbimi. Ndërkohë që kompania e telefonisë fikse Albtelekom zë pozitë dominante në tregun e linjave fikse brenda vendit si dhe në lidhjen e Shqipërisë me linjat ndërkombëtare të transmetimit të informacionit, një sërë operatorësh privatë kanë lulëzuar në tregun e shërbimit të internetit duke realizuar investime të rëndësishme në ndërtimin e rrjeteve dytësore, shtrirjen e lidhjeve optike ndërrurbane e ndërkombëtare dhe ofrimin e internetit me çmime gjithnjë e më konkurruese në tregun vendas. Shumica e operatorëve të tillë ofrojnë në treg krahas shërbimit të internetit, edhe zgjidhje inovative për klientët, duke filluar që nga ndërtimi/hostimi i faqeve të internetit e deri në telefoni apo televizion bazuar në internet. Vlerësohet se rreth 130 operatorë

privatë në shkallë vendi janë të autorizuar nga AKEP për të ofruar shërbimin e internetit. Veçoritë e Shqipërisë, krahasuar me vendet e tjera të Europës janë të dallueshme. Së pari, përdorimi i internetit ka pësuar një rritje të konsiderueshme veçanërisht përgjatë viteve të fundit (në vitin 2000 penetrimi ishte vetëm 0.1%) e kryesisht përmes përdorimit të rrjeteve të telekomunikacionit mobil 2G dhe 3G. Së dyti, ndërkohë që zhvillimi i rrjeteve të telekomunikacionit mobil ka ndihmuar ndjeshëm në rritjen e nivelit të penetritimit të përdoruesve të internetit, shtrirja e rrjetit broadband fiks përmes fibrave optike e linjave të komunikimit, është ende e ulët krahasuar me shumë vende të tjera. Së treti, për shkak të karakteristikave e kontrasteve të terrenit, por edhe të nivelit të zhvillimit e përqëndrimit të popullsisë, Shqipëria ka një polarizim të theksuar hapësinor në përdorimin e internetit, si pasojë e përqëndrimit të përdoruesve kryesisht në zonat e mëdha urbane. Veçanërisht faktori i fundit, është tepër i rëndësishëm për objektivin e këtij studimi.

Zona e përfshirë në studim, “Bjeshkët e Namuna”, mund të konsiderohet në vija të përgjithshme në mos e privuar, ende tërësisht e izoluar nga zhvillimi i shpejtë i shërbimit të internetit broadband në të gjitha zonat urbane të Shqipërisë. Në këtë mënyrë, mungesa e lidhjes së sigurt e të qëndrueshme e internetit për këtë zonë, përforcon për fat të keq edhe më tej izolimin ekonomik dhe social të saj nga ekonomia kombëtare, ndërkohë që shërbimet me vlerë të shtuar bazuar në zgjidhjet përmes internetit janë kthyer në një faktor të rëndësishëm të punësimit, zhvillimit të biznesit, investimeve të huaja dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve në të gjithë Shqipërinë. Padyshim, një pozitë e tillë e disfavorshme në treg justifikon nevojën për ndërhyrje korrektuese, të cilat duhet të synojnë efikasitetin më optimal të mundshëm dhe minimizimin e efekteve dëmtoese në treg.

Shtrirja e gjerë e zonës në një hapësirë relativisht të konsiderueshme gjeografike ka krijuar kushtet për ofrimin e kufizuar të shërbimit të internetit përmes zgjidhjeve më të përshtatshme lokale, por jo sipas një mënyre uniforme në krejt zonën, gjë që pasqyrohet në larminë e mënyrave të ofrimit e përdorimit të internetit në komuna apo fshatra të ndryshme të kësaj zone sipas formës më praktike që mundëson këtë shërbim. Për pasojë, në zonën nën shqyrtim janë të pranishëm në një masë tepër të kufizuar një pjesë e mirë e operatorëve kombëtarë dhe veçanërisht ata të shërbimeve telefonike mobile që ofrojnë në zonat e kufizuara të mbulimit internet 2G, por praktikisht asnjë prej operatorëve nuk mbulon në mënyrë të plotë apo të kënaqshme të gjithë zonën me shërbim internet broadband.

Studimi “Përgatitja e listës së operatorëve dhe ofruesve të internetit broadband në zonën e përzgjedhur, vlerësimi i kuadrit ekzistues ligjor dhe i dokumenteve politike shoqëruar me sugjerime për përmirësimin e tyre, evidentimi i sinergjive të përdorimit të internet broadband për rritjen e bashkëpunimit ndërkufitar në shkëmbimet e vizitorëve/turistëve si dhe në rritjen e shkëmbimeve tregëtare”, realizuar në kuadër të këtij projekti, vlerëson se rreth 22 operatorë kombëtarë dhe lokalë ushtrojnë aktivitetin e tyre të ofrimit të internetit në zonën e projektit.

Mungesa e një kërkesë të strukturuar tregu që do të justifikonte zhvillimin gradual e të plotë të ofrimit të internetit broadband në këtë zonë, kryesisht për shkak të faktorëve natyrorë (shpërndarjes së popullatës, izolimit, terrenit të thyer, klimës etj), ka sjellë për pasojë edhe një situatë të paqartë dhe në vizionet afatmesme të operatorëve të internetit, pra në krahun e ofertës në treg, e cila dëshmon për hezitime në kryerjen e investimeve të nevojshme për përhapjen e shërbimit të internetit broadband, gjë që paraqet njëkohësisht edhe problemin kryesor për shtrirjen e këtij shërbimi në të ardhmen brenda zonës së studimit.

Nga këndvështrimi strategjik, asnjë nga ofruesit e shërbimit të internetit broadband në Shqipëri nuk ka paraqitur ndonjë plan të përpunuar që synon një hyrje agresive apo dhe graduale në zonën e përfshirë në studim. Një pozitë e tillë ndikohet jo vetëm prej natyrës së kërkesës në tregun e zonës dhe vecoritë negative natyrore të saj, por njëkohësisht edhe prej përqëndrimit të strategjisë së biznesit dhe investimeve përkatëse në zonat e tjera të Shqipërisë që paraqesin mundësi dhe të ardhura më të larta për njësi investimi.

Një tjetër faktor i rëndësishëm që ndikon në zhvendosjen e vëmendjes së operatorëve të shërbimit internet broadband prej investimeve në zona pa shumë interes komercial, si “Bjeshkët e Namuna”, lidhet me përparimin e shpejtë të teknologjisë dhe ciklin gjithnjë e më të shkurtër të produkteve në teknologjinë e informacionit, gjë që natyrshëm kërkon dhe përqëndrimin e investimeve nga operatorët e tregut pikërisht në këto zhvillime, aty ku dhe kërkesa nga tregu është më e lartë për shërbime të tilla. Zhvillimi i vrullshëm i shërbimeve të internetit në Shqipëri, kryesisht në zonat e mëdha urbane është arritur pikërisht në sajë të investimeve të konsiderueshme që kompanitë pjesëmarrëse në tregun kombëtar kanë kryer dhe vazhdojnë të kryejnë për të sjellë në kohë reale produktet më cilësore që ofrohen në të njëjtën kohë në tregun botëror.

Nga ana tjetër, hapja e tregut të shërbimeve të telekomunikacionit, përfshirë atë të ofrimit të internetit broadband, ka ndikuar në rritjen e konkurrencës në shkallë kombëtare, gjë që sërish i shtyn operatorët t’i përgjigjen në strategji e investime njeri tjetrit dhe të përdorin vazhdimisht e më shumë teknologjitë më të përparuara në treg. Gjithsesi, sikurse tregohet më pas në këtë studim, shteti shqiptar, në cilësinë e rregullatorit të tregut dhe në një masë më të vogël, si pjesëmarrës në këtë treg, ka mundësi, edhe pse të kufizuara, për të orientuar, stimuluar dhe mbështetur fokusin e investimeve në shërbimin e internetit broadband edhe në këtë zonë.

Kërkesa e dobët që buron nga tregu i kufizuar në zonë, rezulton përgjithësisht edhe në një mbizotërim të rregullit të avantazhit të ofruesit më të parë në treg, i cili pasyrohet në mungesën e plotë të konkurrencës, ose tek-tuk të pranisë së një konkurrence të zbehtë në tregun lokal të zonës, kryesisht për shkak se të gjithë përdoruesit e përqëndruar në një fshat apo komunë të zonës, mjaftohen me marrjen e shërbimit të internetit nga ofruesi më i pare, ndaj nuk ka praktikisht

hapësira të mjaftueshme për zhvillimin dhe promovimin e një konkurrence të shëndetshme që sjell cilësi, zgjidhje të reja apo edhe çmime më të mira.

1.2 Tiparet e kërkesës së tregut në zonën “Bjeshkët e Namuna”

Analiza e strukturës së kërkesës për shërbime interneti broadband në zonën “Bjeshkët e Namuna” nevojitet për të kuptuar aktorët kryesorë që ndikojnë në ekzistencën megjithëse të kufizuar të kërkesës për këtë shërbim në zonë. Një vlerësim i kujdesshëm i tregut aktual tregon se segmentet e mëposhtëm përbëjnë dërrmuese të përdoruesve aktualë dhe potencialë në zonë:

Turistët që vizitojnë zonën.

Kërkesa për shërbime interneti broadband në zonën “Bjeshkët e Namuna”, merr trajtë në varësi të ecurisë së sektorit më pranë këtij shërbimi – turizmit malor, e për rrjedhojë ajo është ende e ulët, ndonëse në zhvillim e sipër. Ajo karakterizohet nga ndryshime sezonale pasi në periudha të caktuara të vitit (si psh. periudha e dimrit) kërkesa nga ky grup përdoruesish thuhet se pushon së ekzistuari.

Studimet e mëparëshme kanë identifikuar numrin dhe vendndodhjen e hoteleve dhe bujtinave në zonën e projektit, gjë që mundëson dhe përlogaritjen e numrit të përdoruesve të internetit në zonë sipas periudhave të ndryshme të vitit. Duke patur parasysh që pjesa më e mirë e përdoruesve të këtij grupi janë turistë shqiptarë apo të huaj, nevojat e tyre për shërbimin broadband do t'i përgjigjen kërkesës normale të të njëjtëve përdorues në zonat urbane, me një masë edhe më të lartë komunikimi përmes shërbimeve VoIP që munësojnë lidhjen me të afërmit e tyre dhe shkëmbimin e mbresave të përfutuara nga vizita në zonë.

Natyra e kërkesës së këtij grupi përdoruesish është sezonale, e shkurtër për çdo përdorues (kufizuar gjatë kohës së vizitës) dhe njëkohësisht ky grup përbën njëkohësisht klientët më pak të ndjeshëm ndaj çmimit të shërbimit, sikurse dhe gjeneruesin kryesor të të ardhurave nga shërbimi internet broadband në zonën “Bjeshkët e Namuna”.

Bizneset lokale.

Një numër i konsiderueshëm hotelesh të vogla dhe bujtinash mikëpritëse tradicionale të veriut të Shqipërisë përbëjnë bërthamën e aktivitetit të organizuar ekonomik në zonën e “Bjeshkëve të Namuna”. Zhvillimi i këtij sektori me ritme të shpejta gjatë viteve të fundit, shoqëruar me përmirësimin e infrastrukturës së transportit drejt kësaj zone, i ka dhënë shtysë investimeve për zgjerimin e rrjetit të turizmit malor dhe ofrimit të shërbimeve të lidhur me të.

Ndër shërbimet që të gjithë operatorët turistikë apo të aventurës në zonat malore dësherojnë të ofrojnë për klientët e tyre, interneti broadband padyshim konsiderohet si ndër më të rëndësishmit.

Për këtë arsye, një pjesë jo e vogël e këtyre operatorëve kanë gjetur zgjidhje sipas rastit për të mundësuar shërbimin e internetit, kryesisht me ËiFi në zonë të vogël mbulimi për ambientet e tyre. Sikurse u përmend më lart, cilësia e komunikimit lë shumë për të dëshëruar krahasuar me standartet e krahinave të tjera të Shqipërisë, dhe zgjidhjet teknike të adoptuara janë të ndryshme në varësi të kushteve të çdo operatori.

Veçanërisht në zonat e izoluara ku dhe mbulimi me rrjet mobil është i vështirë, shërbimi i internetit mund të funksionojë për këta operatorë si mjeti më efikas i komunikimit me botën. Gjithashtu, prania e shërbimit të internetit në ambientet e tyre, ndikon në promovimin e përdorimit të internetit edhe nga banorët vendas në afërsi të çdo operatori.

Brenda të njëjtit grup përdoruesish mund të përfshijmë dhe bizneset e sektorëve të tjerë të ekonomisë (përpunim bujqësie/blegtorie etj.) megjithëse numri i tyre në zonë është praktikisht i papërfillshëm dhe nevoja për përdorim interneti, mjaft më e reduktuar. Në mënyrë të ngjashme, në këtë grup përfshijmë edhe shpërndarësit ose ofruesit e vegjël të internetit, të cilët u ofrojnë banorëve ose turistëve internet përmes pajisjeve që disponojnë për këtë qëllim.

Së fundmi, këta operatorë, përdorin shërbimin e internetit për të promovuar shërbimet e tyre online, përmes faqeve të tyre në web ose nëpërmjet faqeve që ofrojnë informacion mbi turizmin malor, apo përmes aplikacioneve për telefona mobile, përfshirë hartat për vendndodhjen e tyre, gjë që kërkon një lidhje të vazhdueshme të tyre me internetin.

Natyra e kërkesës së këtij grupi përdoruesish është relativisht e qëndrueshme, me theks në sigurimin e vazhdueshëm të ofrimit të internetit, dhe me kërkesë në rritje për cilësi dhe shërbime shtesë në të ardhmen (IPTV etj.). Përdoruesit e këtij grupi janë më të vëmendshëm ndaj kostos së shërbimit por duke e konsideruar atë më pak të rëndësishme se cilësia e ofrimit të tij. Pjesa dërrmuese e këtyre përdoruesve nuk e konsiderojnë si problematike koston e internetit me çmimet mesatare në shkallë vendi dhe do të preferonin të paguanin atë për t'ju ofruar klientëve të tyre.

Banorët e zonës.

Popullsia lokale që banon në zonën “Bjeshkët e Namuna” përbën gjithashtu një grupim të rëndësishëm përdoruesish potencialë që mund të përfitojnë nga shërbimi i internetit broadband. Për shkak të izolimit dhe nivelit të zhvillimit relativ ndaj pjesës tjetër të Shqipërisë, sikurse dhe mungesës së internetit në zonë, përdorimi i internetit ende nuk është masivizuar në këtë pjesë të vendit, por padyshim rritja e mbulimit me internet do të ndihmojë në përdorimin e këtij shërbimi edhe nga banorët lokalë.

Pjesa më e madhe e përdoruesve lokalë të internetit e përdorin atë për të komunikuar përmes komunikimit audio ose video (VoIP, Skype) me të afërmit e tyre që banojnë ose kanë emigruar jashtë

shtetit, fenomen ky masivisht i përhapur në zonën e “Bjeshkëve të Namuna”. Veçmas nevojës për komunikim audio dhe video, interneti kërkohet në një masë më të vogël nga banorët e zonës për përdorimet standarte të tij (email, broësing, etj.).

Natyra e kërkesës së këtij grupi përdoruesish është sporadike dhe relativisht e ulët. Përdoruesit e këtij grupi janë përgjithsisht sensitivë ndaj çmimit të shërbimit dhe indiferentë kundrejt aspekteve të tjera teknike apo cilësore të tij.

Shërbimet publike.

Grupi i fundit por jo pak i rëndësishëm i përdoruesve të shërbimit internet broadband në zonën “Bjeshkët e Namuna”, përfshin institucionet dhe shërbimet publike, siç janë shkollat, qendrat shëndetësore, policia, ushtria, zyrat e komunave, shërbimi postar etj. Megjithëse prania e këtyre institucioneve në zonë është sërish e kufizuar për të njëjtat shkaqe të trajtuara më sipër, avantazhi parësor që ato paraqesin, lidhet jo dhe aq me njohjen e përdorimit të internetit nga banorët e sidomos të rinjtë e kësaj zone, se sa me faktin që në kuadër të modernizimit të administratës dhe institucioneve publike, shteti shqiptar i ka dhënë përparësi përdorimit të teknologjive të IT dhe internetit në të gjitha institucionet e tij, e për rrjedhojë, vala shtrirjes së internetit në të gjithë hallkat e administratës, përfshirë shkollat, ka arritur ose do të mbërrijë edhe në ato që ndodhen në zonën e projektit.

Në këtë mënyrë, përhapja e përdorimit të internetit në institucionet publike përmes formave jo-tërësisht komerciale por më tepër si një e mirë publike, përmes efekteve të rrjetit dhe krijimit të kërkesës në treg, ndihmon në zhvillimin e të gjithë hallkave të duhura për fuqizimin mbi baza komerciale të këtij shërbimi.

Në kushtet aktuale, përdoruesit e këtij grupi që marrin shërbim interneti broadband, e përfitojnë atë me standarte teknike relativisht të mira dhe për shkak të mbulimit të kostos nga ana e shtetit ose burimeve të tjera publike, janë relativisht indiferentë ndaj kostos së ofrimit të shërbimit.

Katër segmentet e mësipërme përbëjnë praktikisht masën dërrmuese të kërkesës aktuale dhe potenciale për shërbim interneti broadband në të gjithë zonën “Bjeshkët e Namuna”. Megjithë ndryshimet e përmendura që ekzistojnë midis grupeve të ndryshme të konsumatorëve, vlen të theksohet që kërkesa e përgjithshme në këtë zonë është e kushtëzuar nga faktorë të rëndësishëm objektivë, ndaj mbetet ende e ulët.

Në këto rrethana, duket e pamundur që forma specifike e kërkesës të kushtëzojë lindjen dhe zhvillimin e një oferte të posaçme në treg, të ndryshme nga ajo që disponohet aktualisht në tregun

kombëtar, e që do të mund t'i përgjigjej në një mënyrë të veçantë kushteve specifike të zonës. Niveli i sofistikimit të të gjithë përdoruesve të shërbimit të internetit në zonë nuk është i tillë që të kërkojë apo justifikojë transformimin e plotë të tregut lokal për të mundësuar kalimin e tij në një stad më të përparuar se kushtet aktuale si në tregun lokal, ashtu dhe në atë kombëtar.

Për këto arsye, adresimi i anës së ofertës në treg, dhe në veçanti, stimulimi i formave bashkëpunuese dhe inovative që rezultojnë në mundësi më të mira aksesit në shërbimin internet broadband për të gjithë konsumatorët e zonës, mbetet për të ardhmen përparësia kryesore për të arritur një treg funksional sikurse dhe në pjesët e tjera të Shqipërisë.

1.3 Burimet ekzistuese në tregun e zonës “Bjeshkët e Namuna”

Burimet ekzistuese në funksion të zhvillimit të tregut të shërbimeve të internetit në zonën “Bjeshkët e Namuna”, për vetë kushtet natyrore dhe stadin e zhvillimit të zonës, janë të kufizuara krahasuar me nivelin mesatar të Shqipërisë.

Gjatë viteve të fundit investimet në infrastrukturën e transportit kanë përmirësuar ndjeshëm kushtet e levizjes drejt e brenda zonës, ndonëse gjatë periudhës së dimrit dëbora izolon një pjesë të mirë të komunave të saj. Problem mbetet furnizimi me energji elektrike i cili për shkak të rrjetit të amortizuar, rritjes së konsumit dhe mungesës së investimeve përbën shpesh një pengesë për bizneset e vogla aktive në këtë zonë, të cilat si zgjidhje janë të detyruara të investojnë në vendosjen e gjeneratorëve të vegjël të energjisë, në mungesë të furnizimit nga rrjeti.

Sistemi arsimor në zonën “Bjeshkët e Namuna” përgatit formimin e nxënësve deri në nivelin parauniversitar, me kapacitete të ulëta për shkak të kushteve të zonës. Shkodra dhe Kukësi janë qytetet më të afërta me zonën që ofrojnë arsimin e lartë universitar. Një numër i papërfillshëm inxhinierësh banojnë në zonë dhe shërbimet e internetit bazohen në njohuritë e përdoruesve lokalë si dhe të një numri të vogël të ofruesve të këtij shërbimi.

1.4 Sektorët mbështetës

Bujqësia dhe blegtoaria, të cilat përbëjnë aktivitetin parësor ekonomik të zonës, paraqiten në një stad relativisht të prapambetur të zhvillimit, duke mos ofruar mundësi realiste për t'u mbështetur apo ndihmuar fuqizimin e zhvillimit të shërbimeve të internetit në zonë. Ndonëse përdorimi i internetit padyshim do të ndihmonte fermerët e zonës për të vendosur kontakte me tregjet, përvetësuar eksperiencat më të mira, apo dhe thjesht për marrjen e informacionit të dobishëm për aktivitetin e tyre, niveli i formimit për këtë sektor të ekonomisë në zonë nuk mundëson shfrytëzimin e këtyre shërbimeve, duke paraqitur një tjetër nevojë për t'u adresuar në të ardhmen. Megjithë këto probleme, bujqësia dhe blegtoaria do të vazhdojnë të përbëjnë një bërthamë të rëndësishme të zhvillimit

ekonomik të zonës në të ardhmen, mbështetur edhe nga përmirësimi i kushteve të infrastrukturës dhe kërkesës në rritje për produkte tradicionale lokale.

Sikurse u përmend edhe më sipër, sektori i turizmit malor, organizuar në format familiare, tradicionale apo të hoteleve dhe bujtinave të vogla, si dhe operatorët e udhëtimeve alpine shtrirë në të gjithë zonën, paraqesin aktivitetet më të ndërvarura ndaj zhvillimit të shërbimeve të internetit broadband dhe burimin kryesor të kërkesës për to në zonë. Ecuria e këtij sektori ndër vitet e fundit dëshmon për një rritje të konsiderueshme në numrin e turistëve të huaj e vendas që vizitojnë zonën, të cilët janë përdorues të rregullt të shërbimeve të internetit dhe që do të ishin të gatshëm për të paguar për të sikurse në pjesën tjetër të Shqipërisë. Pritshmëritë për të ardhmen e këtij sektori, me përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës në rajon dhe të imazhit pozitiv të tij, tregojnë një tendencë në rritje të vazhdueshme gjë që paraqet edhe një potencial të rëndësishëm për ecurinë e kërkesës së shërbimeve të internetit.

Një sektor tjetër i rëndësishëm që ndërlidhet me atë të shërbimit internet broadband, është dhe ai i telekomunikimit, që mundësohet në zonë nga aktiviteti i kompanive kombëtare të telefonisë mobile dhe fikse. Krahas rolit parësor të ofrimit të komunikimit për banorët dhe vizitorët e zonës, aktiviteti i këtyre kompanive i jep jetë dhe shërbimeve mbështetëse të mirëmbajtjes, shërbimit dhe atyre në vlerë të shtuar, komponentë të cilët mbivendosen natyrshëm dhe në rastin e shërbimeve të internetit broadband.

1.5 Roli i Shtetit

Roli i institucioneve shtetërore në promovimin e përdorimit të shërbimeve të internetit broadband, sikurse për çdo aktivitet tjetër ekonomik, është tepër i rëndësishëm, madje për zona të izoluar si ajo në zonën “Bjeshkët e Namuna”, mund të jetë edhe përcaktues. Duke përjashtuar pjesëmarrjen e shtetit në rolin e ofruesit direkt të shërbimit për shkaqet tradicionale që njihen në rastet kur sektori privat operon në sektor (eficienca, ndërhyrja në treg, konkurenca etj.), ka mjaft rrugë të tjera përmes të cilave shteti shqiptar mund të mbështesë zhvillimin e shërbimit internet broadband edhe në këtë zonë.

Mënyra më e drejtpërdrejtë e kësaj mbështetje lidhet me rolin e shtetit si përdorues i rëndësishëm i shërbimit internet broadband në zonë, gjë që krijon kërkesë në treg, stimulon ofrimin e zgjidhjeve nga operatorët privatë, rrit njohjen e shërbimit në zonë dhe njëkohësisht mundëson përdorimin e internetit si një e mirë publike. Si shembuj ilustrues vlen të përmendet psh. përdorimi i internetit nga ana e zyrave të komunave në zonë, shkollat publike apo zyrat e shërbimit postar.

Por shteti shqiptar mundet të ndihmojë në promovimin e përdorimit të internetit broadband në zonë edhe përmes rolit të tij në drejtim të:

- zbatimit të projekteve të bashkëpunimit me donatorë ndërkombëtare (sikurse ky projekt),
- adresimit të vëmendjes së operatorëve privatë rreth zonës,
- promovimit të projekteve të përbashkëta,
- përmirësimit të infrastrukturës shoqëruese,
- financimit apo bashkëfinancimit të mikroprojekteve të shoqatave apo organizimeve të tjera aktive në zonë etj.

Pjesa e dytë e këtij studimi trajton më në gjerësi këto mundësi.

1.6 Institucionet për bashkëpunim dhe ato ndërkombëtare

Tri grupime të rëndësishme organizatash përfshihen në këtë kategori, e cila gjithashtu ndikon në promovimin e përdorimit të internetit broadband në zonë.

Së pari, shoqatat e ndryshme, forumet dhe faktorë të tjerë të shoqërisë civile me aktivitete në zonë, ndihmojnë në njohjen e zonës së 'Bjeshkëve të Namuna' në Shqipëri e në të gjithë botën, duke promovuar vlerat e saj dhe kontribuar në rritjen e numrit të vizitorëve si dhe në një vëmendje më të mirë nga ana e shtetit shqiptar dhe organizmave ndërkombëtarë.

Grupi i dytë i institucioneve për bashkëpunim është edhe më pranë aktivitetit ekonomik në zonë dhe përfshin kryesisht shoqatat turistike, që veç veprimtarive të mësipërme, ndihmojnë hotelet, bujtinat dhe shërbimet e tjera të lidhura me turizmin malor të zonës, duke vendosur e fuqizuar lidhjet e tyre me tregun kombëtar dhe rregjet e turizmit ndërkombëtar. Ky grupim ka një rol tepër të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të aksesit në treg nga operatorët lokalë, duke ndihmuar së tepërmi zhvillimin ekonomik të zonës dhe padyshim, zgjerimin e bazës së kërkesës për produkte të lidhura me shërbimin internet broadband.

Grupimi i tretë i institucioneve për bashkëpunim në zonë është edhe më i rëndësishëm. Ai përfshin organizatat dhe institucionet ndërkombëtare aktive në zonë përmes zbatimit të projekteve të zhvillimit, të tilla si psh. GIZ, SIDA, USAID, Oxfam, UNDP etj. Të gjitha këto organizata dhe shumë të tjera kanë ndihmuar me financime të rëndësishme përmes projekteve të zhvillimit në zonë të cilat kanë synuar në rritjen e cilësisë së jetesës, zhvillimin e biznesit, vendosjen e lidhjeve me tregun kombëtar e rajonal etj. Njëkohësisht, me praninë e tyre, ekipet e këtyre organizatave janë gjithashtu klientë të shërbimeve të hotelierisë në zonë, sikurse dhe përdorues të rëndësishëm të shërbimeve të internetit broadband.

1.7 Çmimi

Në kushtet optimale të një tregu funksional dhe duke presupozuar praninë e një konkurrence të hapur në të, gërshtimi i faktorëve të diskutuar më sipër do të rezultonte natyrshëm në një sërë produktesh të identifikueshme të shërbimit të internetit broadband për të gjithë përdoruesit në zonën ‘Bjeshkët e Namuna’, me çmime plotësisht të përcaktuara.

Por sikurse dihet dhe u shtjellua më sipër, izolimi i zonës, kushtet specifike të saj, popullësia e rrallë dhe e shpërndarë, niveli i zhvillimit ekonomik dhe faktorë të tjerë, kanë bërë që depërtimi i shërbimit internet broadband brenda zonës të jetë tepër i kufizuar. Për rrjedhojë nuk mundet të analizohet çmimi i shërbimit të internetit broadband nisur nga kërkesës lokale në zonë, në kushtet e një oferte të munguar, ose në rastin më të mirë, të pjesshme në treg.

Por duke qenë se operatorët e shërbimit internet broadband në Shqipëri, nisur nga madhësia relativisht e vogël e tregut kombëtar si dhe nga mungesa e sofistikimit të kërkesës mbi baza rajonale (që do të shtynte drejt zgjidhjeve të posaçme), si dhe diktuar nga roli rregullues i shtetit përmes AKEP, përgjithsisht veprojnë me çmime të unifikuara në nivel kombëtar, analiza e çmimit të produkteve të shërbimit internet broadband mund të kryhet duke përdorur çmimet që zbatohen nga këta operatorë në tregun kombëtar duke e marrë të mirëqenë praninë e tyre edhe në zonën e ‘Bjeshkëve të Namuna’, gjë që mundëson një analizë krahasimore mbi bazë çmimi. Një pasqyrë e tillë shoqërohet edhe me përparësitë apo disavantazhet, teknike dhe të kostove që paraqet secila zgjidhje, e analizuar nga kushtet specifike në zonë.

1.7.1 Internet broadband me linja fikse, ADSL, valë dhe fibër optike

Albtelecom Sh.A., si operatori kryesor kombëtar i telefonisë fikse në vend ofron shërbimin e internetit për pajtimtarët e tij. Interneti ofrohet kryesisht me linja ADSL dhe VDSL (për shpejtësi të larta), ndërkohë që rrjeti kombëtar dhe lidhjet me rrjetin ndërkombëtar janë me fibra optike (rreth 1400 km fibra optike në tërë vendin). Tabela e mëposhtme paraqet tarifat e ofrimit të internetit në të gjithë vendin, me çmime të unifikuara, biznese dhe familjare, në të cilën nuk përfshihet vetëm çmimi i modemit (3,300 lekë).

Tabela nr. 20 (Burimi: albtelecom.al)

Paketa	Shpejtësia e transmetimit (Download/Upload)	Limiti Trafikut	IP	Tarifa Instalimit (Lekë)	Tarifa mujore (Lekë/muaj)
ADSL me Limit	2 Mbps / 256 kbps	4 GB	Dinamike	3,990	1,199

ADSL me Limit	2 Mbps / 256 kbps	10 GB	Dinamike	3,990	1,799
ADSL pa Limit	2 Mbps / 256 kbps	Pa limit	Dinamike	3,990	2,399
ADSL pa Limit	4 Mbps / 512 kbps	Pa limit	Dinamike	3,990	3,599
ADSL pa Limit	8 Mbps / 768 kbps	Pa limit	Dinamike	3,990	4,799
ADSL PRO	8 Mbps / 768 kbps	Pa limit	Statike	4990	5,999
ADSL PRO	12 Mbps / 1 Mbps	Pa limit	Statike	4990	8,999
ADSL PRO	16 Mbps / 1 Mbps	Pa limit	Statike	4990	11,999

Edhe operatorë të tjerë të internetit dhe telefonisë fikse ofrojnë internetin me çmime relativisht të krahasueshme, ndërkohë që Albtelecom ka nisur të ofrojë dhe internet me zona ËiFi pranë qendrave kryesore dhe urbane (krahas internetit 3G nëpërmjet Eagle Mobile). Kështu, ATU zotëron një rrjet prej 750 km fibre optike në të gjithë vendin dhe lidhje me të gjitha vendet fqinje. Ndërsa tabela e mëposhtme paraqet çmimet e ofruara nga një tjetër operator – Abissnet, që gjithashtu ka një shtrirje të konsiderueshme të shërbimit në të gjithë Shqipërinë.

Tabela nr. 21

Paketat	Basic	Start	Standart	Extra	Mega
Download	1 Mbps	2 Mbps	6 Mbps	8 Mbps	16 Mbps
Upload	512 Kbps	1 Mbps	1 Mbps	1 Mbps	1 Mbps
Pagesa për 1 Muaj	1,200 lekë	1,600 lekë	1,900 lekë	2,500 lekë	4,000 lekë
Parapagim për 3 Muaj	1,100 lekë	1,500 lekë	1,800 lekë	2,400 lekë	3,900 lekë
Parapagim për 6 Muaj	1,000 lekë	1,400 lekë	1,700 lekë	2,300 lekë	3,700 lekë
Parapagim për 12 Muaj	900 lekë	1,200 lekë	1,500 lekë	2,100 lekë	3,500 lekë
Tarifë Regjistrimi	1,000 lekë	1,000 lekë	1,000 lekë	1,000 lekë	1,000 lekë

Burimi: abissnet.al

Vlen të theksohet se brenda këtij grupimi futen dhe zgjidhjet teknike të lidhjes me mikrovalë e wireless, që mundësojnë përdorimin e internetit nga një zonë relativisht e vogël mbulimi (pranë një qendre, fshati etj.), por të cilat në thelb, kërkojnë ndërtimin e linjës kryesore të fibrës optike deri në transmetuesin lokal.

Ndonëse shërbimi i internetit broadband ka avantazhe në kosto të operimit dhe paraqet lidhjen më të përhapur të internetit në botë dhe Shqipëri, përhapja e rrjetit fiks dhe e fibrave optike në zonën e 'Bjeshkëve të Namuna' praktikisht mungon. Asnjë prej operatorëve të këtij shërbimi nuk ka arritur të zhvillojë rrjetin në këtë zonë për shkaqet e përmendura më sipër, duke i privuar përdoruesit lokale nga ky shërbim i rëndësishëm.

Arsyeja kryesore për mungesën e investimeve në këtë zonë, krahas tregut të kufizuar dhe problemeve që u trajtuan më lartë, lidhet me koston e lartë të investimit për shtrirjen e rrjetit të fibrave optike, i cili sipas standarteve ndërkombëtare për terrene normale e jo të vështira, shkon në rreth 50.000 Euro për km ose në rreth 1000 US\$ për përdorues fundor⁹. Këto të dhëna, duke patur parasysh shpërndarjen e popullsisë, terrenin e thyer dhe konsumin e kufizuar në zonë, vështirësojnë shumë ndërmarrjen e investimeve nga operatorët mbi bazën e vlereësimeve komerciale.

1.7.2 Internet broadband 3G

Të katërt operatorët kombëtarë të telefonisë celulare ofrojnë shërbimin e internetit broadband me një mbulim 3G në pjesë të mirë të Shqipërisë dhe 2G në zonat e thella e malore. Përdorimi i internetit mobil ka pësuar rritjen më të ndjeshmë gjatë viteve të fundit, gjë që është shoqëruar më shtrirjen e rrjetit, përmirësimin e shërbimit dhe uljen e çmimeve që janë konkurrese edhe me internetin përmes linjave fikse. Tabela e mëposhtme paraqet çmimin e shërbimit të internetit ofruar prej njërit nga operatorët kryesorë në treg, ndërkohë që çmime të përafërta ofrohen dhe nga operatorët e tjerë:

Tabela nr. 22

Paketa Fillestare (Modemi USB 3G, me shpejtësi 7.2 Mbps, karta SIM)	Pa Pagesë*
Paketa Fillestare (Modemi USB 3G, me shpejtësi 14.4 Mbps, karta SIM)	Pa Pagesë*
Paketa Fillestare (Modemi USB 3G, me shpejtësi 21.1 Mbps, karta SIM)	Pa Pagesë*
Paketa Fillestare (Modemi USB 3G, me shpejtësi 42.2 Mbps, karta SIM)	5,000 Lekë*

⁹ http://ëëë.ëkinvest.com/industry/Fiber_Optics

**Garancia		6,000 Lekë
Plani Tarifor VMB 3GB	MB për Muaj	Pagesa Fikse Mujore
VMB 3GB	3 GB	1,700 Lekë
Ekstra MB pas konsumit të 3GB fillestare deri në 6GB	3 Lekë/MB	
Ekstra MB mbi 6GB	12 Lekë/MB	
Plani Tarifor VMB 5GB	MB për Muaj	Pagesa Fikse Mujore
VMB 5GB	5GB	2,700 Lekë
***Ekstra MB pas konsumit të 5GB fillestare deri në 10GB	3 Lekë/MB	
Ekstra MB mbi 10 GB	12 Lekë/MB	
Tarifa për SMS (kombëtare dhe ndërkombëtare)	12 Lekë/SMS	

Interneti broadband mobil paraqet disa avantazhe kundrejt atij me linja fikse në zonën e ‘Bjeshkëve të Namuna’. Së pari, edhe pse aktualisht asnjë prej operatorëve mobilë nuk ofron mbulim 3G në zonë (madje dhe mbulimi 2G lë shumë për të dëshëruar), prania e telefonisë mobile në zonë është relativisht më e lartë po të krahasohet me linjat fikse, duke qenë praktikisht mjeti kryesor i komunikimit brenda saj. Së dyti, interneti dhe komunikimi mobil është më i lehtë për t’u aksesuar në territorin e ‘kilometrit të fundit’, pra nga antena drej konsumatorit, krahasuar me shtrirjen e kabllave nëpër shtëpi të izoluara të një fshati në rastin e linjave fikse. Së treti, interneti mobil është më praktik për shkak të lehtësisë së lëvizjes, praktikitetit të përdorimit dhe pasjes së shërbimit edhe në mungesë të energjisë elektrike (antenat funksionojnë edhe me generatorë).

Por sikurse edhe në rastin e internetit me linjë fikse, mosmbulimi i zonës dhe kostot e investimit përbëjnë pengesa serioze për ofrimin e këtij shërbimi në zonën e ‘Bjeshkëve të Namuna’. Mbulimi i pjesshëm 2G që aktualisht ofrohet në zonë, mundëson shpejtësi të ulët komunikimi dhe shoqërohet me pasiguri për aksesin për shkak të sinjalit që mungon ose është i dobët. Nga ana tjetër, dihet që edhe vetë interneti broadband 3G ka kufizime në shpejtësi krahasuar me linjat ADSL, dhe veç kësaj, edhe kufizime në sasinë e informacionit të transmetuar. Në rastet e mbulimit të mirë të zonës me valë 3G, përdoruesit mund të zgjidhnin mjaft mirë përdorimin e email, kërkimin e lundrimit në internet si dhe në një farë masë komunikimin VOIP, por kjo zgjidhje nuk do të ishte shumë efektive për shkarkimin e videove, IPTV apo shërbime të tjera që kërkojnë të mos ketë kufizime në transmetim.

Nga diskutimet me operatorët mobilë në vend, rezulton se kosto e përafërt për ndërtimin e një antene transmetuese sinjali, shkon në rreth 100.000 Euro, ndërkohë që mbulimi i zonës ‘Bjeshkët e Namuna’ do të kërkonte instalimin e një numri të konsiderueshëm të antenave të tilla.

Së fundi, zgjidhja mobile në këtë zonë vështirësohet edhe më tepër për shkak të kostove të mirëmbajtjes e riparimeve të antenave si dhe furnizimit të tyre me karburant në mungesë të energjisë, në një terren tepër të vështirë.

1.7.3 Internet broadband me satelit

Zgjidhjet satelitore ofrojnë mundësi praktike për përdorimin e internetit broadband në zonat e thella e malore sic janë ‘Bjeshkët e Namuna’. Ato janë përdorur me sukses në Shqipëri, pikërisht për shkak të problematikave të terrenit dhe avantazheve të zgjidhjes satelitore. Brenda vendit funksionojnë disa operatorë privatë që ofrojnë shërbimin e internetit përmes satelitit. Zgjidhja satelitore mbizotëron gjithashtu në zonën e ‘Bjeshkëve të Namuna’ aty ku sot ka shërbim interneti. Në ditët e sotme teknologjia ka avancuar dhe lejon përdorimin e internetit me shpejtësi të lartë e të sigurt dhe me çmime konkurruese ndaj zgjidhjeve të tjera që ekzistojnë të treg.

Çmimet e mëposhtme të ofruara në treg nga një prej operatorëve vendas, tregojnë se interneti broadband përmes satelitit, është paksa më i kushtueshëm se ai i ofruar përmes zgjidhjeve të tjera teknike, por duhet theksuar se deri më tani praktikisht ai mbetet e vetmja zgjidhje për ofrimin e shërbimit në zonën e ‘Bjeshkëve të Namuna’.

Tabela nr. 23

Kostot Fillestare				
Pajisjet (Antena, Modemi, Kabllo, etj.)	€ 380			
Aktivizimi	€ 35			
Instalimi (udhëtimit dhe puna e instaluesve)	€ 100 (pa kosto nëse kryhet nga vetë klienti)			
Çmimet e Shërbimit				
Plani i Shërbimit	Tooway 8	Tooway 12	Tooway 18	Tooway 18 ^{max}
Shpejtësia e Shkarkimit (Download)	8 Mbps	12 Mbps	18 Mbps	18 Mbps
Shpejtësia e Dërgimit (Upload)	2 Mbps	4 Mbps	6 Mbps	6 Mbps
Kuota Mujore	8 GB	16 GB	26 GB	50 GB
Çmimi Mujor	€ 23	€ 38	€ 52	€ 97

Burimi: starsat.al

Avantazhi parësor i internetit satelitor krahasuar me format e tjera të ofrimit të këtij shërbimi qëndron në eliminimin e kostove të investimit në infrastrukturën ndërlidhëse (antena, fibra optike etj) dhe komoditetin e lidhjes në çdo pikë të globit.

Pavarësisht këtij avantazhi superior teknik të padiskutueshëm ndaj zgjidhjeve të tjera, është e rëndësishme të nënvizohet se zgjidhja satelitore mbart dhe një sërë problemesh të tjera. Kështu, vonesa e transmetimit të sinjalit përmes rrugës tokë-satelit, vështirëson së tepërmi dhe pengon transmetimet në kohë reale, përfshirë komunikimet video/audio ndërkohë që ajo përjashton shërbime që nuk pranojnë vonesa të tilla në komunikim.

Ndonëse çmimi i instalimit të antenës pasqyrohet në tabelën e mësipërme, lëvizjet e vogla të antenës për shkak të erës, dëborës apo goditjeve, kërkojnë shërbimin e mirëmbajtjes i cili nuk është i disponueshëm në zonë dhe dërgimi i tij nga Tirana është i kushtueshëm dhe kërkon kohë.

Një vështirësi tjetër që paraqet zgjidhja satelitore është se në kushtet e dëborës e të ftohtit që mbizotëron në zonë, antena duhet të pajiset me sistem ngrohjeje për shkrirjen e dëborës, i cili përbën kosto shtesë dhe në rast të mungesës së energjisë (që ndodh shpesh në zonë) lidhja nuk bëhet funksionale.

Së fundi, zgjidhja satelitore vështirësohet shumë në kushtet e motit të keq e mjegullës, gjë që rëndon cilësinë e komunikimit dhe zvogëlon shpejtësinë e internetit të përfutur.

2. Mënyrat e financimit dhe mundësitë e partneritetit për promovimin e shërbimit internet broadband në zonën ‘Bjeshkët e Namuna’

Plani Kombëtar i Broadbandit, miratuar me VKM Nr 468, datë 30.5.2013 përcakton vizionin për zhvillimin e broadbandit në Shqipëri deri në vitin 2020: ‘Zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve broadband në të gjithë vendin për të përfutur akses në shërbimet elektronike në fusha të ndryshme si shëndetësi (e-health), edukim (e-education), tregti (e-commerce), shërbimet qeveritare (e-government) si dhe për të arritur përfitime të mëdha ekonomike dhe sociale për vendin tonë’.

Në përputhje me këtë vizion, zhvillimi i infrastrukturës së internetit broadband ‘...kërkon kontributin e rëndësishëm të sektorit privat, ku përfshihen një sërë operatorësh të shërbimit fiks, shërbimit të lëvizshëm si dhe ofrues të shërbimit të internetit të cilët janë aktivë në tregun shqiptar

që kanë kontribuar në ndërtimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe ofrimin e shërbimeve. Zbatimi i këtij plani dhe arritja e synimeve, objektivave specifike për sigurimin e aksesit broadband me shpejtësi të lartë në të gjithë vendin përfshirë dhe zonat e largëta, kërkon më shumë investime nga sektori privat. Roli i qeverisë do të jetë kryesisht në krijimin e klimës së përshtatshme për investime, në rritjen e kërkesës, rritjen e ndërgjegjësimit për shërbimet broadband, nxitje të kooperimit dhe sinergjive midis aktorëve si dhe zhvillimin e modeleve të partneritetit publik e privat, pa dëmtuar konkurrencën e ndershme në treg’.

Analiza e tregut dhe faktorëve kryesorë që kanë rol në zhvillimin e shërbimit internet broadband, tregon se shtrirja e këtij shërbimi në zonën ‘Bjeshkët e Namuna’, në kushte të natyrshme sikurse në pjesën më të madhe të Shqipërisë, është e vështirë, në mos e pamundur. Për shkak të kërkesës së kufizuar e të copëzuar në një terren me shtrirje tepër të gjerë e kushte të pafavorshme, në mungesë të faktorëve stimulues, aktiviteti i operatorëve ekonomikë është i prirur të polarizohet duke favorizuar me investime zhvillimin e rrjetit në zona me të ardhura më të mira, dhe lënë pas dore shtrirjen e tij aty ku përfitimi ekonomik është minimal.

Për këtë arsye, duke konsideruar njëkohësisht nevojën e balancimit të të drejtave të konsumatorëve në shkallë vendi, por për më tepër, duke vlerësuar rolin e padiskutueshëm që shërbimi i internetit ka në zonat më pak të zhvilluara, ndërhyrja në treg për të promovuar aksesin e barabartë të këtij shërbimi, rezulton e justifikueshme.

Por çdo ndërhyrje e tillë do të duhet të plotësojë të paktën dy kushte të rëndësishme:

- **Idealisht nuk duhet të interferojë negativisht apo konkurojë me ato raste ku sektori privat ka arritur të shtrijë aktivitetin përmes formave të komercializuara në treg.**
- **Përdoruesit fundorë të shërbimit, duhet të paguajnë për të në të njëjtën mënyrë sikurse përdoruesit e tjerë në vend.**

Ndërkohë që kushti i parë synon përputhshmërinë e një ndërhyrje në treg me normat e ndihmës shtetërore e njëkohësisht siguron sektorin privat se nuk do të cënohet nga ndërhyrje të tilla, kushti i dytë, më pak i kapshëm, është po aq i rëndësishëm. Parimi i pagesës për shërbimin është i nevojshëm pasi ai ndihmon përgatitjen e tregut për të qenë funksional në kushtet kur ndihma pushon së funksionuari dhe sektori privat merr përsipër plotësisht operimin e shërbimit. Një parim i tillë justifikohet në rastin e këtij projekti pasi siç u tregua më sipër, nga ana e kërkesës në treg, përdoruesit rezultojnë të gatshëm të paguajnë për çmimin e shërbimit, ndërkohë që është aksesin në shërbim në krahun e ofertës, që krijon problemin.

Një formë e tillë ndërhyrjeje mbështetur në këto parime është përdorur dhe në raste të ngjashme në Shqipëri, për sektorë të tjerë të ekonomisë. Vlen të përmendet psh. përvoja e sektorit të ujitjes dhe

kullimit, ku ndërkohë që shteti dhe donatorët ndërhyjnë në treg për ndërtimin e infrastrukturës së sistemit të ujitjes e kullimit, fermerët paguajnë për konsumimin e ujit të përdorur për këtë qëllim. Për më tepër, sikurse është sugjeruar dhe nga një prej donatorëve ndërkombëtarë aktivë në zonë, e njëjta praktikë është përdorur dhe për shërbime të tjera të ngjashme (energji elektrike etj).

Më poshtë trajtojmë më në hollësi format e ndryshme të bashkëpunimit që mund të përdoren në rastin konkret të promovimit të shërbimit internet broadband në zonën ‘Bjeshkët e Namuna’:

1.1 Promovimi i shërbimit internet broadband përmes ofrimit të shërbimit publik

Përmes reformave strukturore të ndërmarra ndër vite, shteti shqiptar është tërhequr nga ushtrimi i aktivitetit të ofrimit të shërbimeve të telekomunikacionit, në të cilat shteti ka qenë pjesëmarrës (AMC është privatizuar në 2001 dhe Altelecom në 2006), duke i hapur rrugë sektorit privat të konkurojë dhe të plotësojë kërkesat e tregut.

Megjithë mosfunksionimin si duhet të tregut të shërbimit të internetit në zonën ‘Bjeshkët e Namuna’, nuk mund të konsiderohet realiste dhe kurrsesi nuk do të sugjerohej një ndërhyrje e drejtpërdrejtë e shtetit shqiptar përmes kompanive apo ndërmarrjeve publike që mund të krijoheshin enkas për të korrigjuar këtë defekt të tregut. Prirja e zgjidhjes duhet të synojë në angazhimin aktiv të shtetit për të ndërtuar bashkëpunime efikase që ofrojnë zgjidhjet e duhura pa deformuar thelbin e funksionimit të ekonomisë së tregut.

1.2 Promovimi i shërbimit internet broadband përmes ndërtimit të partneritetit publik-privat

Shteti shqiptar nuk është i pranishëm në mënyrë të drejtpërdrejtë në tregun e ofrimit të shërbimit të internetit në vend, ndaj format tradicionale të ndërtimit të partneritetit publik-privat (me publikun të përfaqësuar përmes shtetit) nuk gjejnë hapësirë për ndërtimin e një zgjidhjeje nëpërmjet kësaj forme bashkëpunimi.

Baza ligjore për krijimin e partneriteteve të tilla është Ligji ‘Për Koncesionet’ Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, i cili përmban kuadrin e nevojshëm për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të projekteve koncesionare, të financuara nga sektori privat, duke rritur transparencën, barazinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Neni 4.1.d dhe 4.1.g i ligjit përfshin në fushën e koncesioneve edhe sektorin e telekomunikacioneve dhe shërbimeve të mirëmbajtjes së teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturës së bazës së të dhënave ndërkohë që Neni 4.4 përcakton se ligji nuk zbatohet për lëshimin e licencave, përveçse në masën që një licencë lëshohet brenda kuadrit të kontratës së koncesionit.

Por duke qenë se shteti shqiptar, përmes sistemit të licensimit i ka hapur plotësisht rrugën operatorëve privatë për të ushtruar aktiviteti ekonomik të shërbimit të internetit edhe në zonën e ‘Bjeshkëve të Namuna’ ligji i koncesioneve, si bazë e partneriteteve publike e private, praktikisht nuk sjell ndonjë hapësirë të re që mund të shfrytëzohet për promovimin e mëtejshëm të përdorimit të këtij shërbimi të rëndësishëm në zonë. Problemi nuk lidhet me krijimin e një partneriteti që do të plotësonte boshllëkun që ekziston në treg nga pamundësia e sektorit publik për të ofruar shërbimin, por nga mungesa e kushteve të duhura që sektori privat të funksionojë në mënyrë optimale në hapësirat që i janë dhënë për të ushtruar aktivitetet.

Nga ana tjetër, edhe referencat botërore mbi partneritete të tilla në fushën e shërbimit të internetit, tregojnë se ato janë funksionale në raste të veçanta të interesit publik në shkallë të gjerë, dhe jo tipike për zgjidhje të vogla, lokale dhe të izoluar.

1.3 Promovimi i shërbimit internet broadband përmes fuqizimit të funksionit të shtetit si përdorues i shërbimit në zonë dhe kthimit të tij në të mirë publike

Sikurse u trajtua edhe në pjesën e parë të këtij studimi, një sërë institucioneve shtetërore janë përdorues aktualë ose potencialë të rëndësishëm në zonën e ‘Bjeshkëve të Namuna’. Të tilla përmendim:

- Institucionet lokale (komunat)
- Shkollat
- Qendrat shëndetësore
- Zyrat e shërbimit postar
- Institucionet e ruajtjes së rendit publik
- Institucione të tjera publike

Modernizimi dhe përdorimi i internetit në këto institucione është një përparësi e qeverisë shqiptare dhe duke konsideruar që shtrirja e këtij dimensionit në të gjithë territorin e Shqipërisë, përfshirë dhe zonën e ‘Bjeshkëve të Namuna’, është më e arritshme dhe më e shpejtë se sa shtrirja natyrore e shërbimit të internetit për përdoruesit e tjerë nga operatorët privatë, ky avantazh mund të transformohet më së miri në një përfitim për të gjithë zonën.

Përfitimi do të konsistonte jo thjesht në përdorimin e internetit nga institucionet përkatëse, pra në krijimin apo fuqizimin e kërkesës së drejtpërdrejtë në to si dhe rritjen e nivelit të njohurive mbi internetin, por se përmes ofrimit të shërbimit për të gjithë përdoruesit e tjerë në afërsi të institucioneve (me krijimin e një posti pune të hapur për publikun, dhënien falas të aksesit në rrjetin Wi-Fi etj.), këto institucione do të ktheheshin nje kritike të përhapjes së internetit në të gjithë zonën. Pra përmes investimit publik për marrjen e shërbimit të internetit në institucione publike, shteti

njekohësisht mundëson përdorimin e internetit edhe nga pjesa tjetër e popullsisë, aktualisht e privuar nga kjo mundësi.

Një përvojë e mirë ekziston tashmë në disa pjesë të zonës ku veçanërisht projektet e informatizimit e ofrimit të internetit në shkolla (rreth 2000 shkolla në shkallë vendi janë informatizuar dhe lidhur me internetin) sikurse dhe ai në zyrat e shërbimit postar PAP dhe PAP2, që ka mundësuar lidhjen e rreth 500 posteve publike të internetit në vend, me synim deri në 1800 të tilla, kanë dhënë rezultate pozitive të kësaj forme bashkëpunimi. Nisma e qeverisë për të ofruar pranë gjithë zyrave të shërbimit postar internet falas është pikërisht në mbështetje të kësaj forme bashkëpunimi.

Megjithë avantazhet e kësaj forme bashkëpunimi, ajo shfaq dhe problematika që lidhen me mbarëvajtjen e funksionimit të saj pasi në shumë raste janë evidentuar dëmtime të investimeve të realizuara apo mungesë e funksionimit të plotë të tyre.

Mbetet detyrë e institucioneve shtetërore të punojnë në të ardhmen përmes investimeve publike apo projekteve me donatorët për zgjerimin e këtij shërbimi dhe në pjesë të tjera të zonës sikurse po aq e rëndësishme mbetet çështja e vazhdimësisë së shërbimit internet dhe mirëmbajtjes së lidhjeve që ndërtohen.

Financimi përmes kësaj forme bashkëpunimi, sugjerohet si ndër më optimalët e mundshëm për realizimin e objektivit të këtij studimi.

1.4 Promovimi i shërbimit internet broadband përmes rolit të shtetit si pjesëmarrës në pronësinë e Albtelecom Sh.A

Megjithëse siç u përmend më sipër, shteti shqiptar është tërhequr nga aktiviteti i drejtpërdrejtë i shërbimeve të telekomunikacionit, ai ende zotëron një paketë të vogël (rreth 20%) në aksionet e kompanisë kombëtare Albtelecom Sh.A. e cila njëkohësisht është ndër ofruesit kryesorë të shërbimit të internetit me linja fikse dhe sinjal 3G (Eagle Mobile).

Ndonëse shteti si aksioner në këtë kompani nuk ka të drejta vendimmarrje, përmes pjesëmarrjes në mbledhjet e organeve drejtuese të kompanisë, përfaqësuesit shtetërorë mund të përdorin argumentat e duhura për të ndikuar që planet e zhvillimit të kompanisë të orientohen drejt ofrimit të shërbimit të internetit në zonat më pak të mbuluara, sikurse 'Bjeshkët e Namuna'. Një argumentim i mirë mund ta kthente vëmendjen e kompanisë drejt investimeve në këtë zonë jo vetëm nga këndvështrimi ekonomik, por edhe në kuadër të aktiviteteve të shumta që kompania organizon për të promovuar aspektin e përgjegjshmërisë sociale të saj. Kjo gjë do të ndihmonte zhvillimin e telefonisë fikse, shërbimit cilësor të internetit, si dhe internetit 3G në zonë duke ndihmuar pozitivisht forcimin e imazhit të kompanisë.

1.5 Promovimi i shërbimit internet broadband përmes rolit të shtetit si rregullues i sektorit të telekomunikacioneve

Ligji Nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përbën bazën ligjore që rregullon veprimtarinë e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike së bashku me akte të tjera nënligjore që lidhen me zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve broadband: VKM Nr. 468 date 30.5.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Broadbandit”, VKM Nr. 466 date 27.2.2014 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” etj.

Në zbatim të kësaj platforme legislative, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka një rol tepër të rëndësishëm për zhvillimin e tregut vendas të shërbimit të internetit. Në mënyrë të vecantë vlen të theksohet autoriteti i AKEP në drejtim të monitorimit të zbatimit të angazhimeve kontraktore të operatorëve në treg, dhe sidomos aktiviteti i operatorëve kombëtarë dhe atyre me fuqi të ndjeshme në treg. Kështu AKEP, përmes autoritetit që i jep ligji, mund të jetë më kërkues mbi plotësimin e detyrimit për mbulim me sinjal edhe në zona të izoluar të vendit apo të përmirësorë në bashkëpunim me operatorët e tregut legjislacionin që rregullon detyrimet e tyre në këtë aspekt të rëndësishëm.

Nga ana tjetër, AKEP ka një rol po aq të rëndësishëm në hapjen e mëtejshme të tregut ndaj shërbimeve të reja që mund të sjellin më tepër mundësi aksesit në zonat e pambuluara ose me mbulim të dobët interneti. Përshebull hapja së fundmi e procedurës së tenderit për teknologjinë WiMAX, që pritet të përfundojë gjatë vitit 2015 do të sjellë mundësi të reja për aksesin në internet të këtyre zonave.

1.6 Promovimi i shërbimit internet broadband përmes rolit të shtetit si partner zhvillimi me sektorin privat

Krahas raporteve kontraktore me operatorët e shërbimit të internetit në vend (sikurse përcaktohet në legjislacionin përkatës), nisur nga një perspektivë më e gjerë, shteti shqiptar ka marrëdhënie partneriteti me këto kompani ashtu si me çdo agjent tjetër ekonomik në vend. Në këtë kuptim, krahas bashkëpunimit për përmbushjen e angazhimeve përkatëse të përcaktuara në legjislacion, përmes institucioneve të tij, shteti shqiptar i ka të gjitha hapësirat për të zhvilluar bashkëpunimin në çdo fushë të aktivitetit ekonomik.

Ndërkohë që përjashtojmë opsionin e subvencionimit nga shteti për ndërtimin e infrastrukturës së internetit nga operatorët privatë, evidentimi dhe shfrytëzimi i sinergjive pozitive midis planeve të zhvillimit rajonal duke përfshirë sa më mirë në to perspektivën e zhvillimit të sektorit privat, është në dobi të zhvillimit të integruar dhe të qëndrueshëm. Ndaj koordinimi i strategjive të zhvillimit, investimeve publike, fuqizimit të kapaciteteve duhet të gjejë vend njëkohësisht edhe në planet dhe

strategjitë e biznesit të kompanive private dhe një bashkëpunim i tillë mund të shtrihet më së miri edhe në dobi të promovimit të aksesit dhe përdorimit të internetit në zonën e ‘Bjeshkëve të Namuna’.

Si një aspekt i vecantë i kësaj forme partneriteti, shteti shqiptar ka një rol të pazëvendësueshëm në drejtim të ndërgjegjësimit të operatorëve kryesorë mbi problemin që ekziston në këtë zonë, për të tërhequr vëmendjen e tyre jo thjesht mbi baza komerciale në drejtim të zgjidhjes së tij dhe krijimit të një platforme të vazhdueshme komunikimi për trajtimin e një problematike të kësaj natyre në të ardhmen. Një ngjallje interesi dhe gatishmëri e kompanive private për t’u njohur më mirë me realitetin dhe për të zgjeruar aktivitetin në zonën e ‘Bjeshkëve të Namuna’ u konstatua edhe gjatë intervistave të zhvilluara në kuadër të këtij studimi dhe padyshim, institucionet shtetërore e kanë të gjithë autoritetin e duhur për ta shpënë përpara këtë proces.

1.7 Promovimi i shërbimit internet broadband përmes rolit të shtetit si partner me donatorët ndërkombëtarë

Donatorët ndërkombëtarë luajnë një rol të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të zonës së ‘Bjeshkëve të Namuna’. Disa donatorë kryesorë si GIZ, BE, PNUD, USAID, BB etj. kanë zbatuar një sërë projektesh që i kanë dhënë jetë aktivitetit privat, zhvillimit të bujqësisë dhe turizmit, dhe përmirësimit të infrastrukturës në zonë. Roli i shtetit në koordinimin e aktivitetit të donatorëve si dhe në njohjen, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e tyre rreth problematikës që trajtohet në këtë studim, është parësor dhe i pazëvendësueshëm.

Ndonëse nga kërkimet e kryera rezultojnë se asnjë donator nuk ka nisur ndonjë projekt për zhvillimin e aksesit dhe përdorimin e internetit në zonë, projekte të tjera më të gjera, si psh. ai i modernizimit të shkollave, në kuadër të Projektit për Cilësi dhe Barazi në Arsim, financuar me 15 milionë US\$ nga Banka Botërore gjatë periudhës 2005-2013, përmban një komponent të rëndësishëm të pajisjes me laboratore dhe akses në internet për rreth 2000 shkolla në mbarë vendin, përfshirë ato në zonën e studimit. Projekte të tjera të ngjashme janë zhvilluar në nga UNDP: Projektet ‘Përdorimi i aplikimeve ICT nga autoritetet vendore dhe përmirësimi i pjesëmarrjes nga qytetarët’, me financim 200.000US\$ gjatë periudhës 2010-2011, ‘Mbështetje Qeverisë Shqiptare për të përmirësuar infrastrukturën e ICT dhe e-Service’ me financim rreth 750.000US\$ gjatë periudhës 2011-2013 etj. dhe përvojat pozitive të tyre mund të shërbejnë si modele të mira për shtrirjen e projekteve të tjera në zonën e ‘Bjeshkëve të Namuna’ në të ardhmen.

Financimi i aksesit në internet për institucionet publike, që do të mundësonte dhe përdorimin e tij nga grupet e tjera në zonë, mund të ndihmohet nga projektet e donatorëve, sikurse nga ana tjetër, donatorët mund të aktivizohen dhe për financimin e projekteve të vogla dhe pilote për të ofruar këtë

shërbim ndaj operatorëve lokalë privatë në zona me potencial zhvillimi turistik apo në mungesë të pranisë së institucioneve shtetërore.

1.8 Promovimi i shërbimit internet broadband përmes ndihmës shtetërore

Një formë tjetër me anë të së cilës mund të synohet promovimi i internetit broadband në zonën e 'Bjeshkëve të Namuna', është ndihma shtetërore për sektorin, që në rastin konkret mund të kanalizohet përmes projekteve të zhvillimit të zbatuara nga ana e fondit për zhvillimin e rajoneve.

Investimet e deritanishme të këtij fondi janë përqëndruar kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese dhe hapjen e rrugëve të reja që përshkojnë zonën, por mbështetur në konceptin e bashkëpunimit me komunitetin, fondi mund të investojë në ngritjen e infrastrukturës së telekomunikacionit për nënzona të vogla e të izoluar si psh. fshatra apo qendra turistike që u shërbejnë vizitorëve të ndryshëm.

Për ilustrim, forma e bashkëpunimit mund të konkretizohet në blerjen me fonde publike të pajisjeve të nevojshme për aksesin në shërbimin e internetit (psh blerje e antenës satelitore, modemi, instalimi etj.) ndërkohë që përdoruesit mund të paguajnë për trafikun e përdorur për komunikim me internet apo dhe pjesë të investimit fillestar në infrastrukturë.

Realizimi i investimit në rrjetin broadband për pjesë të vecanta të zonës kërkon krijimin e hapësirave për financime në këtë infrastrukturë, dhe harmonizimin e prioriteteve të financimit të fondit me strategjinë ndersektoriale 'Akhenda Dixhitale e Shqipërisë 2014-2020'. Një gjë e tillë do të krijonte premisat e duhura për të shfrytëzuar në të ardhmen edhe financime të BE-së në këtë sektor nga programet si IPA CBC, HORIZON 2020, EUSAIR (*EU Strategy for the Adriatic and Ionian Region*) ku në këtë të fundit Shqipëria është koordinatore e prioritetit "Turizem i Qëndrueshëm", IPA kombëtare dhe shumëpërfitues.

Vlen gjithashtu të përmendet roli i rëndësishëm që rajonet brenda vendit marrin në kuadër edhe të reformës territoriale, që u mundëson institucioneve përkatëse të konkurojnë për përfitimin e financimeve për zhvillim nga fondet e brendshme dhe ato të BE. Përfshirja e financimit të infrastrukturës së internetit broadband në projektet e zhvillimit të rajoneve do të kërkojë aftësimin institucional të tyre për të përgatitur strategji, buxhete dhe zbatueshmëri të këtyre projekteve në të ardhmen.

1.9 Promovimi i shërbimit internet broadband përmes bashkëpunimit me vendet fqinje

Së fundmi, një formë e vecantë që mund të kihet parasysh për përdorim me synim zvogëlimin e kostove, është ofrimi i shërbimit të internetit nëpërmjet lidhjeve lokale ndërkufitare, për ato raste kur realizimi i një lidhjeje me internetin përtej kufirit është praktikisht më e lehtë se zhvillimi i rrjetit të

brendshëm kombëtar deri në atë pikë. Rast ilustrues psh mund të jetë fshati Vermosh, që fizikisht është shumë më pranë kufirit me Malin e Zi (ku mund të ekzistojë një zgjidhje e mirë teknike për internetin) se sa me pikën më të afërt në Shqipëri ku ka arritur fibra optike.

Forma të tilla të ‘kalimit të kufirit’ ndeshen brenda zonës pasi aktualisht operatorë të Kosovës ofrojnë shërbimin e internetit në disa fshatra pranë kufirit. Formalizimi i këtij aktiviteti nëpërmjet marrëveshjeve midis vendeve apo autoriteteve përkatëse që rregullojnë sektorin e telekomunikacioneve mund të jetë produktive dhe në dobi të përdoruesve, padyshim deri në kohën që ai mbetet si zgjidhje e përkohshme dhe e vetme, dhe pa deformuar konkurrencën normale brenda territorit të secilit shtet.

1.10 Përmbledhje vlerësuese e mundësive të identifikuar

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmbledhur avantazhet kryesore, kostot dhe problematikën e mënyrave të identifikuar në këtë seksion të studimit për promovimin e shërbimit internet broadband në zonën ‘Bjeshkët e Namuna’:

Tabela nr. 24

Forma e propozuar	Avantazhet kryesore	Kostoja e shërbimit	Problematika
Shërbim publik	Trajtimi i shërbimit si e mirë publike	Shumë e lartë për hyrjen në treg	Jo praktike, shteti shqiptar është tërhequr nga aktiviteti ekonomik në sektor
Partneritet publik-privat	Sektori privat merr përsipër realizimin e investimit	E lartë krahasuar me zonat e tjera të vendit	Forma rezulton e panevojshme pasi sektori privat i ka hapësirat e duhura për të ushtruar aktivitetin
Fuqizim i përdoruesve shtetërorë	Ne përputhje me vizionin e qeverisë për promovimin e përdorimit të ICT në shërbimin publik. Përfitime të gjera nga të gjithë përdoruesit si e mirë publike	Zgjidhjet teknike optimale sipas kushteve konkrete japin kosto të përbalueshme. Psh. instalimi i shërbimit me satelit kushton rreth 400€ ndërsa kosto e shërbimit rreth 30-80€ në muaj	Përvoja tregon se shërbimi në institucionet publike varet së tepërmi nga vazhdimësia e financimit dhe dëmtimet e pajisjeve dhe rrjetit

Përmes Albtelecom Sh.A. si operator pjesërisht shtetëror	Kosto mbartet nga shoqëria	Relativisht e lartë për zgjidhjet me fibër optike, e konsiderueshme për shërbimin e telefonisë mobile	Shtirja e rrjetit fiks apo fibrave optike është e kushtueshme dhe nuk justifikohet me kërkesën aktuale në zonë
Funksioni rregullator i shtetit	Zgjidhjet korrigjuese rajonale mund të justifikohen brenda kuadrit të licensës së operimit	Relativisht e lartë për lidhjet me linjë fikse apo shërbim mobil	Ngarkesa e operatorëve me detyrim të mbulimit për zona në disavantazh, mund të dëmtojë konkureshmërinë e tyre në treg dhe të ndikojë në planet e zhvillimit në zona të tjera të vendit
Partneriteti me biznesin	Lejon mundësimin e zgjidhjeve më të natyrshme të problemit	Kosto e shërbimit optimizohet sipas zgjidhjes më të mirë teknike të cdo zone	Zgjidhja mbetet në varësi të interesit të operatorëve për të ndihmuar dhe nuk garanton një zgjidhje të qëndrueshme
Mbështetja nga donatorët e huaj	Lehtëson financimin nga fonde publike	Kosto e shërbimit optimizohet sipas zgjidhjes më të mirë teknike të cdo zone	Zgjidhjet mund të mos jenë të qëndrueshme. Kërkon koordinim specifik midis donatorëve të përfshirë
Financimi nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve	Ofrimi i shërbimit realizohet brenda kornizës zhvillimore të rajonit. Mundësohet financimi në të ardhmen përmes fondeve të BE.	Kosto e shërbimit optimizohet sipas zgjidhjes më të mirë teknike të çdo zonë	Realizimi i zgjidhjes kërkon kohë dhe është i varur nga financimet e fondit.
Bashkëpunimi ndërkufitar me vendet fqinje	Mund të sjellë zgjidhje praktike në rastet kur vendet fqinje e kanë më të modernizuar shërbimin e internetit në zonat pranë kufirit	Relativisht e ulët	Realizimi i zgjidhjes kërkon rishikimin e legjislacionit dhe arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit për këtë qëllim.

REKOMANDIME

Analiza e mësipërme tregon ekzistencën e një situatë të pafavorshme për përdoruesit e internetit në zonën e 'Bjeshkëve të Namuna' për shkak se sektori privat, i cili ofron shërbimin e internetit në të gjithë vendin, nuk gjen interesin e duhur, ndeshet në vështirësi të konsiderueshme objektive dhe nuk paraqet prirje të dukshme për të mundësuar në të ardhmen e shpejtë shërbimin e internetit në këtë zonë, ashtu si dhe në pjesët e tjera të Shqipërisë.

Në kushte të tilla, dhe duke vlerësuar rëndësinë e veçantë që interneti paraqet për zhvillimin e sektorëve aktivë ekonomikë në zonë e sidomos turizmin malor, përpjekjet për të promovuar shërbimin e internetit në zonë për t'u ofruar mundësi përdorimi të njëjta të gjithë përdoruesve në shkallë vendi, duke përdorur edhe mënyra jo tipike për pjesët e tjera të vendit, janë jo vetëm të justifikuar, por edhe të nevojshme.

Rezultate pozitive në këtë drejtim, mund të arrihen vetëm përmes një bashkëpunimi të ngushtë, të vazhdueshëm e të qëndrueshëm midis të gjithë faktorëve ekonomikë, rregullatorë e shoqërues të tregut, përfshirë institucionet shtetërore, operatorët e shërbimit të internetit, bizneseve lokale në zonë, organizatave lokale dhe ndërkombëtare etj. E rëndësishme është të theksohet që çdo ndërhyrje për mbështetjen e përdorimit të internetit në zonë, duhet të jetë e pajtueshme me sistemin e tregut dhe nuk duhet të dëmtojë aktivitetin e operatorëve privatë në zonat ku ata kanë arritur të funksionojnë. Nga kjo pikëpamje, studimi rekomandon që pavarësisht zgjidhjes teknike, përdoruesit fundorë biznese aktive në zonë, duhet të paguajnë për shërbimin e përfituar në kushte të ngjashme me përdoruesit e tjerë në vend.

Studimi i problematikës në zonë tregon se është vështirë të rekomandohet një zgjidhje e vetme teknike për të mundësuar shërbimin e internetit për përdoruesit në zonë, sikurse nga ana tjetër, çdo mënyrë promovimi mund të rezultojë e dobishme. Për më tej, në varësi të kushteve specifike, një zgjidhje optimale në komuna të caktuara brenda zonës mund të jetë e pamundur nga ana praktike në një komunë tjetër, ndaj vlerësimi përfundimtar i vendimmarrjes për zgjidhjen teknike do të duhet të bazohet rast pas rasti.

Pavarësisht diversitetit të zgjidhjeve teknike për ofrimin e shërbimit të internetit brenda zonës, në të gjitha rastet, shteti shqiptar përmes funksioneve dhe institucioneve të tij ka një rol parësor për shtrirjen dhe fuqizimin e shërbimit të internetit në zonë. Nisur nga përmasat e kërkesës në zonë dhe veçoritë specifike të saj, për të përmbushur mungesën e shërbimit të internetit, studimi nuk rekomandon ndërmarrjen e ofrimit të këtij shërbimi nga ana e një njësie publike (kompani shtetërore) dhe as nuk vlerëson si të nevojshme zgjidhjen e këtij problemi me forma koncesionare. Qeveria shqiptare gjithashtu nuk mund të vendosë, por mund të influencojë për shtrirjen e shërbimit

të internetit në zonë, në vendimarrjen e operatorit më të rëndësishëm të linjave fikse në vend, nëpërmjet aksioneve që zotëron në këtë shoqëri.

Forma praktikisht më e përshtatshme dhe e pajtueshme me modelin e tregut, ka për bazë funksionin e shtetit si një përdorues i rëndësishëm i këtij shërbimi nga i cili mund të përfitojnë pa shumë kosto shtesë edhe përdorues të tjerë. Më konkretisht, rekomandohet që qeveria shqiptare të vazhdojë me të njëjtin ritëm shtrirjen e përdorimit të internetit në të gjitha zyrat publike që funksionojnë në zonë, gjë që do të ndihmojë apo mundësojë pa, ose me pak kosto shtesë, aksesin në internet edhe për përdoruesit që ndodhen në afërsi të këtyre zyrave. Përvoja pozitive e arritur me projekte e-government, sic është ai PAP (*Points of Public Access*) që mundësojnë përdorimin falas të internetit pranë zyrave të shërbimit postar, prefekturave, komunave etj. vlen të thellohet edhe më tej duke rritur numrin e këtyre njësive funksionale drejt objektivit 1800 në shkallë vendi, dhe i kthyer ato në bërthama të rëndësishme për përhapjen e internetit në zonë.

Në mënyrë të njëjtë, rekomandohet intensifikimi i informatizimit dhe lidhjes e fuqizimit të internetit në të gjitha shkollat e zonës, si një process që ka përfshirë rreth 2000 shkollat që funksionojnë në shkallë vendi. Përbushja e këtij objektivit mund të realizohet jo vetëm nëpërmjet financimit nga buxheti i shtetit, por edhe përmes projekteve të financuara nga organizatat ndërkombëtare, gjë që kërkon gjithashtu një bashkëpunim të ngushtë dhe koordinim të punës me to.

Realizimi i investimit në rrjetin broadband për pjesë të vecanta të zonës mund të kryhet edhe nëpërmjet financimeve të fondit për zhvillimin e rajoneve, gjë që kërkon krijimin e hapësirave për financime në këtë infrastrukturë, dhe harmonizimin e prioritetëve të financimit të fondit me strategjinë ndërsektoriale 'Akhenda Dixhitale e Shqipërisë 2014-2020'. Një gjë e tillë do të krijonte premisat e duhura për të shfrytëzuar në të ardhmen edhe financime në këtë sektor nga projektet e BE si IPA CBC, HORIZON 2020, EUSAIR (*EU Strategy for the Adriatic and Ionian Region*) ku në këtë të fundit Shqipëria është koordinatore e prioritetit "Turizëm i Qëndrueshëm", IPA kombëtare dhe shumëpërfitues. Në mënyrë të ngjashme, rajonet brenda zonës, kanë gjithashtu një rol të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e projekteve të zhvillimit që fuqizojnë shtrirjen e infrastrukturës së internetit në zonë.

Studimi rekomandon që shteti shqiptar, përmes AKEP-it si institucioni përgjegjës për rregullimin e tregut të telekomunikacioneve, duhet të përdorë të gjithë hapësirat ligjore dhe politikat ekzistuese për të inkurajuar dhe shtyrë investimet në rrjetin e internetit broadband në zonat e izoluara e rurale nga ana e operatorëve në treg. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar, mund të konsiderohet edhe mundësia e marrjes së shërbimit në zona të caktuara nga operatorë të vendeve fqinje, kur kushtet specifike mundësojnë një gjë të tillë pa dëmton tregun vendas dhe mbështetur në marrëveshjet përkatëse.

Vlerësimi i kostos së instalimit dhe përdorimit tregon se në zonat pa mbulim të mjaftueshëm me rrjet fiks apo të lëvizshëm, lidhja satelitore rezulton si më efektive për të përmbushur nevojat e tregut, ndërkohë që kufizimet teknike që ajo paraqet, balancohen nga avantazhe të tjera që zgjidhjet e tjera nuk i kanë. Në zonat që kanë mbulim me sinjal 3G apo ku ka arritur rrjeti fiks apo fibrat optike, zgjidhjet mund të bazohen në përdorimin e këtyre teknikave apo dhe kombinimeve të tyre.

Fund Kapitulli IV

KONKLUZIONE

Bjeshkët e Namuna, zona e mbuluar nga projekti IBB shtrihet në qarkun e Shkodrës dhe Kukësit. Të dy këto qarqe kanë potenciale të evidentuara për zhvillimin e turizimit. Zhvillimi i turizimit dhe agrobiznesi janë dy sektorë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik e social të zonës. TIK dhe lidhja broadband janë shumë të rëndësishëm për të realizuar këtë. Projekte dhe eksperiencat e vendeve të tjera tregojnë më së miri lidhjen dhe ndikimin e TIK dhe broadband për zhvillimin ekonomik e social dhe zhvillimin e turizmit.

Nevoja për Internet dhe broadband është evidente në zonën e Bjeshkëve të Namuna, si rrjetet fikse dhe ato të lëvizshme nuk mbulojnë në mënyrë të kënaqshme me shërbim të gjitha pikat dhe zonat e thella. Marrja në konsideratë e mundësive teknologjike për realizimin e lidhjes broadband është i nevojshëm.

Qarku Kukës ka një stabilizim të popullsisë totale të rajonit në vitet e fundit pavarësisht se lëvizjet demografike brenda tij vazhdojnë (nga zonat rurale në ato urbane) si pasojë e terreneve gjeografike të vështira dhe ofrimit të dobët të shërbimeve në zonat më periferike.

Ekonomia rajonale është mjaftueshmërisht e diversifikuar dhe nga ana tjetër rajoni posedon burime të mëdha natyrore të cilat kanë potencial të lartë ekonomik. Përmirësimi i aksesit infrastrukturor sidomos me pjesën tjetër të vendit i jep më shumë shanse ekonomisë rajonale. Por nga ana tjetër ka akoma potenciale të pashfrytëzuara të burimeve (turizmi, energjitë e rinovueshme, minierat). Për më tepër ka nevojë për parandalimin e shfrytëzimit të paligjshëm të burimeve (psh: pyjeve).

Në aspektin social parametrat e arsimit e shëndetësisë kanë përmirësime sidomos në zonat urbane.

Megjithatë rajoni në brendësi ka shumë pabarazi dhe problematike mbeten zonat rurale dhe periferike, zona të cilat vuajnë edhe nga varfëri dhe papunësi e lartë dhe akses më i dobët në shëndetësi dhe arsim.

Rajoni ka bukuri të rralla natyrore por që nga ana tjetër vihen shumë në rrezik nga niveli shumë i ulët i përgjegjshmërisë dhe masave mbrojtëse ndaj mjedisit (psh: ndotje mjedisore për shkak të industrisë minerare, përdorimi i paqëndrueshëm i pyjeve, i ujërave për peshkim etj).

Ndërkohë, aksesit infrastrukturor i përmirësuar mund të përbëjë dhe kërcënim duke qenë se mund të rrisë presionin mjedisor.

